

# RAPORT PARAPRAK VLERËSIM I NDIKIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

LIGJ Nr.10 440, datë 07.07. 2011, SHTOJCA II, PIKA 10, B

Projekti:

## REHABILITIMI I BREGUT TE LIQENIT TE OHRIT DHE GJELBERIMI PERGJATE RRUGES SEGMENTI LIN - POGRADEC

BASHKIA POGRADEC, QARKU KORCE



Tiranë, Korrik 2015



Informacion mbi Studimin Paraprak të VNMS:

**Titulli i projektit:** Rehabilitimi i bregut të Liqenit të Ohrit dhe gjelberimi përgjatë rruges segmenti Lin - Pogradec

**Procedura:** Paraprake

**Rev:** 00

**Aprovuar:** C.E.C GROUP.Sh.p.k  
(Licensuar me LN-7297-01-2014)

**Koha e përgatitjes së projektit** 2014-2015

**Objektivat afat-gjata** Orientimi i zbatimit të studimit të fisibilitetit për të siguruar një ndikim sa më pozitiv mjedisor dhe social përgjatë bregut të liqenit të Ohrit (Lin-Pogradec)

**Objektiva specifike të projektit:**

- Të përshkruajë, identifikojë dhe vlerësojë efektet e mundshme domethënëse të zbatimit të Projekt – idese se kerkuar per zhvillimin e projektit ne teresi me elementet e vete perberes te planifikuar konform standarteve te projektimit
- Kthimin e hapësirës së bregut të liqenit në një hapësirë të mirefillte publike për qytetaret.
- Përcaktimin e një strukture të qartë rrugore e afte për të plotësuar nevojat për levizje dhe qarkullim komod për komunikim sa më të mirë të Rajonit me qendrat e banuara dhe strukturat e mëvonshme turistike apo edhe të shërbimeve publike.
- Realizimi i një komunikim sa më të shpejtë dhe të qëndrueshëm midis qytetit dhe qendrave të banuara përgjatë bregut të liqenit duke përdorur mjete transporti me impakt të ulët ambiental.
- Përmirësimin e peisazhit natyror e urban të bregut të liqenit nëpërmjet nderhyrjeve të thjeshta rehabilituese, shtrime, sisteme, dhe shtim të gjelberimit.

**Data e këtij raporti:** Korrik 2015

**Revizion:** Rev-01

**Bashkeautore:**

Ing.Mjedisi. Bledi Dimo (Expert Mjedisi)

Ing. Mjedis Fatjona Levani

Ing.Mjedisi Gjergji Lici

Ing.Anduen Mbrice

  
\_\_\_\_\_  
  
\_\_\_\_\_  
  
\_\_\_\_\_  
  
\_\_\_\_\_





**Pasqyra e Lendes së VNMS:**

|   |    |
|---|----|
| 1. QELLIMI I PROJEKTTIT DHE DATEN E PARASHIKUAR TE VENIES NE FUNKSIONIM TE INSTALIMEVE.....   | 7  |
| 1.1. Qellimi dhe objektivat e studimit.....   | 7  |
| 1.1.1.1. Qellimi i projektit.....   | 7  |
| 1.1.2. Objektivat e projektit.....  | 8  |
| 1.2. Qellimi i vleresim ndikimit ne mjedis dhe social.....  | 8  |
| 1.3. Përshkrim i kuadrit ligjor dhe institucional.....  | 10 |
| 2. ZHVILLIMI RAJONALE SI DHE STUDIME TE REALIZUARA NE ZONEN NE RANGE QARKU.....   | 18 |
| 2.1. Hyrje.....   | 18 |
| 3. PERSHKRIMI I PROJEKTTIT.....   | 22 |
| 3.1. Te pergjithshme.....   | 22 |
| 3.2. Metodologjia dhe koncepti i nderhyrjes.....  | 23 |
| 4. PERSHKRIMI I MJEDISIT NE ZONEN E POGRADECIT.....   | 37 |
| 4.1. Klima.....   | 37 |
| 4.2. Gjeologjia & Gjeomorfologjia.....  | 37 |
| 4.3. Hidrologjia.....   | 39 |
| 4.4. Habitatet në zonën e mbrojtur.....   | 41 |
| 4.5. Përshkrimi i peisazhit kulturor dhe trashëgimia në zonën e mbrojtur.....   | 48 |
| 4.6. Përshkrimi i sistemit socio-ekonomik të zonës së mbrojtur.....   | 49 |
| 4.7. Bujqësia dhe blegtoaria.....   | 50 |
| 4.8. Aktiviteti artizanal.....  | 51 |
| 4.9. Përdorimi i ujit.....  | 51 |
| 4.10. Peshkimi.....   | 51 |
| 4.11. Aktiviteti industrial.....  | 52 |
| 4.12. Turizmi.....  | 52 |
| 5. VLERESIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE DHE SOCIAL.....  | 54 |
| 5.1. Aspekti mjedisor dhe vleresimi i integruar i ndotjes.....  |    |
| Subjekti, siguron qe aspektet ambientale qe kane ose mund te kene pasur impakte te rëndësishme mbi ambientin konsiderohen ne aktin e perkufizimit te objektiveve dhe qellimeve ambientale te Shqiperise, dhe ne aktin e indentifikimit te aktivitetit qe kane nevoje per planifikimin, me ardhjen e emetimeve eventuale te procedurave te reja..... |    |
| 5.2. Identifikimi i aspekteve mjedisore.....  |    |
| 5.3. Vleresimi i aspekteve mjedisore.....   |    |
| 5.4. Vleresimi i efekteve ndaj ndryshime klimaterike.....   |    |
| ➤ Biodiversiteti.....   |    |
| ➤ Burimet ujore.....  |    |
| ➤ Bujqësia.....   |    |
| ➤ Turizmi.....  |    |
| 5.5. Masat parandaluese.....  | 96 |
| 5.6. Masat për adaptim ndaj ndryshimeve të klimës të propozuara për t'u integruar ne planin e menaxhimit.....   |    |
| 5.7. Normat e lejuara te shkarkimeve ne mjedis.....   |    |





|   |     |
|---|-----|
| 6. NDIKIMI SOCIAL .....   | 100 |
| 6.1. Situacioni Fillestar: .....  | 100 |
| <br>  |     |
| 7. MUNDËSINË E REILABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE<br>MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË<br>GJENDJEN E MËPARSHME, PËRFSHII EDHE KTHIMIN E TOKËS BUJQËSORË (NË<br>RAST SE PËRDORIMI EKZISTUES ËSHIË I TILLË) DHE KOSTOT FINANCIARE<br>TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN..... | 102 |
| 7.1. Rehabilitimi i mjedisit të ndikuar nga ndertimi i rrjetit inxhinierik .....  | 102 |
| 7.2. Gjelherimi (mbjella e druveve dhe e burit).....  | 103 |
| 7.3. Kujdesi mbi sipërfaqen, druret dhe shkurret.....   | 103 |
| <br>  |     |
| 8. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGJEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE<br>NEGATIVE NË MJEDIS .....   | 105 |
| <br>  |     |
| 9. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUTITAR (NËSE PROJEKTI<br>KA NATYRË TË TILLË).....   | 110 |
| <br>  |     |
| 10. MONITORIMI .....  | 112 |
| 10.1. Elementet e monitorimit .....   | 113 |
| 10.2. Menaxhimi i mjedisit.....   | 113 |
| 10.3. Demolimi / nxjerrja jashtë përdorimit.....  | 113 |
| 10.4. Veprimet e ndaluara: .....  | 116 |
| 10.5. Raportimi dhe publikimi i të dhënave, etj. ....   | 116 |
| <br>  |     |
| 11. KONKLUZIONE .....   | 117 |
| <br>  |     |
| <b>SHTOJCA I</b> .....  | 119 |
| FOTO TE ZONES-INSPEKTIMI NË TERREN.....   | 119 |
| <br>  |     |
| <b>SHTOJCA II</b> .....   | 121 |
| CERTIFIKATA TË EKSPERTEVE DHE LICENCËN PËRKATËSE TË QKI-SË QË<br>KA ILARTUAR RAPORTIN PARAPRAK TË VNM-SË.....   | 121 |





**Lista e figurave, hartave:**

|  |     |
|--|-----|
| Harta 1: Harta e habitateve në Peisazhin e Mbrojtur Tokësor/Ujor të Pogradecit .....   | 45  |
| Harta 2: Tokat aktualisht në pronësi të shtetit dhe komunave në Zonën e Mbrojtur Tokësore/Ujore të Pogradecit .....  | 49  |
| Harta 3: Aktivitetet industriale brenda Peisazhit të Mbrojtur Tokësor/Ujor të Pogradecit .....   |     |
| Harta 4: Ndikimet e mundshme nderkufitare (Harta e NRB Oher-Prespe) .....  | 110 |
|  |     |
| Tabela 1: Per sa i perketë aneve pozitive dhe negative po paraqesim analizen SWOT: .....   | 10  |
| Tabela 2: Fazat e identifikimit .....  |     |
| Tabela 3: Vlerësimi i aspekteve .....  |     |
| Tabela 4: Sipërfaqja sipas verifikimeve aktuale dhe VKM-se .....   | 42  |
| Tabela 5: Aktivitetet e ndaluara e të lejuara brenda Peisazhit të Mbrojtur Tokësor/Ujor të Pogradecit .....  | 43  |
| Tabela 6: Tokat pyjore dhe kullosore që i janë transferuar komunave .....  | 49  |
| Tabela 7: Vëllimet e punimeve që do të kryhen për ndërtimin e objekteve .....  | 56  |
| Tabela 8: Përmbledhje e vlerësimeve të ndikimeve në mjedis gjatë ndërtimit .....   | 91  |
| Tabela 9: Normat e lejuara të shkarkimeve të lëngjta, që duhet të plotësojnë ujërat (e zeza dhe ato teknologjike) pas trajtimit, (Në zbatim të vlerave të miratuara me VKM nr.177 datë 31.03.2005) ..... | 98  |
| Tabela 10: Lista e kontrollit të efekteve të mundshme dhe masave kryesore nga zhvillimi i projektit .....  | 106 |
| Tabela 11: Plani i menaxhimit mjedisor-Mjedisi .....   | 114 |
|  |     |
| Figure 1: Horografia me objektet (Orthophoto View) .....   | 24  |
| Figure 2: Planimetria e Exchange – Market Buqezë .....   | 25  |
| Figure 3: Pamje e Exchange-Market Buqezë .....   | 26  |
| Figure 4: Pamje e lookout .....  | 26  |
| Figure 5: Planimetria e Lookout Yellow .....   | 27  |
| Figure 6: Pamje 3D e Exchange Market Piskupat .....  | 28  |
| Figure 7: Planvendosja e exchange market Piskupat .....  | 28  |
| Figure 8: Planvendosja e Ohri club 1 .....   | 29  |
| Figure 9: Pamje e sailing club .....   | 30  |
| Figure 10: Pamje e Ohri Club 3 .....   | 30  |
| Figure 11: Planimetri e zones se Ohri club 2 .....   | 31  |
| Figure 12: Pamje e Ohri Club 2 .....   | 31  |
| Figure 13: Planvendosja e Exchange Market Hudenisht .....  | 32  |
| Figure 14: Pamje exchange market Hudenisht .....   | 33  |
| Figure 15: Planimetria e lookout magenta .....   | 33  |
| Figure 16: Pamje e exchange market Memelisht .....   | 34  |
| Figure 17: Pamje e Ohri Club 3 .....   | 35  |
| Figure 18: Pamje e parkut të projektuar .....  | 36  |





## Shkurtime

|             |  |
|-------------|--|
| MM -----    | Ministria e Mjedisit   |
| KKT -----   | Këshilli i Kombëtar i Territorit                                       |
| DSHP -----  | Drejtoria e Shërbimit Pyjor  |
| IST -----   | Instituti i Studimeve të Transportit                                   |
| MPPTT ----- | Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit         |
| KQ -----    | Këshilli i Qarkut  |
| NBO -----   | Nevoja Biologjike për Oksigjen   |
| IUCN -----  | Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës                           |
| OJF -----   | Organizata Jofitimprurëse  |
| ARM -----   | Agjencia Rajonale e Mjedisit   |
| SWOT -----  | Analiza e Pikave të Forta, Pikave të Dobëta, Mundësive dhe kërcënimeve |





## 1. QELLIMI I PROJEKTIT DHE DATEN E PARASHIKUAR TE VENIES NE FUNKSIONIM TE INSTALIMEVE

Ne vendin tone zhvillimi i fushes se turizmit eshte nje nga ceshtjet me prioritare te zhvillimit te vendit. Shkak per kete eshte bere dhe trashgimia ne kete fushe e para viteve 1990. Turizmi i ketyre viteve ishte vendor dhe me nje infrastrukture modeste. Me ndryshimin e sistemit ne vendin tone dhe me hapjen e Shqiperise kerkesat per nje turizem bashkekohor dhe elitar erdhen gjithmone e ne rritje. Per kete dhe kerkesat per hapjen e zonave te reja turistike ka ardhur gjithmone e ne rritje. Ky raport thekson nevojën e pershpëjtimit si te hartimit te projektit te detajuar, ashtu dhe planifikimit te metejshem te tij per rritjen e ketyre resurseve me anen e rehabilitimit te zonave turistike te cilet jane ne rrezik prej efektit te erozionit ne nivele te larta duke shkaktuar probleme ne prishjen e vijes se brigjeve te zones se Pogradecit si dhe ndertimeve informale ne keto zona te urbanizuara.

Duke pasur parasysh kushtet social-ekonomike ne zonen e Pogradecit, ky rajon do te kete shume perfitime nga nje investim i tille rehabilitues i cili do te krijoj mundesine per te patur vijueshmeri ne projekte te tjera sensibilizuese per perdorimin e strukturave sociale dhe hapësirave te gjelberta qe do te zhvillohen.

### 1.1. Qellimi dhe objektivat e studimit

Investitori paraqet kete raport – preliminar (fillestar) VNMS-e si procedure te kerkuar per projektin **“Rehabilitimi i bregut te Liqenit te Ohrit dhe gjelberimi”( përgjatë rruges segmenti Lin - Pogradec, Bashkia Pogradec)** si nje kerkese urgjente e kerkuar nga ana e investitorit per permiresimin e aftesive te tyre riperceritese te vijes ujore te zones Pogradec, si dhe zhvillimit te turizmit ne kete zone me vlera mjedisore, duke qene se keto ekosisteme te shendetshme ujore ofrojne – si burim per rritjen ekonomike, turizmin çlodhes si edhe mbrojtjen e brigjeve deri ne mos zhdukjen e ketyre ekosistemeve ujore dhe tokesore.

Investitori do te aplikoje ne vijim per marrjen e te gjithe miratimeve te nevojshme të Rehabilitimit te bregut te Liqenit te Ohrit dhe gjelberimi përgjatë rruges segmenti Lin - Pogradec. Investimet qe do te zhvillohen nga zhvilluesi , ne kete zone per rehabilitim per zhvillim te turizmit si krijimi i kushteve per bike bank, look out, ohri club, exchange market etj ku tashme prej disa vitesh eshte evident fakti qe e gjithë vija ujore e zones se Pogradecit si edhe perreth saj kane qene dhe jane subjekt i erozionit te konsiderueshem.

#### 1.1.1.1. Qellimi i projektit

Qellimi i ketij projekti eshte te shnderroje territorin e bregut te liqenit ne nje hapësirë publike te jetueshme dhe te prekshme per te gjithë qytetaret dhe vizitorët e qytetit te Pogradecit dhe rrethinave te





tij. Sistemimin pothuajse gjatë gjithë gjatësisë së rrugës dhe rehabilitimin e bregut të liqenit, ndertimin e tregjeve dhe helvedereve, si dhe gjelbërimit të zonës. Kjo hapësirë e re e sistemuar dhe e pajisur me infrastrukturen që siguron lidhjen e saj me qendrat e banuara do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve, por mbi të gjitha të rritjes së ndjeshmerisë së tyre për perjetimin dhe mirëmbajtjen e një pasurie të tillë siç është liqeni i Ohrit.

### 1.1.2. Objektivat e projektit

Kthimin e hapësirës së bregut të liqenit në një hapësirë të mirëfillte publike për qytetarët, nëpërmjet nderhyrjeve të thjeshta rehabilituese, shtrime, sistemeve, dhe shtim të gjelbërimit.

## 1.2. Qëllimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe social

Qëllimi i këtij studimi mjedisor është të përshkruajë:

- Vlerësimin kompleks të ndotjes së mjedisit të provokuar nga ky projekt në terma të emetimit në mjedisin akuatik, shkarkime hidrike, nderhyrje në sipërfaqen e tokës, emetime zanore, mbetje, etj
- Vlerësimin e përgjithshëm të zhvillimit turistik;
- Teknikat e adoptuara tashmë për parandalimin e erozionit duke treguar nderhyrjet në këtë rajon konform masterplanit që do të zhvillohet në këtë rajon;
- Përshkrimin e teknikave që menaxhuesi kërkon të ndermarre për parandalimin e ndotjes, duke treguar nderhyrjet që kanë për të ulur emetimin në ajër, në ujë dhe tokë.

Bashkeveprimi i aktiviteteve të kryera në fazën e ushtrimit të aktivitetit turistik janë analizuar në raport me aspektet ambientale në vijim:

Studimi i fizibilitetit (i cili është projektuar nga studioja e nenkontraktuar nga investitori) jep një përmbledhje të të gjithë informacionit të mundshëm për kushtet fillestare të zonës, përfshirë kushtet fizike dhe atmosferike, burimet ujore dhe biologjike, burimet kulturore dhe kushtet social-ekonomike. Këto kushte si dhe standardet dhe normat e aplikueshme janë mbajtur parasysh gjatë procesit të kryerjes së studimit, për të vlerësuar ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale.

Ky studim përfshin ndikimet e mundshme në ajër, tokë, burime ujore, kushtet social-kulturore gjatë fazave të ndertimit dhe përdorimit të zonës së rehabilituar të bregut të Liqenit të Ohrit, si dhe infrastrukturen shtesë që lidhet me veprimtarinë e tij sipas projekt-idese bashkelidhur studimit.

Studimi paraqet masa lehtësuese për të minimizuar ose për të parandaluar ndikimet sociale dhe ambientale të projektit. Këto përfshihen në një plan menaxhimi ambiental i cili konsiston në vendosjen e masave lehtësuese, monitoruese dhe institucionale që do të ndermerren gjatë ndertimit







dhe pas zbatimit te projektit "Rehabilitimi i bregut te Liqenit te Ohrit dhe gjelberimi pergjate rruges segmenti Lin - Pogradec" per te eliminuar, kompensuar ose per te zvogeluar ndikimet sociale dhe mjedisore.

Ri-ndertimi i kesaj zone turistike "Rehabilitimi i bregut te Liqenit te Ohrit dhe gjelberimi pergjate rruges segmenti Lin - Pogradec" do te ishte nje zgjidhje ekonomike per kushtet aktuale te situates turistike ne vend dhe me ndikime mjedisore me te ulta te mundshme ne raport me te gjitha veprimtarite e tjera.

Studimi fillestar i fizibilitetit per realizimin e ketij projekti, eshte mbeshtetur ne parimet baze te mbrojtjes se mjedisit, te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit te qendrueshem
- Parimi i kujdesit
- Parimi i parandalimit
- Parimi "ndotesi paguan"
- Parimi i riparimit te demeve mjedisore, perteritjes e riaftesimit te mjedisit te demtuar
- Parimi i pergjegjesise ligjore
- Parimi i mbrojtjes ne shkalle te larte
- Parimi i integritit te mbrojtjes se mjedisit ne politikat sektoriale
- Parimi i ndergjegjesimit dhe i pjesemarrjes se publikut ne vendimarrjen mjedisore
- Parimi i transparences ne vendimarrjen kryesore

Ne studimin Mjedisor per ndertimin e ketij projekti "Rehabilitimi i bregut te Liqenit te Ohrit dhe gjelberimi pergjate rruges segmenti Lin - Pogradec" jane mbajtur parasysh elementet kryesore strategjike te mbrojtjes se mjedisit, te renditur si me poshte:

- Parandalimi dhe ulja e ndotjes se ujit, ajrit, tokes dhe ndotjeve te tjera te cdo lloji
- Ruajtja e shumellojshmerise biologjike sipas hazes natyrore, biogjeografike te vendit
- Perdorimi racional i burimeve natyrore e minerare dhe shmangia e mbishfrytezimit te tyre
- Riaftesimi ekologjik i zonave te demtuara dhe te ndotura nga veprimtaria e njeriut dhe dukurite natyrore shkaterruese
- Ruajtja e ekuilibrit ekologjik dhe permiresimi i cilesise se jetes

Studimi ka marre parasysh mbrojtjen e mundshme maksimale te biodiversitetit, parandalimin e problemeve te mundshme mjedisore ne te ardhmen. Elementet baze te metodologjise se perdorur e trajtojne zhvillimin e kesaj zone si nje proces te vazhdueshem dhe adaptiv te administrimit te burimeve per zhvillimin e qendrueshem te brigeve Ne kete drejtim, ka rendesi kuptimi i plot i





marredhnieve midis vleresimit te sakte te vleres se pasurive natyrore ujqore, perdorimit efektiv te tyre dhe ndikimit te ndersjellte midis zhvillimit ekonomik te vendit dhe ruajtjes se mbrojtjes se mjedisit. Shprehja e marredhnieve te mesiperme ne terma fizike e mjedisore, si dhe ne terma ekonomike, ndihmon ne planifikimin, formulimin e politikave, zbatimin dhe kryerjen e vleresimit te drejte te ndikimit ne mjedis te objektivave te planifikuara per ndertimin ne zonen ne studim.

Konkretisht studimi i VNM-se per problemin ne studim ka marre parasysh:

*Ruajtjen maksimale te mundshme te mjedisit, e cila realizohet nepermjet:*

- Sugjerimit te perzgjedhjes se zones me me pak ndikime negative ne mjedis.
- Sugjerimit te perzgjedhjes se zones qe po erodohet nga liqeni. Parimi "ndotesi paguan", ne kete rast perkthehet me "sipermarresi mbron brigjet prane ndertimit te planifikuar".
- Sugjerimit te perzgjedhjes se zones me me pak ndikime negative ne biodiversitet.
- Perdorimit te burimeve energjitike me efekt minimal ne mjedis.

Tabela 1; Per sa i perket aneve pozitive dhe negative po paraqesim analizen SWOT:

| Anet e forta   | Mundesite  |
|--|--|
| Pozicioni gjeografik<br>Kapaciteti njerezor<br>Prania e ujerave me karakter te perhashket ujqor dhe tokesor<br>Burimet Natyrore (lagunat natyrore, etj)<br>Afersia me rrugen kombetare per ne piken kufitare Qafe Thane<br>Prania e sherbimeve per banoret si (uji i pijshem, menaxhimi i mbetjeve, etj) | Zhvillimi turistik<br>Zhvillimi tregtar i zones<br>Peshkimi si aktivitet<br>Perpunimi i produkteve bujqesore<br>Mundesite e zhvillimit te infrastruktures qe lidhen me sistemin rrugor |
| Anet e dobeta  | Rreziket   |
| Zhvillimi i pa kontrolluar i ndertimeve pa leje<br>Mungesa e master planeve dhe planeve rregulluese<br>Siperfaqja e vogel e Bashkise Pogradec  | Erozioni i larte ne brigje nga ndertimet e paligjshme dhe i tokes<br>Permbytjet (ngritja e nivelit te liqenit gjate rreshjeve te dendura te shiut. etj)<br>Vandalizma                  |

### 1.3. Pershkrim i kuadrit ligjor dhe institucional.

#### Metodologjia e hartimit te VNM

Hartimi i ketij raporti VNM eshte bere ne perputhje me ligjin Nr. 10 440, date 7.7. 2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis " ku sipas nenit 8 te ketij ligji ,percaktohen edhe projektet qe i nenshtrohen procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis ,sipas shtojces II (pika 10) veprimtaria e projekteve te infrastruktures, nenpika b). Projektet e zhvillimit urban i nenshtrohen Procedures Paraprake te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis;

Gjithashtu hartimi i ketij raporti fillestar te procedures paraprake te vleresimit te ndikimit ne mjedis eshte bere ne perputhje me ligjin Nr.10 431, date 9.6.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit" i ndryshuar, i cili eshte përfuar plotësisht me Direktiven 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, date 21 prill 2004 "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin".





Metodologjia e hartimit të VNM është hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës mjedisor të shprehura në Udhëzimin Nr.3, datë 19.11.2009 "Për Metodologjinë e Vlerësimit të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Vlerësimi i ndikimeve në mjedis nga aktiviteti në zonën e projektit merr në konsideratë se si këto procese gjatë zbatimit të projektit ndikojnë në gjendjen ekzistuese të mjedisit të zonës dhe me vone. Ndikimet kumulative që mund të ndodhin mund të shfaqen menjëherë kur ndodh një ndërhyrje në mjedis apo shfaqen në mënyrë indirekte dhe ato mund të shfaqin shkallë të ndryshme rëndësie. Këto ndikime mund të jenë të ndryshme në kohë zgjarjen e ndikimit (Afatshkurter, Afatmesatar dhe Afatgjatë në kohë) dhe të ndryshme në karakterin e tyre (ndikim i perkohshëm dhe i perhershëm).

Vlerësimi i ndikimeve në mjedis të shkaktuara nga proceset e përmendura më lart janë përcaktuar për pritesit në mjedis të këtyreve ndikimeve,

- Ekosistemet natyrore, fauna dhe flora
- Toka dhe nentoka
- Hidrologjia në mjedis (ujrat tokësore dhe ato nentokësore)
- Cilesia e ajrit
- Klima
- Peisazhi
- Shëndeti publik dhe cilesia e jetes
- Pronesia (ndertimet e ndryshme dhe tokat bujqesore)
- Trashëgimia kulturore, duke përfshirë ndertimet arkeologjike dhe ato tradicionale

Gjatë plotësimit të kërkesave hartuesit e këtij raporti grumbullojnë informacionin e domosdoshëm, që përfshin:

- a) kërkesat e përdorimit të tokës dhe mënyrat e përdorimit aktual të saj nga zbatimi i projektit;
- b) ndërtimin e objekteve dhe instalimet e pajisjeve teknologjike që do të realizohen;
- c) proceset teknologjike, lëndët e para që do të përdoren, përfshirë edhe energjinë elektrike dhe produktin përfundimtar të procesit;
- d) shkarkimet në mjedis, si dhe mundësisht sasinë respektive të tyre;
- e) llojin e mbetjeve përfundimtare që do të prodhohen nga veprimtaria, si dhe sasinë e tyre;
- f) gjendjen aktuale të mjedisit ku do ushtrohet veprimtaria, si dhe karakteristikat e veçanta të tij, përfshi edhe statusin ligjor të zonës ku synon të ushtrohet veprimtaria;
- h) gjendja e infrastrukturës rrugore, elektrike, kanalizimet e ujërave, si dhe nevoja për infrastrukturë të re të projektit.

Vendimi (Nr.247, datë 30.04.2014): Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore.

1. Pjesëmarrja e publikut në hartimin e politikave, strategjive, rajonale e kombëtare, të përgjithshme dhe të planeve të veprimit, në zbatim të tyre, që kanë lidhje me mjedisin, përbën kërkesë ligjore në procesin e hartimit të këtyre dokumentave, që përmirëson përmbajtjen dhe lehtëson zbatimin e tyre.

2. Autoritetet publike gjatë procesit të hartimit të dokumentave të përmendura në pikën 1, të këtij kreu, pjesëmarrjen e publikut të ndikuar e realizojnë:

- a. duke i siguruar atij informacionin e nevojshëm për këto dokumenta;
- b. me përcaktimin e rregullave dhe procedurave sa më të thjeshta;
- c. me sigurimin e kushteve dhe të zgjidhjeve praktike, të përshtatshme për tërheqjen e mendimit të tij.

3. Për të garantuar pjesëmarrjen e publikut dhe kontributin e tij, autoritetet publike zbatojnë procedurat, si më poshtë vijon:

- a. Në përputhje me natyrën dhe përmbajtjen e dokumentit të hartuar, identifikojnë atë, që përbën publikun e ndikuar për rastin konkret;
- b. Organizojnë njoftimin e publikut të ndikuar, se është hartuar projekti i dokumentit që do të bëhet objekt i debatit publik dhe e ftojnë publikun të njihet me të e të përgaditet për debat.

4. Njoftimi i publikut të ndikuar shpallet:

- a. në radio e tv, kombëtare e vendore;



- b. në faqen e internetit të autoritetit;
- c. në botime, të përditshme apo periodike, nëse është e mundur;
- d. në tabelën e njohimeve, në vend të dukshëm.

5. Grupi hartues i dokumentit e ripunon atë, duke marrë parasysh çdo koment, informacion, analizë apo mendim të paraqitur nga publiku, që vlerësohet i vlefshëm, dhe harton relacionin, që shoqëron projektdokumentin, ku pasqyrohen vërejtjet e publikut, që nuk janë reflektuar në të, duke shpjeguar edhe arsyet pse nuk janë marrë parasysh.

6. Relacioni i përcillet organit vendimarrës, së bashku me projektin përfundimtar të dokumentit e me procesverbalin e debatit me publikun.

*Hartimi i këtij raporti VNM është bërë në përputhje me ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011. "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis " ku sipas nenit 8 të këtij ligji, përcaktohen edhe projektet që i nënshtrohen procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, sipas shtojcës II i nënshtrohen Procedurës paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.*

Gjithashtu hartimi i këtij raporti të përmbledhur të vlerësimit të ndikimit në mjedis është bërë në përputhje me ligjin Nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", i cili është përafëruar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 21 prill 2004 "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin".

Synimet e hartimit të VNM-se

Hartimi i këtij raporti VNM -je është bazuara gjithashtu në ligjin për mbrojtjen e mjedisit, i cili në vetvete synon:

- të rregullohet marrëdhënia ndërmjet njeriut dhe mjedisit,
- të mbrojtë përbërësit e mjedisit dhe proceset mjedisore
- të sigurojë kushtet materiale për zhvillimin e qëndrueshëm, duke plotësuar kuadrin e nevojshëm për zbatimin e kërkesës kushtetuese për një mjedis ekologjikisht të pastër.
- përdorimin racional të mjedisit dhe kufizimin e shkarkimeve të ndotjeve në të, parandalimin e dëmtimit të tij, rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar;
- përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut;
- ruajtjen dhe mirëmbajtjen e burimeve natyrore, të përsëritshme dhe të papërsëritshme, administrimin racional dhe të frytshëm të tyre;
- bashkërendimin e veprimtarive shtetërore për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit;
- bashkëveprimin ndërkombëtar në fushën e mjedisit;
- nxitjen dhe pjesëmarrjen e publikut në veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit;
- bashkërendimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit me kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm;
- ngritjen dhe forcimin e rrjetit institucional të mbrojtjes së mjedisit në nivel qendror dhe vendor.

#### Parimet e Hartimit të VNM-se:

Parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit , ku mbështetet edhe ky raport VNM-je janë :

- a) parimi i zhvillimit të qëndrueshëm;
- b) parimi i kujdesit;
- c) parimi i parandalimit;
- ç) parimi "ndotësi paguan";
- d) parimi i riparimit të dëmeve mjedisore, përtëritjes e riaftësisimit të mjedisit të dëmtuar;
- dh) parimi i përgjegjësisë ligjore;
- e) parimi i mbrojtjes në shkallë të lartë;
- e) parimi i integritetit të mbrojtjes së mjedisit në politikat sektoriale;
- f) parimi i ndërgjegjësimit dhe i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen mjedisore;
- g) parimi i transparencës në vendimmarrjen mjedisore.



"Zhvillimi i qëndrueshëm" i cili është zhvillimi që plotëson nevojat e se tashmes dhe të se ardhmes pashtrënguar ose prekur mundësitë dhe kapacitetet që edhe brezat e ardhshëm të plotësojnë nevojat e tyre.

"Përdorimi i qëndrueshëm" i burimeve natyrore e minerare, i cili siguron plotësimin e nevojave të sotme, pa cenuar nevojat e brezave të ardhshëm për këto burime.

"Teknikat me të mira të mundshme" përfaqësojnë fazën më të përparuar dhe me nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, të zhvillimit të një veprimtarie dhe që janë plotësisht të zbatueshme nga pikëpamja praktike dhe ekonomike.

"Parimi i parandalimit" është përzgjedhja dhe miratimi i variantit më të mirë, që në fazën fillestare të vendimmarrjes, për të shmangur ndikime të dëmshme të një veprimtarie në mjedis.

"Parimi i riaftësimit" është domosdoshmëria për të riparuar dëmet mjedisore të shkaktuara nga vete personat fizike e juridike dhe për të përtëritur dhe riaftësuar mjedisin e dëmtuar :

"Parimi "Ndotësi paguan" nënkupton koston që paguan ndotësi për përmirësimin e një mjedisi të ndotur dhe për kthimin e tij në një gjendje të pranueshme. Kjo pasqyrohet në koston e prodhimit, të konsumit të mallrave dhe të shërbimeve që shkaktojnë ndotjen.

#### Elementet kryesore strategjike të mbrojtjes së mjedisit

Elementet kryesore strategjike të mbrojtjes së mjedisit që janë gjithashtu detyruesisht të zbatueshme të përshkruar në këtë raport VNM -je janë:

- a) parandalimi dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
  - b) ruajtja e shumëllojshmërisë biologjike sipas bazës natyrore, biogeografike të vendit;
  - c) përdorimi racional i burimeve natyrore e minerare dhe shmangia e mbishfrytëzimit të tyre;
  - ç) riaftësimi ekologjik i zonave të dëmtuara dhe të ndotura nga veprimtaria e njeriut dhe dukuritë natyrore shkatërruese;
  - d) ruajtja e ekuilibrit ekologjik dhe përmirësimi i cilësisë së jetës
- Gjate vënies në punë të veprimtarive dhe instalimeve, personat fizike e juridike sigurojnë:
- a) zbatimin e të gjitha masave që parandalojnë shkarkimet mbi norme dhe ndotjen e mjedisit;
  - b) shmangien dhe pakësimin e mbetjeve dhe, aty ku përdorimi i tyre nuk është i mundur teknikisht ose ekonomikisht, neutralizimin e tyre, duke shmangur dhe pakësuar ndikimin në mjedis;
  - c) parandalimin e aksidenteve industriale dhe kufizimin e pasojave të tyre;
  - ç) kthimin e vendit në kushte të kënaqshme mjedisore pas përfundimit të veprimtarisë;
  - d) njoftimin për çdo ndryshim të planifikuar të linjës teknologjike;
  - dh) respektimin e kërkesave dhe të kushteve të lejes mjedisore;
  - e) njoftimin e agjencive rajonale të mjedisit, jo më rrallë se një herë në 3-6 muaj, për rezultatet e vetemonitorimit dhe, në çdo kohë, për aksidentet ose emergjencat me ndikim negativ në mjedis;
  - ë) plotësimin e kërkesave të Inspektoratit të Mjedisit gjatë kryerjes së kontrollit të veprimtarisë së tyre;
  - f) njohjen e publikut me gjendjen e mjedisit dhe profilin mjedisor të veprimtarisë së tyre;
  - g) mbajtjen e regjistrave për shkarkimet në mjedis, për përdorimin e ujit dhe të energjisë, si dhe për teknikat e përdorura.

#### Politikat Kombëtare për Mjedisin

Ligji për mbrojtjen e mjedisit përcakton dhe politikat shtetërore për mjedisin . Ky raport VNM-je përmbush dhe është në përputhje me këtë nen mbi politikat shtetërore për mjedisin si më poshtë :

1. Politika shtetërore për mbrojtjen e mjedisit synon zbatimin e kërkesave të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë për mjedisin. Në hartimin dhe zbatimin e saj angazhohen të gjitha organet shtetërore, secili në linjën e vet.

2. Organet shtetërore të ngarkuara me ligj për administrimin e përbërësve të mjedisit në politikat sektoriale, kombëtare e vendore, si transport, energji, bujqësi, turizëm, industri, shërbime, rregullim territori e zhvillim ekonomik e shoqëror, në tërësi, sigurojnë harmonizimin e zhvillimit ekonomik e shoqëror me mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

#### **Kuadri Ligjor Vendor dhe Nderkombëtar**





Hartimi i kesaj VNM -je per zhvillimin e zones se projektit te pershkruar ne kapitujt ne vijim , eshte i mbikqyrur nga disa institucionet qendrore dhe ato lokale per zbatimin sa me rigoroz te te gjitha ligjeve dhe normave te parashtruara ne ligjet perkatese sipas institucioneve dhe kompetenceve te tyre

Legjislacioni mjedisor eshte ndertuar per te mbrojtur dhe parandaluar komponente te veçante dhe te rëndësishem te mjedisit. Keshtu, nder me specifiket mund te permendim:

- Ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis"
- Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 " Per Mbrojtjen e Mjedisit "
- Ligji 10448 date 14/07/2011 " Per lejet e Mjedisit "
- Ligjin Nr.10 266, datë 15.4.2010"Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin Nr 8897 date 16/5/2002 "Per Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja "
- Ligji Nr.9115 datë 24.07.2003, "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura".
- Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja".
- Ligji Nr.9379, datë 28.04.2005, "Për eficientën e energjisë".
- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit"
- Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura".I ndryshuar me:  
Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008

- Ligji Nr.10 081, datë 23.02.2009 për "Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"

- Ligji Nr. 8094 datë. 21.03.1996: "Për largimin publik të mbeturinave"
- Ligji Nr. 9010 datë 13.02.2003: "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta" I ndryshuar me :Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009
- Ligji Nr.8102 datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" i ndryshuar me:

Ligjin Nr. 9352, datë 3.3.2005

Ligjin Nr. 9915, datë 12.5.2008

- Ligji Nr. 9537, datë 18.5.2006 "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme" i ndryshuar me:  
Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009

- Ligji Nr. 9103, dt. 10.7.2003, "Per mbrojtjen e Ligeneve Nderkufitare"

- VKM Nr. 80, dt. 18.2.1999, "Per shpalljen Park Kombetar te Prespes dhe Peisazh i mbrojtur tokesor/ujor te Pogradecit",

Nr. 80, datë 18.2.1999• VKM. Nr. 835, datë 28.12.2005 "Për miratimin e listës së mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve dhe mbeturinave të tjera, që ndalohen të importohen, me qëllim ruajtjeje, depozitimi dhe asgjësimi"

- V.K.M Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit"

- V.K.M Nr. 395, datë 21.6.2006. "Për miratimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për zhvillimin e turizmit, kulturor dhe mjedisor"

- V.K.M Nr.435 datë 12.09.2002,"Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë"

- V.K.M Nr.267, datë 24.4.2003 "Për procedurat e propozimit dhe shpalljen e zonave të mbrojtura dhe buferike"

- V.K.M Nr.994, datë 02.07.2008 "Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin".

- VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve"

- VKM Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritëse"

- VKM Nr.114, datë 27.01.2009 për "Marrjen e masave emergjente, për përmirësimin e situatës së sigurisë dhe të veprimtarive në instalimet, që shërbejnë për depozitimin transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre".

- Vendim Nr.824, datë 11.12.2003 Për klasifikimin, ambulazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme

- Udhezim Nr.6, datë 27.12.2006, "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimeve në mjedis të një veprimtarie"



- Udhëzim Nr.6527.datë 24.12.2004,"Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyrat e kontrollit të tyre"

Shqipëria është një vend i cili është tashme nënshkrues i shumë konventave dhe marrëveshjeve mjedisore dhe kjo ka ndihmuar në taktin e hartimit të ligjeve kombëtare mjedisore në përputhje me praktikën ndërkombëtare. Ky raport duhet të pershtatet me ligjet dhe aktet ligjore në nivel lokal dhe ato kombëtare dhe me poshte ilustrohen në menyre të përmblodhur etapat kryesore të zhvillimit të politikës europiane në fushën e mjedisit .

- Protokollin e Kievit :Per vlerësimin strategjik mjedisor.Ratifikuar në vitin 2005
- Protokollin e Kartagjens:Per biosigurine .Bere pale në vitin 2005
- Konventa e Stokholmit:Mbi ndotesit organike te qendrueshem. Ligji nr. 9263, date 29.07.2004
- Protokollin e Kartagjens :Per sigurine biologjike .Ratifikuar në vitin 2004.
- Ligji nr. 9279, date 23.09.2004
- Konventa e Washingtonit:Per tregetine nderkombetare te llojeve te rrezikuara te flores dhe faunes se eger. Ligji nr. 9021, date 06.03.2003

### **Kuadri Ligjor European**

Raporti i VNM-se për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përjasë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat me kryesore :

- Direktiva e KE 1999/30/CE 22 Prill 1999, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit.
- Direktiva 2000/60/CE e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës,Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujrave.
- Direktivës KE 42/2001 (të Këshillit të Evropës), mbi VNMS dhe VSM.
- Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës (21 Maj 2008) "Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën".
- Direktiva 75/442/CEE e Këshillit e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.
- Direktiva 91/689/CEE e Këshillit e datës 12 Dhjetor 1991, Mbi Mbetjet e Rrezkshme.
- Direktiva 2001/42/CE e Këshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave të Planeve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin.
- Direktiva 85/337/CEE e Këshillit e datës 27 Qershor 1985, Mbi Vlerësimin e Pasojave të Disa Projekteve Publike dhe Private mbi Mjedisin.
- Direktiva e Këshillit 96/62/EC Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.
- Direktiva 1999/30/CE, Në lidhje me vlerat kufi për NO2, NOx, SO2, lëndët grimcore dhe Pbnë ajër.
- Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659 per cilesine e ujerave te embla
- Direktiva 99/61/CE Për gropat e mbetjeve.
- Direktiva 91/689/CE Për Mbetjet e Rrezikshme.

Referimet në nivel komunitar në fushën e menaxhimit të mbeturinave janë të shumta dhe për qëllimet tona është e dobishme të përzgjidhen ato me kryesoret.

Disa nga parimet themelore, parimet baze, që sugjerojnë linjat e veprimit dhe objektivat që përmbajnë programet komunitare,po i përshkruajme me poshte.:

#### **A. PARIMET KRYESORE.**

Referimi themelor juridik i Bashkimit European është themeluar nga "Traktati që krijon kushtetuten për Europën ,që dikton parimet themelore të Komuniteti European".Në kuader të mbrojtjes së mjedisit "Traktati" parashtron arritjen e disa parimeve që përmbledhen në menyre specifike në Seksionin e 5 të Mjedisit- Artikulli III-129 (ish artikulli 174 TKE) që sillet si më poshte në menyre të integruar.

1. Politikat e BE në fushën mjedisore kontribuojnë në arritjen e objektivave të mëposhtem:

- a) ruajtja,mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit;
- b) mbrojtja e shëndetit njerëzor;
- c) përdorim të shkathet dhe racional të burimeve natyrore;
- d) promovim në planin ndërkombëtar të masave për zgjidhjen e problemeve të mjedisit në nivel rajonal dhe hotezor





2. Politika e BE në fushën mjedisore synon në një nivel të lartë kujdesi, duke patur parasysh diversitetin e situatave në rajone të ndryshme të Bashkimit Europian. Është krijuar mbi parimet e masave paraprake të aksioneve të parashikuara, mbi parimin e korrektimit në mënyrë prioritare në burim të demove mjedisore dhe mbi parimin "kush ndot paguan".

3. Për të nxitur politiken në fushën e mjedisit duhet të kihet parasysh:

- a) të dhëna shkencore dhe teknike në dispozicion;
- b) kushtet e mjedisit në rajone të ndryshme të BE;
- c) avantazhet dhe përfitimet, që mund të rrjedhin nga veprimi ose mungesa e aksionit;
- d) nga zhvillimi social-ekonomik i BE në teresinë e tij dhe në zhvillimin e ekuilibruar të rajoneve të vecanta.

4. Në kuader të kompetencave respektive, BE dhe shtetet anëtare, bashkëpunojnë me vendet e treta dhe organizatat ndërkombetare kompetente. Modalitetet e bashkëpunimit të BE mund të krijojnë objekt marrëveshje midis tyre dhe të tremeve të interesuar.

Parimet baze ku mbështetet :

A. Parimi i Parandalimit. I futur në politiken mjedisore europiane, që nga programi i parë i veprimit si nevojë për të "evituar që në fillim ndotjen dhe shqetësime të tjera, para se të luftosh me vone efektet" mbi cilësinë e jetes dhe mbi ambientin, është zhvilluar në mënyrë të veçantë në programin e dytë të veprimit, që ka formuar bazën e traktateve (duke filluar nga akti i veçantë europian i 1986) me strukturën e udhëzimit komunitar mbi mbeturinat të 1975 të modifikuar në 1991.

B. Parimi "Ndotesi Pagan". Një parim i tillë i ardhur nga bota e ekonomisë, gjën mbështetje në mënyrë të gjere në fushën e ligjeve dhe përmban promovimin e iniciativave në fuqinë e përgjegjësisë civile. Një parim i tillë, i futur në nivelin ligjor të udhëzimit 94/62/CE mbi ambalazhet dhe mbeturinat e ambalazheve, është riafirmuar nga direktiva e re në këtë fushë (2004/12/CE), që parashikohet në mënyrë specifike në nenin 4, mundësia për të realizuar "projekte intensive për të paraqitur përgjegjësimin e prodhuesit". I njëjti parim ka njohtur një zhvillim të metejshëm në planifikimin e disa masave të përshtatura në nivel europian në lidhje me përdorimin e automjeteve, baterive, pajisjeve elektrike dhe elektronike, etj.

B. "Parimi i Nivelit të Lartë të Mbrojtjes Mjedisore". Koncepti i nivelit të lartë të mbrojtjes mjedisore fillimisht u paraqit nga Akti unik Europian (1986), në kuader të përkrahjeve që u takojnë tregjeve të vetëm, në relacion me masat përafëruese të legjislativave kombëtare; e cila gjeti konfirmim në Traktatin e Maastricht-it (1992) dhe me vone në Traktatin e Amsterdamin (1997).

C. "Parimi i subvencionit të Ndihmës Ekonomike". Siç është vendosur nga "Akti unik europian" dhe me pas nga "Traktati i Maastrichtit", në fushën mjedisore dhe në mënyrë me specifike në sektorin e mbeturinave, vlen parimi tradicional i respektimit të nivelit normativ me të përshtatshëm të nderhyrjes.

E. Parimi i Menaxhimit pa Rreziqe për Mjedisin/Shëndetin Publik. , një rregull thelbësor në fushën e mbeturinave, përpara parashikohet në nenin 4 të udhëzimit të përkrahur, është absolutisht e ndaluar hedhja e mbeturinave në mënyrë të pakontrolluar që detyrimisht këto mbeturina duhet t'u nënshtrohen shërbimeve për shpërberjen, rikuperimin, ose trajtimin nga ana e vetë prodhuesit n.q.s është në gjendje ta bëjë.

F. "Parimi i integritetit." koncepti i nevojës për të integruar tematikë mjedisore në fushën e politikave të tjera komunitare ka qenë qartësisht i shprehur shumë herë në fushën e traktateve europiane. Në linjë të përgjithshme, bazuar mbi traktatin e Amsterdamin "nevojat relative me mbrojtjen e mjedisit duhen të integrohen në përcaktimin dhe implementimin e politikave dhe nderhyrjeve të BE".

Shqipëria ka firmosur shumë konventa dhe protokolle ku mund të përmendim disa prej tyre:

- Konventën e Aarhus për akses në informacion, pjesëmarrje të publikut në vendim marrje ambientaliste dhe akses të drejtësisë në çështjet ambientaliste, të ratifikuar me Ligjin Nr.8672, datë 26 tetor 2000.







- Konventën Ndërkombëtare "Për Përgjegjësinë Civile Për Dëmet Nga Ndotjet Me Karburant", 1992, Ratifikuar nga RSH me Ligj Nr.9293, datë 21.10.2004;
- Konventa mbi Ndotjen Atmosferike në distanca të mëdha, Gjenevë, Zvicër, me 13 nëntor 1979.
- Konventa për Ruajtjen e Florës dhe Faunes së egër dhe mjedisit natyror të Europës në Bernë, 19 shtator 1979
- Konventën e Rio De Janeiro-s për Biodiversitetin, të ratifikuar me 10 Nentor 1996,

Qellimet e hartimit të VNM-se dhe metodat e përdorura për hartimin e saj Zgjedhja dhe hartimi i metodës me të mirë për të vlerësuar ndikimet është hapi themelor për të hartuar një VNM të një niveli të lartë. Praktika që ndiqet për hartimin e VNM-se konsistojnë në kërkimin e metodave me të mirë për vlerësimin e ndikimeve:

- Përbajtja dhe qëllimi i projektit
- Informacioni i disponueshëm për gjendjen ekzistuese të mjedisit të zones
- Niveli i përkjes së mendimit në të cilin ka arritur ideja për zbatimin e projektit, para se të hartohet VNM-ja.

Në hartimin e një VNM-je mund të përdoren për vlerësimin e ndikimeve metoda sasiore dhe cilësore. Nuk ka propozime specifike për metoda konkrete.

Kusht i domosdoshëm për vlerësimin e metodave sasiore është stadi i maturimit të projektit i cili përmban stadin e përcaktimit të burimeve të shfrytëzimit dhe të përcaktimit të punimeve dhe të veprimeve për zbatimin e projektit. Gjithashtu është e domosdoshme edhe mbledhja e informacioneve për gjendjen ekzistuese të mjedisit të zones para se të fillojë zbatimi i projektit. Kur njëra nga këto dy kushte nuk plotësohet atëherë kalohet në përzgjedhjen e metodave cilësore.

#### Permasat e ndikimeve

- + Kur aktiviteti ka ndikim të vogël pozitiv
- ++ Kur aktiviteti ka ndikim mesatar pozitiv
- +++ Kur aktiviteti ka ndikim të lartë pozitiv
- 0 Kur aktiviteti ka një ndikim asnjësor
- Kur aktiviteti ka një ndikim të vogël negativ
- Kur aktiviteti ka një ndikim mesatar negativ
- Kur aktiviteti ka ndikim të madh negativ

#### Kohe zgjatja e ndikimeve

- 1 Kur ndikimi ka një kohë zgjatje të shkurtër
- 2 Kur ndikimi ka një kohë zgjatje të mesme
- 3 Kur ndikimi ka një kohë zgjatje të përhershme





## 2. ZHVILLIMI RAJONAL SI DHE STUDIME TE REALIZUARA NE ZONEN NE RANG QARKU

### 2.1. Hyrje

Ritmet e zhvillimit ekonomik të vendit në këto vitet e fundit në të gjithë sektorët e ekonomisë janë në rritje. Për rrjedhojë rritja është pasqyruar edhe në disa sektore të transportit, dhe veçanërisht në transportin ujor, detar dhe liqenor.

Ky projekt do të zbatohet nga kontraktori që do të përzgjidhet konform. Meqenëse projekti mbulon një sipërfaqe të projektit rreth disa hektare, nga Pogradeci në Lin, ka një rëndësi të veçantë në strategjinë e menaxhimit të qëndrueshëm të ujit, duke qenë se liqeni është pikë e rëndësishme e faunës dhe florës. Gjithashtu, si dhe zonë me trashëgimi kulturorë, kandidate për nominim tek UNESCO.

#### Objektivat e zhvillimit rajonal të zones:

- Shkëmbime me autoritetet dhe komunitetin në fushën e menaxhimit të qëndrueshëm të ujrave dhe zhvillimit bujqësor të zonës.
  - Rritja e kapaciteteve mbi metodat e konservimit të rrjedhave natyrore të ujit, metodave të trajtimit të tij, ujëtja dhe kullimi eficient, adaptimi me ndryshimet klimatike, vaditja me ujë të shiut, ruajtja e biodiversitetit, etj.
  - Përvetësimi i projekteve të planifikuara dhe projekteve të realizuara në Pogradec. (Ujësjellësi, Kanalizimet, WWTP i realizuar, Kanalet Kulluese, Bujqësi, Infrastrukturë, etj.)
  - Realizimi i një projekti për vaditjen eficiente të një parcele në fshatin Lin dhe reduktimin e ndotësve që vijnë nga Bujqësia, shoqëruar me relacionin teknik dhe librezën e masave.
  - Studim Fizibiliteti mbi përdorimin e burimeve ujore në Pogradec, Mbrojtja & Restaurimi i rrjedhave natyrore.
  - Vaditja Automatikë me Pikim (draft propozim për tu futur në standardet shqiptare të projektimit) si përdorimi më eficient i burimeve natyrore.
  - Përcaktimi i tipave më të mirë dhe më të përshtatshëm lidhur me WWTP, kanaleve kulluese, vaditëse, ndërtimi i rezervuarëve për grumbullimin e ujit të shiut.
  - Rilindja e teknikave tradicionale të përdorimit dhe konservimit të ujerave pa i ndotur ato.
  - Sugjerime për ndryshimin e sjelljes dhe trajtimit të ruajtjes së burimeve natyrore dhe biodiversitetit.
  - Krijimi i një strategjie për menaxhimin e qëndrueshëm të ujit për pjesën Shqiptare të basenit të Ohrit.
  - Bashkëpunim me organizatat Gauss dhe Grasaniica për krijimin e një strategjie ndërkufitare mbi menaxhimin e burimeve ujore për gjithë Basenin e Ohrit.
- Autoritetet lokale: Bashkia Pogradec dhe Lin

**Strategjite Rajonale e Strategjia Rajonale e Zhvillimit – Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit,** e miratuar në vitin 2005, përfaqëson përpjekjen e parë për të hartuar një Plan të Plotë për Zhvillimin Rajonal për Qarkun e Korçës. Strategjia bën një analizë të gjëndjes ekonomike dhe sociale të rajonit dhe thekson faktin se qarku i Korçës nuk është vetëm i pasur me burime natyrore dhe njerëzore, por gjithashtu ka dhe një pozitë gjeografike mjaft të favorshme çka i mundëson bashkëpunim ndërkufitar me Greqinë dhe Maqedoninë. Ky dokument thekson bashkëpunimin ndërkufitar si një mjet për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe social të rajonit. Turizmi dhe rigjallërimi i prodhimit industrial e bujqësor renditen si mundësitë më të mëdha për zhvillimin rajonal në këtë Strategji.





Pergatitja e strategjise dhe planeve te menaxhimit per peisazhin e mbrojtur tokesor/ujor te Pogradecit Preparation of Strategy and Plans - Protected Areas Management Plans, 2010., eshte financuar nga Bashkimi Europian.

#### Marreveshjet e bashkepunimit rajonale dhe nderkufitare:

- Marreveshje midis Qeverise se Maqedonise dhe Keshillit te Ministrave te Shqiperise per mbrojtjen dhe zhvillimin e qendrushem te liqenit te Ohrit dhe pellgut ujembledhes, 17 Korrik, 2004.

**Përshkrim i shkurtër i turizmit ne rajonin e Qarkut Korçe:** Trashëgimia kulturore tashmë është bërë pjesë e rëndësishme e turizmit kulturor, si rrjedhojë politikat janë orientuar duke e trajtuar këtë fushë në funksion të turizmit. Investime të rëndësishme janë kryer në Restaurimin e Qendrave Historike dhe Monumenteve të Kulturës në Voskopojë, Pazari i Korçës, Mozaikët e Linit. Si rezultat, numri i vizitorëve në parqe arkeologjike dhe muze kombëtarë është rritur gati 2.4 herë në krahasim me vitin 2008. Gjatë periudhës 2007–2012 Delegacioni Europian ka mbështetur një projekt me titull "Për Zhvillimin e Integruar të Teritorit të Voskopojës". Partnerët e projektit janë FERT Paris, Komuna Voskopojë, dhe zbatimi është kryer nga ADAD. Ky projekt ka synuar vlerësimin e burimeve të teritorit të Voskopojës për zhvillimin e turizmit, bujqësisë, ruajtjen dhe vlerësimin e trashëgimisë kulturore të sitit të Voskopojës, që ka çuar në krijimin e shoqatës Voskopoja, rritjen e prodhimit bujqësor e artizanal, vlerësimin e trashëgimisë dhe rritjen e numrit të turistëve në Voskopojë dhe shtrirjen e iniciativës në komuna të tjera si Drenovë e Vithkuq të Rajonit të Korçës. Zhvillimi i produkteve specifike turistike Rajoni prodhon një sërë produktesh bazuar në historinë, kulturën dhe traditat e tij si dhe pasuritë e tjera natyrore. Për ta sjellë Rajonin në standardet e duhura për zhvillimin dhe lulëzimin e turizmit, duhen krijuar dhe organizuar mirë atraksionet kulturore dhe sitet natyrore. Kjo pjesë bën rekomandime rreth produkteve që do pasurojnë ofertën për turizëm në Rajon. Këto padyshim nuk janë nisma të shumta, prandaj duhen zhvilluar nisma të tjera, e vlerësuar për përshtatshmërinë e tyre me zonën.

**Liqene dhe Gjeomonumente-**Liqeni i Ohrit është liqeni i dytë tektonik më i madh në Ballkan dhe një

nga liqenet më të mëdhenj në botë (me një altitude prej 693 m dhe sipërfaqe prej 349 km<sup>2</sup> (66% i përket Republikës së Maqedonisë dhe 34% Shqipërisë). Liqeni i Ohrit është propozuar si sit UNESCO me "Trashëgimi botërore kulturore dhe natyrore". Pozicioni nderkufitar i liqenit paraqet jo vetëm një sfidë të mëtejshme, por edhe mundësi për bashkëpunim.

**Shpella e Najazmes:** Ndodhet ne afërsi të fshatit Tushemisht 697m mbi nivelin e detit, përhn një shpellë karstike të formuar nga gëlqerorët e Triasit të sipërm e Jurasit të poshtëm. Është e gjatë deri në 12 m, e gjerë deri në 2m dhe e lartë deri në 3m. Në të ndodhen një koloni lakuriqësh nate. Legjenda e lidh me fenë. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike), didaktike, ekologjike dhe fetare. Vlerat e saj janë të karakterit vendor. Shpella e Pëllumbave Ndodhet në afërsi të fshatit Tushemisht dhe është një shpellë karstike. Prej saj del me zhurmë një burim karstik. Ka nevojë për rikonstruktim. Ka vlera didaktike, ekologjike etj. Erde nuk është eksploruar. Gojëdhëna flet për përmasa të mëdha. Shpella e Tushemishtit Ndodhet në fshatin e Tushemishtit dhe është një shpellë karstike me përmasa shumë të mëdha. Me parë njëqezit e përdorin për qëllime të ndryshme. Ka vlera didaktike, ekologjike, gjeologjike etj.





**Produktet Historike dhe Kulturore Trashëgimia kulturore Korçare** është një trashëgimi e pasur me vlera. Ajo përfshin vlera arkeologjike, urbanistike, arkitekturore, historike dhe inxhinierike. Gjithashtu, përfshin edhe trashëgiminë e luajtshme, objekte arkeologjike, monumentale, libra dhe dokumente, numizmatikë, almise dhe armë zjarri, prodhime artistike dhe sende të rralla. Ajo shprehet me rrënojat arkeologjike dhe ndërtesat e banuara, të cilat datojnë nga prehistoria deri në shekullin e fundit.

Lista e monumenteve është e hapur për përmirësime të vazhdueshme sipas parametrave të përcaktuar me ligj. Monumentet vuajnë nga efektet shkatërruese të dukurive natyrore, por dhe nga ndërhyrjet shkatërruese të njeriut. Monumentet vuajnë nga efektet shkatërruese të dukurive natyrore, por dhe nga ndërhyrjet shkatërruese të njeriut. Nga viti 1990 deri në vitin 2000 nuk ka pasur mjaft financime shtetërore për monumentet. Gjatë kësaj periudhe një sërë monumentesh janë dëmtuar në mënyrë të pakthyeshme. Nga ana tjetër është rritur së tepërmi bashkëpunimi me donatorët vendas e të huaj, si dhe me pushtetin vendor. Kjo frymë vazhdoi edhe në vitet në vijim ku bashkëpunimi sidomos me organizma të huaj prestigjiozë mori përmasa të qëndrueshme. Përmendim këtu Patrimoine sans Frontieres, Komisionin Evropian me projektet IPA Ndërkufitare, Ambasadën Gjermane, Rajonet italiane me projektet INTERREG, etj. Ky lloj qëndrimi ndaj monumenteve e shtoi financimin direkt, duke rritur jo vetëm sasinë, por duke siguruar edhe një ndërhyrje më të specializuar, të siguruar nga organizma prestigjiozë si listimi i Voskopojës në Listën e Pasurive Botërore të Rrezikuara, si dhe së fundmi përgatitja e **Dosjes së Pogradecit** për t'u renditur në **Listën e Pasurive Botërore**, tregojnë vlerat universale të këtyre siteve. Përveç ndërtimeve dhe ansambleve ndërtimore, specialistët e monumenteve tregojnë kujdes edhe për punimet e drurit, gurit, metaleve, qeramikës, afresket, ikonostaset, një tjetër pasuri e madhe e kombit shqiptar.

**Kishat dhe Xhamiat:** Një përzgjedhje e ndërtesave arkitektura dhe vlerat e të cilave një mund të shijohen nga turistët që vizitojnë rajonin.

- Kisha e Shën Kollit ndodhet në qendër të fshatit Voskopojë, është e ndërtuar në vitet 1721 dhe 1722. Në kishë ruhen afreske të vjetër që prezantojnë afër 1000 figura biblike. Brendësia e kishës u pikturua nga njëri prej artistëve shqiptarë të kohës, David Selenicasi. Hajati i kishës është pikturuar nga 2 piktorë të shquar të tjerë të të njëjtit shekull, nga 2 vëllezërit korçarë, Konstandin dhe Athanas Zografi në vitin 1750. Këta artistë kanë punuar kishat më të rëndësishme të kohës, deri në Malin Athos, vendin e shenjtë të ortodoksisë.
- Kisha e Fjetjes së Shën Mërisë, edhe kjo kishë ndodhet në qendër të fshatit Voskopojë. Konsiderohet si Katedralja e qytetit të vjetër. Është ndërtuar në vitin 1712. Këmbanorja në hyrje të saj është ndërtuar në vitin 1887 me kontribut të të kamurve të fshatit. Kisha u dëmtua shumë nga dy luftërat botërore, por sidomos nga tërmeti i vitit 1960. Megjithatë në të janë kryer punime të rëndësishme restauruese.
- Kisha e Shën Thanasit ndodhet në pjesën e pasme të fshatit Voskopojë në afërsi të varrezave. • Edhe kjo është restauruar. Është ndërtuar në vitin 1724 dhe është pikturuar nga të famshmit Vëllezërit Zografi në 1751.
- Manastiri i Shën Prodhomit (Pugëzorit) kisha më e vjetër, e cila ka trajtën e kryqit me kube, është ndërtuar rreth viteve 1632- 1634, ku ruhen afreske me vlera botërore dhe njëkohësisht tregojnë nivelin e lartë të mjeshtrave që janë marrë me zbulimin e mureve të tyre.
- Kisha e Shen Merise & Kisha Ringjallja. Pogradeci ka Kishën e vjetër ortodokse, që quhet kisha e Shën Mërisë dhe ndodhet në lagjen e vjetër të Pogradecit, si dhe një kishë të re, me arkitekturë shumë të veçantë të quajtur Ringjallja.





Zejtaria është zhvilluar qysh në kohërat e hershme dhe nga mbetjet arkeologjike ne arrijmë të kuptojmë shkallën e mjeshtërisë së zejtarëve të lashtë që shfaqen te punimet e bronzit, qeramikës, armët dhe almiset. Në fshatin korçar tradita e punimit dhe e zhukurimit të objekteve të vogla prej druri nga vetë fshatarët për nevoja të jetës së përditshme, aty-këtu, u ruajt e gjallë edhe në gjysmën e parë të shekullit XX. Në shekujt XIII-XIX, kemi ekzemplarë gdhëndjesh në dru, si interiore ndërtesash kulti, interiore hanesash fshatare e qytetare, etj. Edhe sot, ruhen objekte argjendi me mbishkrime të datuara e me prejardhje nga qendra e mirënjohur qytetare e Voskopojës, etj. Në rajonin e Korçës tekstilet e leshta, të ekzekutuara me një varg teknikash të ndryshme pune, përdoreshin gjerësisht dhe ruanin shumë karakteristika lokale. Njihen gjithashtu thurjet e ndryshme me shtiza, e sidomos qendisjet me fije mëndafshi ose ari.


Pas viteve '90 ndodhën ndryshimet e mëdha demokratike dhe vetëm në vitin 1993 sektori filloi të merrte frymë sërish. U rishfaqën subjektet e para që merrreshin me punimin e hekurit, drurit, qeramikës, gurit etj. Gjatë periudhës nga 1995-2005 pati përpjekje për mbështetjen e biznesit të vogël. Pjesa më e madhe e prodhimit të tyre shkon për tregun vendas dhe për turistët që vizitojnë Shqipërinë. Një pjesë e vogël e tyre kanë gjetur tregje të huaja. Disa nga problematikat që shfaq kjo fushë: teknologjia është e vjetër; tradita është tepër familjare; ka pak produkte të reja; të ardhurat nga sektori janë të pakta; organizimi në shoqata është në një shkallë të ulët (njihet p.sh Shoqata e Artizanëve Duarte e Arta)

Gjithashtu: produkti i artizanatit shkon me vështirësi tek blerësi: është i pazhvilluar aspekti menaxherial, komunikativ, financiar, markëtues dhe hulumtues; nuk ka politika vendore për nxitjen e artizanatit; nuk ka investime për teknologji dhe pajisje të reja; nuk njihen modele bashkëkohore. Veshjet popullore janë një nga manifestimet më të fuqishme të kulturës tradicionale. Ato trashëgojnë e transmetojnë shumë elementë, që vijnë nga lashtësia dhe nga koha e mesme, por janë njëkohësisht janë edhe shprehje e marrëdhënieve kulturore me popuj të tjerë. Në veshjet për burra, tipi më i përhapur deri në fund të shekullit XIX ka qenë veshja me fustanellë e cila më vonë u zëvendësua me poture. Në veshjet për gra tipi më i përhapur ishte me këmishë të gjatë e një përparje. Karakteristike për veshjen e grave korçare janë brezat e paftat metalike me dekoracione të larmishme.

Kuzhina Tradicionale e rajonit është e mirënjohur në të gjithë Shqipërinë për cilësinë dhe freskinë e saj, tradita korçare në gatim është, shumëllojshmëri, cilësi dhe servirje. Fshatrat pranë Liqenit ofrojnë pjata unike peshku si Korani nga Liqeni i Ohrit, Belushka e argjentë etj. Fshatrat ofrojnë pjata bazuar në trashëgiminë e tyre bujqësore, prodhimet Bio dhe burimet lokale. Është për t'u përmendur byreku ose lakrori me dy petë i pjekur në saç, gatimi i peshkut krap, cironkat e famshme si dhe gatimi i kafshëve të egra dhe shpendëve. Gjellët karakteristike korçare janë: petanik me fasule, lakror, përvëlak i ardhur, lakror me qumësht, kërnacka etj. Në tavolinat Voskopojare mund të shijosh lakrorin në saç, mishin e pjekur në hell të shoqëruar me raki kumbulle të egër. Por ka dhe një gamë të gjerë produktesh që ofrohen në Voskopojë si petkam nardenm raki, bulmet si qumësht, djath, gjizë, kos, gjalp, gatime të ndryshme dhe perime të konservuara.

#### Poetë, Shkrimtarë dhe Piktore

**LASGUSH PORADECI** - L Lazar Sotir Guslo i njohur nën pseudonimin Lasgush Poradeci, lindi më 27 dhjetor të vitit 1899 në Pogradec, poet dhe shkrimtar shqiptar. Lasgush Poradeci e jetoi Rilindjen në periudhën e shpërthimit të kryengritjeve të mëdha për liri. Në veprën e këtij romantiku të fundit të letërsisë sonë jetoi shqetësimi atdhetar i mbrojtjes së kombit dhe të traditës së Rilindjes, ashtu sikurse edhe dëshira për triumfin e pikë- pantjeve demokratike, shqetësimi për një emancipim të përgjithshëm kulturor e shpirtëror të shoqërisë shqiptare. Ai është nga lirikët





tanë më të mëdhenj, i cili u shqua për sensibiliterin dhe ëmbëlsinë poetike me të cilën i këndoi Shqipërisë dhe dashurisë.

**MITRUSH KUTELI** - Dhimitër Pasko i njohur me pseudonimin Mitrush Kuteli lindi më 13 shtator 1907 në Pogradec. Ka qenë shkrimtar, përkthyes dhe ekonomist shqiptar. Kuteli shkroi artikuj mbi Naimin, Çajupin, Gramenon, Papa Kristo Negovanin, Asdrenin, Hilë Mosin, Lasgushin, Loni Logorin, Filip Papajarin, Ali Asllanin, etj. Me pseudonime të ndryshme botoi artikuj mbi çështjen e Bjeshkës së Velipojës të Vermoshtit dhe mbi Manastirin e Shën Naumit.

**VANGJUSH MIO** ishte piktori i parë impresionist në Shqipëri. Ai njihet më së shumti për peisazhet dhe konsiderohet si peisazhisti më i përkryer shqiptar i shekullit XX.[1] Temat e tij të parapëlqyera i merrte nga Korça, Pogradeci dhe rrethinat, por ai përjetësoi në punimet e tij edhe qytete të tjera si Tirana, Elbasani, Himara, Berati dhe Gjirokastra. Përveç peisazheve, Mio ishte brilant edhe në pikturimin e portreteve. Gjatë 40 viteve karreirë të lavdërueshme ai realizoi mbi 400 vizatime dhe 130 piktura. Rreth 60 punime të tij mund të admirohen në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë. Festivale dhe Ngjarje Kulturorë Rajoni i Korçës po fiton një reputacion si Rajon i festivaleve dhe ngjarjeve kulturore. OJQ dhe iniciativa të ndryshme mbështesin një sërë ngjarjesh kulturore të cilat janë të financuara nga të dy burimet publike dhe private. Ngjarjet më të rëndësishme janë: Festa Popullore Shën Prodhomi është një festë fetare kryesore që bëhet çdo vit në 24 qershor tek Manastiri i Shën Prodhomit në Voskopojë. Në këtë festë vijnë shumë vizitorë, numër që mund të arrijë deri në 10 mijë, të cilët pas kryerjes së riteve fetare qëndrojnë një natë në natyrë dhe festojnë me familjet dhe të afërmit e tyre.

#### **Aktivitete turistike**

Festa e Verës organizohet në qytetin e Pogradecit. Të gjithë prodhuesit tradicionalë të saj prezantojnë produktet e tyre në një organizim të përvitshëm të shoqëruar me një panair të gatimeve tradicionale. Përveç vendasve nuk mungojnë në festë edhe mysafirët nga qytetet e tjera të vendit. Festa e verës zgjat dy ditë, në fund të të cilave një komision i posaçëm degustuesish shpall verën fituese. Festivali European i Kukullave i pagëzuar "Xinxifillua", organizohet çdo vit në Pogradec me pjesëmarrjen e trupave teatrore nga i gjithë rajoni.

Të dhënat nga MTKRS tregojnë se Maqedonia është tregu më i madh që gjeneron turistë për Shqipërinë, e që ndiqet në vend të dytë nga Kosova. Këto tregje kanë pësuar rritje gjatë viteve të fundit për shkak të stabilitetit në rritje të Kosovës dhe tensionimit të marrëdhënieve ndërmjet Maqedonisë dhe Greqisë. Vihet re një rritje e turistëve sllavë maqedonas të cilët kanë filluar të zbulojnë cilësitë dhe çmimet e favorshme të turizmit shqiptar. Shqiptarët etnik që jetojnë në vende të tjera. Këta përfshijnë komunitetet shqiptare në SHBA, Kanada, Gjermani, Britani, Itali, Francë, Australi dhe Lindjen e Mesme. Vlerësohet që janë rreth 1.8 milion njerëz me prejardhje shqiptare që jetojnë jashtë Shqipërisë. Vlerësohet që 1.000.000 shqiptarë jetojnë në vende të BE-së si Britani e Madhe, Gjermani, Zvicër, Suedi, Itali, Austri dhe Francë pjesa më e madhe janë vendosur aty pas viteve 1991. Që nga viti 1920 janë rreth 1000 shqiptarë të vendosur në Australi. Në censusin e vitit 2006, statistikat treguan që kishte rreth 2000 Australianë të lindur në Shqipëri, dhe rreth 11 000 Australianë.

#### **PERSHIKRIMI I PROJEKTTI**

##### **2.2. Te përgjithshme**





**Projekt-ideja:** REHABILITIMI I BREGUT TE LIQENIT TE OHRIT DHE GJELBERIMI

**Vendodhja:** Përgjatë rruges segmenti Lin - Pogradec, Bashkia Pogradec, Rrethi Pogradec (Qarku Korçë)

#### **Te dhena te pergjithshme:**

Projekti që propozohet ndodhet pikerisht përgjatë bregut të liqenit të Ohrit dhe rruges nacionale që lidh pjesën juglindore të Shqipërisë me Tiranën. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit e zonës në studim është 695 m.

Segmenti i marrë në studim fillon që nga fshati Lin dhe kalon përgjatë gjithë bregut të liqenit deri në hyrje të qytetit të Pogradecit.

Projekti i Rehabilitimit të gjelberimit është ndërtuar i mbështetur tek planimetria e rruges që është në ndërtim. Janë përdorur po të njëjta seksione tërthore të rruges në baze të cilave është shtuar edhe pjesa e mbetur e terrenit që do të rehabilitohet.

Territori i marrë në studim është në kushte topografike të një terreni pothuajse të rrafshët, me një pjerrësi të lehtë. Toka është e mbuluar me bimësi të ulet tokash të lagështa bregliqenore të llojit gjineshtra e shkurre.

Struktura strategjike parashikon një numër hapësirash ku mund të mbledhen njerëzit, duke krijuar një paralele me skemen e molit ekzistues. Plani i ri kombinon në mënyrë efektive hapësirat që kanë akses publik, në të cilat do të organizohen aktivitete të ndryshme. Vija e plazhit ofron një zonë argëtimi në të cilën përfshihen një zonë për nisjen e varkave, anijeve, hapësira ankorimi të perkohshëm, etj.

Parimet e peizazhit të vijës së plazhit janë:

- Të forcohet vijueshmëria e vijës publike të plazhit dhe Liqenit të Ohrit.
- Të zhvillohet një lidhje e fortë mes komunitetit dhe vijës së plazhit.
- Zonat e argëtimit të vendosen aty ku mund të arrihen lehtësisht.
- Të ruaje hapësirat si një karakteristikë kryesore e vijës së plazhit.
- Të ofrojë hapësirë të mjaftueshme parkesh ndërkohë që rritet densiteti i ndërtimeve në vijën e plazhit dhe zonave të gjelbërta.
- Të mbrojtë brezin e pishave të cilat krijojnë vijën e plazhit dhe zonës së urbanizuar.


### **2.3. Metodologjia dhe koncepti i ndërhyrjes**



Projekti është fokusuar ne rehabilitimin e bregut te liqenit te Ohrit duke parur si fokus kryesor pastrimin e mbetjeve te ngurta pergjate gjithe gjatesise se bregut, krijimin e zonave te gjelberuara si dhe krijimin e disa zonave rekreacioni per banoret dhe turistet pergjate bregut te liqenit te vendosura ne planimetri si me poshte.



Figure 1: Horografia me objektet (Orthophoto View)







Kilometrazhi i objekteve i referohet kilometrazhit të rruges së ndertuar nga Lin në Pogradec.

Ne km 5+734 ndodhet objekti i parë i projektuar, **Exchange – Market në Buqezë**. Objekti është projektuar pranë rruges nacionale duke krijuar korsite perkatese të ngadalesimit dhe përshpejtimit. Struktura e përdorur është metalike me trare dhe kolona IPE, themelet janë të tipit plint të vecuar, mbulimi me llamarinë betoni të vlezuar. Fasada është menduar të jetë kryesisht transparente duke përdorur një rrjetë metalike të galvanizuar dhe në zonën e dyqaneve do të ketë dhe dritare duralumini me dopjo xham. Përreth zonës së Exchange-Market terreni do të sistemohet duke u gjelberuar me peme dhe bar. Funkcioni i Exchange-market do të jetë kryesisht krijimi i një njesie tregtare me dy dyqane, si vendqendrim për biciklistet.




Figure 2: Planimetria e Exchange – Market Buqezë





Figure 3: Pamje e Exchange-Market Buqeze

Ne km 6+419 ne afersi te fshatit Buqeze ndodhet objekti i dyle **Lookout Yellow**. Kjo eshte nje strukture e konceptuar per te krijuar nje pike vrojtimi drejt liqenit te Ohrit. Struktura eshte prej betonarme e mbeshtetur mbi pilota kjo per efekt te hapësires 11m e cila nuk toleron ceidme te struktures. Me poshte jepet dhe planimetria e objektit.



Figure 4: Pamje e lookout




Figure 5: Planimetria e Lookout Yellow

Struktura ka dhe një dalje konsol drejt liqenit, gjatësia e konsolit është 3m. Në pjesën e përparme janë vendosur tre xhama me ngjyrë të verdhë të temperuar (sipas specifikimeve) për të krijuar një tjetër panoramë të liqenit. Struktura është e ndricuar dhe mund të përdoret dhe gjatë orëve të natës.

Në km 7+820, në afërsi të fshatit Piskupat, ndodhet një tjetër **Exchange-Market**, me karakteristika të njëjta me Exchange-Market-in e përshkruar më sipër. Dhe në këtë zonë është harmonizuar gjelberimi egzistues me ato të propozuar, janë përdorur plepa (*Populus pyramidalis*), Pisha (*Pinus halepensis*), meshtekne (*Betula alba*), hidrombjellje e zonës përreth me bar si dhe rehabilitim i plazhit egzistues duke e pastruar dhe duke hedhur zhavor të imet. Pjesa e parkimit është trajtuar me pllaka betoni.





Figure 6: Pamje 3D e Exchange Market Piskupat





Figure 7: Planvendosja e exchange market Piskupat





Ne **km 9+109** ndodhet **Ohri Club 1**. Në gjendjen aktuale kjo është një zonë ku ka patur ndërtime që janë prishur, dhe kërkon rehabilitim. Në projekt janë parashikuar evadimi mbetjeve të ngurta dhe sistemimi i zonës me gjelbërim.

Në projekt kjo hapësirë është menduar të jetë në funksion të pushuesve. Hapësira që përfshin Ohri Club ndahet në tre zona:

- a- Zona e plazhit
- b- Zona për kamping
- c- Zona për parkim ku përfshihet dhe një ndërtesë (sailing club)




Figure 8: Planvendosja e Ohri club 1

Gjelbërimi në secilin nga këto zona është i ndryshëm duke iu përshtatur dhe funksionit për të cilin janë destinuar. Zona e plazhit ka Pinus nigra të cilat i rezistojnë kushteve atmosferike të zonës, zona e kampingut ka gjelbërim me Betula alba ndërsa zona e parkimit ka pemë plepi (Populus pyramidalis).

Në zonën e plazhit është parashikuar vendosja e një shtrese rere cilesore (sipas specifikimeve) që do të mundësojë krijimin e një plazhi të mirefillte. Zona e kampingut do të jetë e mbjelle me bar, ndërsa zona e parkimit do të jetë e shtruar me cakell sipas specifikimeve.

Në pjesën e kontaktit me liqenin do të ketë dhe struktura mbrojtëse nga ngritja e nivelit të liqenit si dhe nga dallgët e liqenit. Strukturat mbrojtëse janë të tipit skoliera.

Ndërtesa e sailing club është konceptuar si një strukturë metalike e mbështetur mbi një sistem traresh betoni të mbështetur mbi pilota me diametër 40cm. Pjesa metalike është projektuar me trure IPE dhe sistem kontraventimi. Mbulimi është bërë llmarine betoni të vlezuar.






Figure 9: Pamje e sailing club



Figure 10: Pamje e Ohri Club 3

Ne km 11+753 ndodhet **Ohri Club 2**. Ne menyre te ngjashme me Ohri club 1 dhe kjo eshte nje zone ne funksion te pushuesve ditore dhe atyre shetites me kamper. Gjelberimi dhe ne kete zone eshte zgjedhur me pisha (Pinus nigra) ne zonen e plazhit, meshtekna (Betula alba) ne zonen e kampingut dhe plepi (Populus pyramidalis) ne zonen e parkimit.






Figure 11: Planimetri e zones së Ohri club 2

Hyrje – daljet në këto zone janë zgjidhur duke parashikuar ndërtimin e korsive të pershpejtit dhe ngadalesimit.



Figure 12: Pamje e Ohri Club 2

Në km 15+040 ndodhet Exchange Market në afërsi të fshatit Hudenisht. Struktura e objektit është e njëjta ato të përshkruara më sipër. Zona përreth objektit është sistemuar duke integruar gjelbërimin me gjelbërim të ulët dhe të lartë. Gjelbërimi përbehet nga pemë të larta të tipit plop (Populus pyramidalis), qiparis (Cupressus sempervirens).






Figure 13: Planvendasja e Exchange Market Hudenisht

Vemendje i eshte kushtuar dhe rehabilitimit te bregut te liqenit duke hequr mbetjet e ngurta dhe duke hedhur nje shtrese zhavori te imet.





Figure 14: Pamje e exchange market Hudenisht

Ne km 16+982 ndodhet **Lookout Magenta**. Funkzioni i saj eshte i njejte me Lookout-et e pershkruara me sipër. Zona ne te cilen shtrihet ky objekt kerkon rehabilitim pasi ka patur ndertime te shumta.




Figure 15: Planimetria e lookout magenta





Ne kete zone jane parashikuar evadimi mbetjeve te ngurta sistemimi zones si dhe ndertimi i lookout-it ne afersi te liqenit.

Ne **km 19+741** ne afersi te fshatit Memelisht ndodhet nje tjetër **exchange market**. Objekti eshte projektuar prane rruges nacionale duke krijuar korsite perkatese te ngadalesimit dhe pershpjtitimit. Struktura e perdorur eshte metalike me trare dhe kolona IPF, themelet jane te tipit plint te vecuar, mbulimi me llamarine betoni te valezuar. Fasada eshte menduar te jete kryesisht transparente duke perdorur nje rrjete metalike te galvanizuar dhe ne zonen e dyqaneve do te kete dhe dritare duralumini me dopjzo xham. Perreth zones se Exchange-Market terreni do te sistemohet duke u gjelberuar me peme dhe bar. Funkzioni i Exchange-market do te jete kryesisht krijimi i nje njesie tregtare me dy dyqane, si vendqendrim per biciklistet. Zona perreth objektit eshte sistemuar duke ntegruar gjelberimin me gjelberim te ulet dhe te larte. Gjelberimi perbehet nga peme te larta te tipit plep (*Populus piramidalis*), qiparis (*Cupressus sempervirens*).



Figure 16: Pamje e exchange market Memelisht

### Ne **km 20+661** ndodhet **Ohri Club 3**.

Ne gjendjen aktuale kjo eshte nje zone ku ka patur ndertime qe jane prishur, dhe kerkon rehabilitim. Ne projekt jane parashikuar evadimi mbetjeve te ngurta dhe sistemimi zones me gjelberim. Pjesa e platformes ku do vendoset Ohri Club 3 ka disnivel rreth 4m nga rruga automobilistike Lin-Pogradec. Zbritja ne nivelin e platformes se Ohri Club eshte bere me ane te nje rampe e cila pjeserisht eshte e ndertuar.

Ne projekt kjo hapesire eshte menduar te jete ne funksion te pushuesve. Hapesira, qe perfshin Ohri Club ndahet ne tre zona:

- a- Zona e plazhit



- b- Zona për kamping
- c- Zona për parkim ku përfshihet dhe një ndërtesë (sailing club)

Gjelbërimi në secilën nga këto zona është i ndryshëm duke iu përshtatur dhe funksionit për të cilën janë destinuar. Zona e plazhit ka Pinus nigra të cilat i rezistojnë kushteve atmosferike të zonës, zona e kampingut ka gjelbërim me Betula alba ndërsa zona e parkimit ka peme plepi (populus pyramidalis).



Figure 17: Pamje e Ohri Club 3

Pjesa e Ohri Club ku ndodhet parkimi dhe kampingu është menduar të trajtohet si një shkallare e cila zbret nga niveli i parkimit dhe parkimit deri në liqen poshtë me shkalle, ndërsa pjesa tjetër është menduar të trajtohet si skoliere.

Në zonën e plazhit është parashikuar vendosja e një shtrese rere cilesore (sipas specifikimeve) që do të mundësojë krijimin e një plazhi të mirëfilltë. Zona e kampingut do të jetë e mbjellë me bar, ndërsa zona e parkimit do të jetë e shtruar me çakëll sipas specifikimeve.

Në pjesën e kontaktit me liqenin do të ketë dhe struktura mbrojtëse nga ngritja e nivelit të liqenit si dhe nga dallgët e liqenit. Strukturat mbrojtëse janë të tipit skoliere.

Ndërtesa e sailing club është konceptuar si një strukturë metalike e mbështetur mbi një sistem traresh betoni të mbështetur mbi pilota me diametër 40cm. Pjesa metalike është projektuar me trare IPE dhe sistem kontraventimi. Mbulimi është bërë llmarine betoni të vulezuar.



Ne km 20+908 është projektuar një park si dhe një zone plazhi.



Figure 18: Pamje e parkut të projektuar

Ne gjendjen aktuale zona paraqitet e degraduar dhe është shndërruar në një varrezë makinash. Ndërtesat që janë ndërtuar janë në fazën e ndërtimit të karabinasë dhe nuk janë të suvatuara. Në këtë zonë është menduar të ketë gjelbërim të lartë me bime Mëshstekne (betula alba), si dhe gjelbërim me bar.

**Në km 22+085 ndodhet lookout cyan.**

Struktura është e ngjashme me lookout-et e përshkruara më sipër, dhe funksioni është i njëjti. Gjelbërimi ekzistues është i mjaftueshëm dhe është menduar të plotësohet kjo zonë me mbjellje me bar.



Figure 0-19 Pamje e lookout cyan



### 3. PERSHIKRIMI I GJENDJES MJEDISORE BAZE

Liqeni i Pogradecit ka vlera të larta të biodiversitetit. Liqeni njihet për praninë e specieve të rralla dhe për një numër të madh specimesh endemike. Liqeni ka gjithashtu vlera të mëdha kombëtare dhe ndërkombëtare për shkak të trashëgimisë kulturore specifike që ka zona.

#### 3.1. Klima

Klima e territorit tokësor/ujor të Pogradecit është e tipit kontinental lokal, me një temperaturë mesatare vjetore prej 11.4°C. Temperaturat mesatare mujore arrijnë rreth afërsisht 21.2 gradë në Korrik dhe Gusht, ku maksimumi arrihet në gusht me 34.4 gradë. Temperatura mesatare më e ulët është gjatë Janarit, rreth 1.5 °C, me një minimum prej -17.2°C.

Rreshjet janë një prej faktorëve kryesorë që influencojnë regjimin klimaterik të zonës. Rreshjet e shiut variojnë gjatë vitit dhe luajnë një rol të rëndësishëm në balancën e ujit të liqenit dhe pellgut të tij ujëmbledhës. Niveli më i lartë i reshjeve normalisht shënohet në Nëntor-Janar dhe në pranverën e vonë, zakonisht në maj. Rreshjet arrijnë nivelin më të ulët gjatë Korrikut dhe Gushtit. Rreshjet mesatare të shiut në vit në basenin e liqenit shkojnë afërsisht 759 mm.

Era më e shpeshtë është ajo që fryn nga veriu, sidomos në vjeshtë dhe dimër. Erërat që fryjnë nga jugu dhe juglindja dominojnë gjatë pranverës dhe verës. Erërat e juglindjes dhe lindjes janë të konsiderueshme. Periudhat e qeta dhe me erë ndryshojnë gjatë ditës, veçanërisht në verë. Mëngjeset karakterizohen nga luhatjet mes erërave që fryjnë nga veriu dhe periudhave të qeta. Kushtet e motit ndryshojnë mjaft pasditeve, kur qetësia prishet nga erërat e jugut dhe juglindjes. Shpejtësia mesatare e erës në rajonin e Ohrit është relativisht e ulët, 3.4 m/sek

#### 3.2. Gjeologjia & Gjeomorfologjia

Liqeni i Pogradecit është formuar rreth 2-3 milionë vjet më parë dhe është një prej liqeneve më të vjetër në botë. Liqeni ka origjinë tektonike, i përket periudhës gjeologjike terciare si pak liqene të tjerë në botë. Vetë liqeni i Ohrit është i formuar mbi një strukturë me orientim meridianor dhe shtyrje horizontale përgjatë lidhjes kryesore ndarëse tektonike: Bilisht – Korçë – Dibër. Forcat tektonike kanë formuar një pjesë të konsiderueshme të terrenit të pellgut ujëmbledhës të liqenit të Pogradecit.

Struktura e shtyrjes shkëmbor të zonës së pellgut ujëmbledhës përfshin shkëmbinj të llojeve, përbërjeve dhe moshave të ndryshme, kryesisht shkëmbinj metamorfik paleozoik dhe magmatik. Përbërjet mezoike datojnë qysh në Triasik dhe kanë dy lloj faqesh: sedimente konglomerate karstike, rërë, argjilë dhe sedimente karbonatike si gurë rrasash, depozita qymyri, gur gëlqeror dhe dolomite, duke krijuar rrugë kalimi për ujin nëtokësor mes pjesëve të konsiderueshme të Malit të Thatë.

Sedimentet cenozoike përbëhen nga shtresa të Pliocenit dhe Kuarternarit. Sedimentet e Pliocenit gjenden në pjesën veriore dhe perëndimore të Luginës së Prespës.





Zona e Pogradecit është e pasur sidomos sa u përket formacioneve gjeologjike. Në këtë zonë janë të pranishme pothuajse të gjitha llojet e formacioneve shkëmbore si: a) karbonate, b) magmatike dhe poroze.

- 1- Formacionet e karbonateve përfaqësohen nga gurët qëlqerorë dhe dolomitet, të cilat janë të pasura me faunën e çdo epoke shpjeguar më poshtë. Formacionet e flishit janë të pranishme në këtë zonë, por jo të shpërndara gjerësisht. Së bashku, karbonatet janë të pranishme në formacione të tjera si shiste argjilore, konglomerate, gurë qëlqerorë silicorë dhe argjilë. Këto formacione mbulohen nga një shtresë himësie që arrin nga 0.2-0.5m në disa metra në vendet ku këtë e lejon ndërtimi gjeomorfologjik. Shpërndarja e tyre në zonë nuk është uniforme.
- 2- Formacionet magmatike përfaqësohen kryesisht nga shkëmbinj të ofiolite dhe vullkano- sedimentare. Ato zënë një sipërfaqe të konsiderueshme të zonës. Trashësia e shtresave tokësore të bimësisë mbi këto formacione është zakonisht nga 0.5-1.5m për shkak të mungesës së pyjeve dhe pjerrësisë së madhe të shpateve. Shpërndarja e tyre në zonë nuk është uniforme.
- 3- Formacionet poroze (Kuaternari-K). Këto formacione përfaqësohen kryesisht nga sedimentet aluviale-proluviale të liqenit, si rëra, zhavorri, llumi dhe sedimentimet fluvio-glaciale si rëra, zhavorri dhe llum. Ato janë të shpërndara në të gjithë zonën në formën e aluvioneve, proluvioneve dhe deluvioneve. Trashësia e tyre në qendër të zonës arrin në 50-60m.

Bazuar në natyrën e formacioneve dhe në moshën e tyre gjeologjike, ato renditen si më poshtë:

#### **Karbonatet:**

**T3-J1** –Triasiku i Sipërm-Jurasiku i Poshtëm. Gurë qëlqerorë me megalodonte, gurë qëlqerorë stromatolite me O. Prekursorë, gurë qëlqerorë dhe dolomite.

**T1-2** –Triasiku i Poshtëm– i Mesëm. Shiste argjilore, gurë qëlqerorë amoniti dhe vullkanikë në zonën e Mirditës.

**S-D** – Silurian-Devonian. Shiste të zeza argjilore me graptolite, shiste argjilore dhe gurë qëlqerorë me krinoide dhe tentakulite.

**J3** –Jurasiku i Sipërm. Gurë ranorë ofiolite breça shtufi.

**T2** – Triasiku i Mesëm. Shiste argjilore, gurë qëlqerorë, gurë qëlqerorë të rrumbullakosur, gurë qëlqerorë silicozë, radiolaritete me shtuf.

- 2 **Pg<sup>2</sup>**-Eoceni i Mesëm. Gurë llumi argjilorë me gurë ranorë dhe flishe argjilore gurësh ranorë me

mergel dhe gurë qëlqerorë në nënzonën e Krastës, mergel, gurë qëlqerorë, konglomerate se argjilë, gurë llumorë, gurë ranorë, mergel dhe gurë qëlqerorë në basenet e brendshme.

**1b**  
**N1** - Burdigalian. Mergel, gurë llumorë të kalcifikuar, dhe gurë qëlqerorë litotamnik dhe makroforaminifer.



**Magmatik:**

**T2 - J1-** Triasiku i Mesëm-Jurasiku i Poshtëm. Ofiolite, kryesisht formacione vullkano-sedimentare.

**σJ2** - Jurasiku i Mesëm. Dumite.

**σJ2** - Jurasiku i Mesëm. Plagioklase, iherzolite.

**σJ2** - Jurasiku i Mesëm. Olivin, hornblendite (periodite amfibole).

**σJ2** - Jurasiku i Mesëm. Sekuenca mbulimi kryesisht me përbërje hazburgite me trupa të rrallë dunitesh në pjesën e sipërme.

**σJ2** - Jurasiku i Mesëm. Hartzburgite mbulimi - iherzolite me interkalacione të rralla dunitesh në pjesën e sipërme.

**μJ2** -Jurasiku i Mesëm. Dhe metamorfik (amfibolite, paragneis, shiste gjysmë-kuarci)

**Cr2sen** - Senonian. Gurë gëlqerorë me hipurite, gurë gëlqerorë me globotrunkana, gurë gëlqerorë konglomerate.

**Porozë**

**Qp-h** - Pleistoceni- Holocene. Sedimente mikse aluviale-proluviale: rërë, zhavorr, llum.

**Qp-** Pleistoceni. Sedimente liqenore alluviale-proluviale; llum, rërë, zhavorr.

**Qp-** Pleistoceni. Sedimente proluvial-alluviale; rërë, zhavorr.

**Qp-** Pleistoceni. Sedimente fluvio - glaciale.

**Qp-** Pleistoceni. Sedimente deluvionale - koluvionale. **Qp-** Pleistoceni. Sedimente proluviale; rërë, zhavorr. **Qp-** Pleistoceni. Sedimente aluviale; llum, rërë, zhavorr.

**N2-** Plioceni. Argjilë, gurë ranorë, zhavorr, konglomeratë, qymyrguri.

**J2-3-** Jurasiku i Mesëm-i Sipërm. Gurë gëlqerorë, çert radiolarite në pjesën e sipërme të ofioliteve të Xhurasikut dhe në pjesën e sipërme të karbonate-silicore në zonën e Mirditës.

**3.3. Hidrologjia**

**Liqeni i Pogradecit** është liqeni tektonik më i thellë në Ballkan (289 m, liqeni i 7-të më i thellë në Evropë). Ai ka një sipërfaqe prej 358.2 km<sup>2</sup> dhe vetëm 109 km<sup>2</sup> i përkasin Shqipërisë. Liqeni ndodhet 695 m mbi nivelin e detit.

Bregu i Liqenit të Pogradecit/Ohrit është 87.5 km i gjatë, nga të cilat 56 km i përkasin Maqedonisë dhe 31.5 km Shqipërisë. Vetë liqeni ka një gjatësi maksimale prej rreth 30 km dhe një gjerësi që varion nga 11.2 km në 14.5 km. Thellësia maksimale është 289 m, kurse thellësia mesatare 164 m.

Niveli i ujit të liqenit të Pogradecit ka rënë gradualisht me kalimin e kohës. Kjo duket edhe në tarracat përgjatë bregut të liqenit. Në breg dallohen 2-3 tarraca dhe ndoshta 5 në një pjesë të





bregut të liqenit, të cilat tregojnë nivelet e mëparshme të liqenit. Në pjesën veriore të liqenit në Maqedoni, është një terracë nën sipërfaqen e liqenit. Terracat përgjatë buzëve të liqenit përfaqësojnë disa nga fushat më produktive për bujqësinë (Bucimas, Lin, Struga, Ohër). Ishujt e hershëm të Lin-it dhe Ohrit tashmë janë shndërruar në gadishuj. Fusha e Lin-it mbart gjurmë të dukshme të origjinës së saj liqenore (sipërfaqet e lagështa dhe ngjyra e zezë e aluviumit).

Midis liqeneve të Pogradecit/Ohrit dhe Prespës, ndodhen Mali i Thatë dhe Malet e Galicica. Formacionet karstike të Malit të Thatë në Shqipëri dhe ato të Malit të Galicicës në Maqedoni janë tejet poroze, me një kapacitet të lartë për transportimin e ujit.

Për shkak të këtij poroziteti të lartë dhe përmbujtes së ujit, shkëmbinjtë e zonës Prespë-Ohër klasifikohen si akuifere poroze, karstike dhe akuifere të copëtuara.

Për shkak se këta dy liqene kanë një diferencë të nivelit të ujit prej 155m, dhe përbërja gjeologjike e kësaj zone konsiston në shkëmbinj karstikë karbonatë, është ngritur një hipotezë mbi një lidhje të këtyre dy liqeneve. Rreth 50% e ujit të burimeve të Shën Naumit dhe Tushemishtit në brigjet jugore të liqenit të Pogradecit/Ohrit vjen nga liqeni i Prespës.

Prandaj, liqeni i Pogradecit/Ohrit e merr ujin si nga prurjet e ujërave sipërfaqësore, ashtu edhe nga ujërat nëntokësore nga sistemi i liqenit të Prespës. Dy liqenat e Prespës, Prespa e Madhe dhe Prespa e Vogël, të cilat lidhen përmes një istmusi, përbëjnë sistemin e Liqenit të Prespës. Për shkak të këtyre lidhjeve unike, sistemi ujqor Prespë-Ohër është unik në botë.

### **Regjimi hidrik**

Regjimi hidrik i zonës karakterizohet nga një shpërndarje e parregullt stimore dhe hapësinore e reshjeve. Duke marrë në konsideratë reshjet, avullimin dhe lartësinë e zonës, totali i burimeve ujore karstike të këtyre maleve rezulton të jetë 5, 2 m<sup>3</sup>/sek ose 165, 2·10<sup>6</sup> m<sup>3</sup>/vit.

Masat kryesore ujore që derdhen në liqenin e Ohrit janë burimet e Malit të Galicicës, dhe ujërat sipërfaqësore që rrjedhin nga degët e tyre.

Prurjet më të rëndësishme në pjesën shqiptare janë ato nga burimi i Shën Naumit, lumi i Çërravës, burimet e Tushemishtit, lumi i Pogradecit dhe lumi i Vërdovës. Më poshtë jepen veçoritë hidrike të këtyre prurjeve:

**Burimet e Shën Naumit** ndodhen në bregun lindor të liqenit, afër kufirit Shqiptaro-Maqedonas. Uji i burimit vjen nga vargmali i Galicicës, si nga reshjet, ashtu edhe nga ujërat e liqenit të Prespës. Hulumtimet e prurjeve të burimeve janë hërë që në vitet 1949/50 në stacionin hidrik ku niveli i ujit monitorohet në mënyrë konstante. Gjatë vitit bëhen edhe matje direkte të rastit të prurjeve të ujit. Këto matje tregojnë se prurja nga burimet e Shën Naumit variojnë nga 4.0 në 12.0 m<sup>3</sup>/s, me një prurje mesatare Q=7.50m<sup>3</sup>/s. Prurja maksimale arrihet në periudhën midis Majit dhe Qershorit, kurse prurja minimale ndodh në fund të vjeshtës dhe gjatë periudhës së thatë, ose në periudhën midis Shkurtit dhe Marsit – minimumi i dimrit.

**Burimet e Tushemishtit** janë pjesë e burimeve nëntokësore masive të Galicicës – Malit të Thatë që derdhen në liqenin e Pogradecit/Ohrit. Matjet hidrike në burimet e Tushemishtit kanë filluar në vitin 1971. Prurjet mesatare afatgjata llogariten të jenë 2.5m<sup>3</sup>/s. Në liqenin e Pogradecit/Ohrit derdhet edhe një sasi uji përgjatë bregut të liqenit nga burimet e Shën Naumi deri në burimet e Tushemishtit (burime nënujore).

**Lumi i Çërravës** është lumi më i madh në anën shqiptare që rrjedh në liqenin e Pogradecit/Ohrit. Ai ndodhet në pjesën jugore të liqenit dhe rrjedh nga burime të ndryshme në







zonën malore të Gurit të Kamjes, në një lartësi 1538 m mbi nivelin e detit. Përgjithësisht, rrjedha është e drejtuar drejt lindjes deri në lshatin Çeravë, më pas, në veri, afër lshatit Lubanishte në anën maqedonase.

Pellgu ujëmbajtës i lumit të Çerravës në Shqipëri është 87 km<sup>2</sup>; ai është 18 km i gjatë dhe me një lartësi mesatare rreth 1100 m. dhe me pjerrësi mesatare të shpateve prej 20 %. Deri tani nuk është bërë ndonjë hulumtim hidrik i këtij lumi. Ka plane për ndërtimin e një stacioni hidrik në anën shqiptare të lumit të Çeravës si pjesë e Projektit të Ruajtjes së Liqenit të Pogradecit/Ohrit. Sipas studimeve të mëparshme hidrike në rajon dhe duke përdorur morfometrike rreth zonës ujëmbledhëse, prurja mesatare përllogaritet të jetë afërisht 1.5 m<sup>3</sup>/s.

**Lumi i Pogradecit** është një përrua i vogël që rrjedh përmes qytetit të Pogradecit. Zona e tij ujëmbledhëse është 10.6 km<sup>2</sup> dhe e ka origjinën nga malet rreth qytetit. Karakteristika kryesore e Lumit të Pogradecit është shpati i ngritur i shtratis të tij prej rreth 9.2%, gjë që përbën një kërcënim për qytetin e Pogradecit gjatë stuhive të mëdha. Për ta mbrojtur qytetin nga përmbytjet, shtrati i lumit është bonifikuar me beton në të gjithë sektorët urbanë.

Për lumin e Pogradecit ka të dhëna hidrike për periudhën 1974-1990. Këto të dhëna tregojnë për një prurje mesatare vjetore prej 0.250 m<sup>3</sup>/s. Edhe lumi i Verdovës është një përrua i vogël që derdhet në pjesën jugperëndimore të liqenit të Pogradecit/Ohrit. Pellgu ujëmbajtës i këtij përroi është 8.4 km<sup>2</sup>, i gjatë rreth 8 km dhe me një pjerrësi të shtratis prej 4.5 %.

Në anën shqiptare ndodhen edhe disa përrenj të vegjël të përkohshëm dhe burime të vogla me prurje mesatare vjetore prej deri 100 l/s (burimet e Linit).

#### Regjimi i nivelit të ujit të Liqenit.

Niveli i ujit të liqenit të Ohrit ka shumë pak luhatje. Maksimumi vjetor është vëzhguar nga fundi i pranverës, Maj-Qershor, kurse minimumi në Tetor. Ky fenomen tregon ndikimin e shkrirjes së borës. Në kushte normale, amplituda vjetore varion nga 30 në 80 cm. Luhatjet e nivelit të ujit nuk ndjekin regjimin natyror – ekstremet në nivelin e ujit nuk lejohen. Sipas një marrëveshjeje midis Ish Jugosllavisë dhe Shqipërisë të vitit 1962, niveli maksimal i ujit në liqenin e Pogradecit/Ohrit nuk lejohet të shkojë më shumë se 693 m mbi nivelin e detit, kurse niveli minimal i ujit nuk lejohet të hjerë nën 691.65 m mbi nivelin e detit. Porta në lumin e Drinit të Zi menaxhon derdhjen e ujit në daljen nga liqeni i Pogradecit/Ohrit.

#### 3.4. Habitatet në zonën e mbrojtur

Habitatet më të pasura në zonë janë trupat ujore (10,837.2 ha). Pyjet dhe toka pyjore (bimësia e shkurre dhe barishtore) zënë një sipërfaqe të konsiderueshme prej rreth 8,997.89 ha.

Zona bujqësore zë rreth 4,529.93 ha në zonën e mbrojtur dhe është e vendosur tipikisht afër lshatrave të banuar. Habitatet e kullotave dhe livadheve, të parat të përdorura kryesisht për kullota, zënë përafërsisht 1885.8 ha. Gjithsesi, ka një mbivendosje të të dhënave bujqësore dhe kullosore; në të vërtetë në disa vlerësime të përdorimit të tokës, zonat kullosore përfshihen në zonat bujqësore, në disa të tjera si kullota.

Të tjera lloje të përdorimit të tokës brenda peisazhit të mbrojtur përfshijnë: sipërfaqet jo produktive (përafërsisht 218.87 ha) dhe sipërfaqet ekonomike/industriale rreth 817.39 ha. Këto zona zënë një





sipërfaqe të kufizuar të sipërfaqes totale të zonës së mbrojtur. Megjithatë, këto shifra nuk përfshijnë fusha si shtytëzim minierash, zona të hedhjes së mbeturinave, troje ndërtimi etj., të cilat gjithashtu duhet të konsiderohen si urbane/industriale.

Një habitat i rëndësishëm, kryesisht i lidhur me shumimin e Koranit, është edhe habitat i kallamishteve (36.2 ha). Zona e kallamishteve ka rëndësi specifike lidhur me procesin e shtrimit të vezëve.

Vlen të përmendet se shifrat e paraqitura më sipër, siç kanë rezultuar nga verifikimet/vëzhgimet ndryshojnë ndjeshëm nga ato që paraqiten në VKM-në që përcakton peisazhin e mbrojtur (shih tabelën më poshtë).

**Tabela 24: Sipërfaqja sipas verifikimeve aktuale dhe VKM-se**

| Veçoria kryesore                                 | Sipërfaqja sipas verifikimeve aktuale (ha) | Sipërfaqja sipas VKM-së | Diferenca (+/- ha) |
|--|--|-------------------------|--------------------|
| Tokë bujqësore (arë, vreshta, frutore, pemishte) | 4,530                                      | 2,500                   | 2,030              |
| Tokë pyjore dhe shkurre                          | 8,998                                      | 10,24                   | -1,250             |
| Kullota dhe lëndina <sup>1</sup>                 | 1,922                                      | 1,377                   | 545                |
| Zona jo-produktive                               | 219  | 672                     | -453               |
| Zona industriale/ekonomike                       | 817  | 1,396                   | -579               |
| Trupat ujorë                                     | 10,83                                      | 11,14                   | -303               |
| <b>TOTALI</b>                                    | <b>27,32</b>                               | <b>27,32</b>            |                    |

Këto diferenca mund të shpjegohen me përdorimin për qëllime të ndryshme të territorit që nga viti 1999 kur edhe u shpall zona e mbrojtur, si dhe nga pasaktësitë e metodave të përdorura për llogaritjen e sipërfaqeve gjatë hartimit të VKM-së. Sidoqoftë, kjo pjesë e VKM-së ka nevojë për ndryshim.

Në ligjin nr.8906 dallohen gjashtë kategori të ndryshme që i korrespondojnë atyre të IUCN-se (BNRN). Kështu, Zona e Mbrojtur e Territorit Tokësor/Ujor të Pogradecit është e mbrojtur sipas kategorisë së pestë<sup>7</sup>. Sipas pikës 2 të nenit 6 të ligjit, në zonën e mbrojtur do të zhatohet niveli i katërt i mbrojtjes. Tabela 3 më poshtë jep një përmbledhje të aktiviteteve të ndaluara dhe të lejuara brenda zonës së mbrojtur.





Tabela 36: Aktivitetet e ndaluara e të lejuara brenda Peisazhit të Mbrojtur Tokësor/Ujor të Pogradecit

| KATEGORIA | ZONA E MBROJTUR    | NIVELI I MBROJTJES | AKTIVITETET E NDALUARA   | AKTIVITETET E LEJUARA   |
|-----------|--------------------|--------------------|--|---|
| V         | Peisazh i mbrojtur | Niveli i katërt    | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbjellja e pyjeve monokultu rë;</li> <li>• Neutralizimi i mbetjeve dhe ndezja e zjarreve jashtë vendeve të caktuara;</li> <li>• Përhapja e kafshëve dhe bimëve që vijnë nga jashtë vendit;</li> <li>• Gjuetia me ushqime të helmuara; Ndërtimi i rrugëve</li> <li>• automobilistike, kanaleve lundruese dhe zonave urbane;</li> <li>• Qarkullimi me mjete transporti jashtë rrugëve dhe vendeve të caktuara. Ky rregull nuk aplikohet për makinat shtetërore, makineritë bujqësore dhe pyjore, zjarrfikëset, ambulancat, dhe për makineritë e menaxhimit të mbetjeve dhe shërbimeve veterinarë;</li> <li>• Organizimi garave me makina, motoçikleta dhe biçikleta.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitete që ndryshojnë përdorimin e territorit;</li> <li>• Ndërtimet;</li> <li>• Përdorimi i kimikateve e pesticideve;</li> <li>• Trajtimi i ujerave të zeza në ferma, për zona me të mëdha se 2 ha;</li> <li>• Veprimtari të tjera, që nuk ndalohen shprehimisht nga ligji</li> </ul> |





Aktualisht ka një plan të përgjithshëm menaxhimi që të mbulojë gjithë Peizazhin e Mbrojtur të Pogradecit të miratuar me Urdhër të Ministrit të MM Nr.2026, datë 31.12.2014. Ekzistojnë në zbatim vetëm plane menaxhimi sektoriale (p.sh. Plani i Menaxhimit të Pyjeve, Plani i Menaxhimit të Peshkimit në Liqen). Plani pyjor nuk përfshin ruajtjen dhe menaxhimin e natyrës. Plani i Menaxhimit të Peshkimit në Liqen përfshin shfrytëzimin e qëndrueshëm të rezervave të stokut të peshkut e ekosistemit dhe kriteret e mbrojtjes së integritetit të diversitetit të peshqve unikë në liqen. Megjithatë, ndërveprimi midis planeve të ndryshme (planet territoriale rajonale, master-planet, planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura, etj.) nuk është i qartë, pasi në Shtator të 2015 do të ketë ndryshim në aktet ligjore dhe nenligjore mjedisore si dhe në fushën e pyjeve dhe menaxhimit të zonave të mbrojtura ujore dhe tokësore.

Për momentin, zona menaxhohet nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor në Pogradec, e cila përbëhet nga gjashtë persona. Pyjet ndahen në dy zona pyjore që menaxhohen nga dy ose tre Inspektorë të Policisë Pyjore dhe nga shefi i sektorit. Drejtoria e Shërbimeve Pyjore të Pogradecit është përgjegjëse për zbatimin e ligjit në zonën e mbrojtur.

Kryetarët e komunave, OJQ-të lokale, përfaqësuesit e sektorit privat lokal dhe popullsia lokale e zonës së mbrojtur kanë informacione të kufizuara në lidhje me zonën e mbrojtur, administrimin e saj dhe kuadrin ligjor: bashkëpunimi mes aktorëve lokalë është gjithashtu i kufizuar. Në shtator ndryshon struktura e menaxhimit të kësaj zone të mbrojtur me ndryshimin e ri të planifikimit të territorit.

**Habitatet pyjore:** Habitatet pyjor në peisazhin e mbrojtur përfshin disa nivele bimësie të mirëdalluara të bazuara në kushtet bio-fizike të zonës. Pyjet e lisit dominojnë kodrat lindore të peizazhit të mbrojtur dhe kodrat në rrezë të Malit të Thatë, ashtu si dhe pjesën e ulët të kodrave të liqenit deri në 1400 m.

Speciet e rëndësishme përfshijnë: Shparthin (*Quercus frainetto*), Bungëbutën (*Q. Pubescens*), Bulgërin (*Q. Trojana*), Bungën (*Q. Petrea*) dhe Qarrin (*Q.cerris*). Shkoza e zezë (*Carpinus orientalis*), Mëlleza (*Ostrya carpinifolia*), Frashëri gjethgjerë (*Fraxinus ornus*), Kulumbria (*Prunus spinosa*) dhe Panja (*Acer campestre*). Gjithsesi, një pjesë e madhe e këtyre zonave janë degraduar për shkak të prerjes së pyjeve të lisit; habitatet pyjor ka ndryshuar në drejtim të shkurreve të gjelbëruara të Bërsheni (*Juniperus foetidissima*), Dëllinja e kuqe (*J. Oxycedrus*) and Bushi (*Buxus sempervirens*). Në zonat më të ftohta, pyjet e lisit plotësohen edhe nga Frashëri i zakonshëm (*Fraxinus excelsior*) dhe Panja Italiane (*Acer opalus subsp. obtusatum*).

Sipërfaqet e gjera të pyjeve në Peisazhin e Mbrojtur Tokësor/Ujor të Pogradecit përfaqësohen sot kryesisht nga pyjet natyrore dytësore dhe pjesërisht nga pyjet jo-natyrore falë ripyllëzimit me Pishën e Zezë (*Pinus nigra*).

Sistemi tradicional i administrimit të pyjeve është sistemi i menaxhimit të cungishteve, i cili siguron të ardhura të shpejta nga zonat pyjore (Rotacioni i të korrave në pyjet e cunguara është 15-40 vjet). Sistemi i menaxhimit të cungishteve përdoret kryesisht për prodhimin e drurëve për zjarr dhe për prodhime të tjera.

Në lartësi më të mëdha se 1200 m në kodrat në perëndim të liqenit, peizazhi karakterizohet nga degradimi i pyjeve të ahut *Fagus sylvatica*, lajthisë *Corylus avellana* dhe Shkoza e zezë *Carpinus orientalis*. Gjithashtu, ky lloj pylli ndikohet shumë nga prerjet e pemëve dhe nga mbledhja e drurëve të zjarrit duke u shndërruar pjesërisht në shkurre dëllinje.





Pylli i gështenjave, *Castanea sativa* dominon shpatet me pamje nga veriu - në jug të Pogradecit dhe Buçimasit, kryesisht në kodrat afër Pogradecit, Verdovës, Gështenjazit dhe Leshnicës në një lartësi mesatare prej 700 deri në 1000 m. Në këtë zonë, pjesa më e madhe e pemëve të larta janë prerë dhe pylli është shndërruar tashmë në një sistem pylli të cunguar. Llojet e gështenjave njihen për vlerat e tyre të rëndësishme natyrore dhe komerciale. Pyjet janë menaxhuar tradicionalisht kryesisht për prodhimin e arrorëve.

Pylli i gështenjave në komunën Buçimas zë rreth 1400 ha, kurse në Pogradec rreth 600 ha. E drejta për të mbledhur gështenja në Buçimas është e ndarë në zona për secilën prej familjeve që jetojnë në fshatrat aty pranë. Pylli në Pogradec është nën administrimin e komunës, por një grup prej 12 familjesh pretendojnë se kanë të drejtën mbi 600 ha të pyllit të gështenjave.

Aktualisht, prodhimi mesatar është 100-150 kg për hektar. Përvoja nga e shkuara tregon se prodhimi maksimal mund të rritet deri në 600 kg për hektar. Prodhimi maksimal kërkon pemë të maturuara dhe ujë mjedis pyjor të hapur, me prerje selektive të pemëve dhe largim të pemëve të tjera të padëshiruara. Komuna Buçimas ka planifikuar të mbjellë në të ardhmen një pyll të ri gështenjash.

**Harta :** Harta e habitateve në Peisazhin e Mbrojtur Tokësor/Ujor të Pogradecit





**Habitati i tokave natyrore barishtore dhe kullotave:** Zona malore e Malit të Thatë karakterizohet nga male të larta, me bimësi malore dhe alpine ndërtuajt 1800 dhe 2288 m. Përdorimi kryesor i tokës është i lidhur me bagëtinë dhe grumbullimin e bimëve mjekësore dhe aromatike. Livadhet alpine dhe subalpine janë karakteristike dhe pjesë e florës tokësore të pellgut ujëmbledhës. Livadhet/kullotat alpine dominohen kryesisht prej *Arabis alpina*, *Asteri alpin* - *Aster alpinus*, *Achillea atrata*, *Bishtpelëza* - *Festuca sp.*, *Xhufka e drejtë* - *Nardus stricta*, etj. Kullotat subalpine dominohen kryesisht prej *Dëllinjës së zezë* - *Juniperus communis*, *Boronica* - *Vaccinum myrtillus*, *Potentilla e ngritur* - *Potentilla erecta*, etj.

Kullotat alpine dhe subalpine ofrojnë një gamë të gjerë specimesh, shumica e të cilave përdoren për vlerat e tyre kuruese. Bimët mjekësore më të zakonshme janë *Gentiana lutea*, *Urtica dioica*, *Origanum vulgare*, *Thymus serpyllium*, *Trifolium campestre*, *Rosa canina*, *Salvia officinalis*, etj.

**Fauna në habitatet tokësore:** Tokat kullimore, arat dhe arat e braktisura që të shndërruara në toka barishtore në afërsi të vendbanimeve dhe fshatrave, sigurojnë mbajtje të një numri të lartë specimesh zogjsh, më së shumti zogjve të vegjël (Rendi: *Passeriformes*/Harabelorët). Në dimër, fushat e hapura përdoren nga tufa trishtilash shoqëruar nga harabela të tjerë të vegjël. Në verë, fushat e hapura sigurojnë terrere shumëzimi për Shkurtën - *Coturnix coturnix*. Gardhet dhe pemët e ndryshme frutore në vendet e hapura vizitohen nga Gushëkuqi - *Erithacus rubecula*, Cerla e zakonshme - *Miliaria calandra*, Harabeli - *Passer domesticus*, Cerri - *Troglodytes troglodytes*, lauresha (*Alaudidae*) dhe shumë lloje trishtilash.

Brezat gjethgjerë të përziara bartin një numër llojesh zogjsh karakteristik si qukapikët (fam. *Picidae*), Qukapiku i gjelbër - *Picus viridis*, Qukapiku i zakonshëm larosh - *Dendrocopos syriacus*, Qukapiku i vogël larosh - *Dendrocopos minor*, etc.), trishtilët (Trishtili i madh - *Parus major*, Trishtili i kaltër - *Parus caeruleus*, Trishtili i madh i murmë - *Parus lugubris*), mëllenjat dhe përsëri grifshat.

Lloji i gjitarit më të zakonshëm në zonën e Peizazhit të Mbrojtur është vidra (*Lutra lutra* (VU)), e cila është një tregues i mirë biologjik i gjendjes së ekosistemit. Gjithashtu takohen edhe gjitarët e mëdhenj si ariu - (*Ursus arctos*), ujku (*Canis lupus*), kaprolli (*Capreolus capreolus*) dhe derri i egër (*Sus scrofa*).

Lakuriqët e natës përfaqësohen kryesisht nga *Myotis nattereri*, *Nyctalus leisleri*, *Rhinolophus ferrugineus*, *R. blasii*. Gjitarë të tjerë dhe më shumë të përhapur në zonën e mbrojtur të liqenit të Pogradecit janë shqarhi (*Martes foina*), vjedulla (*Meles meles*), nuse-lala (*Mustela nivalis*), dhelpra e kuqe (*Vulpes vulpes*), ketri i kuq (*Sciurus vulgaris*), lepuri (*Lepus europeus*), iriaqi (*Erinaceus concolor*), gjeri (*Glis glis*), gjumashi i lathjise (*Muscardinus avellanarius*), minjtë e drurit/arave (*Apodemus flavicollis*, *A. sylvaticus*, *A. mystacinus*), hundegjates (*Crocodyrus* sp), urithi (*Talpa stankovici*) dhe miu i fushës (*Microtus* sp).

Peisazhi i Mbrojtur Tokësor/Ujor i Pogradecit shërben si bio - korridor për gjitarët e mëdhenj midis zones qendrore Rajcë-Shebenik-Jabllanicë dhe Guri i Nikës-Holtë-Lukovë, në Shqipëri.

Amfibët dhe zvarranikët janë të zakonshëm në zonën e mbrojtur. Gjatë ciklit të tyre të jetës ata janë të lidhur me habitate të ndryshme, sidomos me habitatet ujore për riprodhim dhe funksione të tjera. Llojet kryesore më të përhapur që mund të vëzhgohen kryesisht në zonën e liqenit të Pogradecit janë: *Triturus cristatus*, *T. vulgaris*, *Salamandra salamandra*, *Bombina variegata*, *Rana balcanica*, *Rana dalmatina*, *Rana graeca*, *Bufo viridis*, *Hyla arborea*, *Emys orbicularis* dhe





Natrix natrix. Zvarranikët tokësorë më të përhapur në peizazhin e mbrojtur të Pogradecit janë Podarcis muralis, Lacerta viridis, Testudo hermanni etj. Zvarranikë të tjerë janë nepërka me bri (Vipera ammodytes) dhe gjarpërinjtë kolubrid (Coluber spp, Coronella austriaca).

Habitati i liqenit: Flora dhe fauna dhe shkalla e biodiversitetit në liqenin e Pogradecit është e lidhur shumë me cilësinë e ujërave të liqenit dhe kushtet e ekosistemit.

Liqeni i Pogradecit ka një bimësi të pasur prej 125 bimësh ujore. Llojet më të zakonshme janë Phragmites australis, Potamogeton spp., Chara spp., Ceratophyllum spp., Myriophyllum spp. Gjashtë zonat e njëpasnjëshme të bimësisë përcaktohen në vijim: Zona 1: Chara spp., Zona2: Potamogeton spp., Zona 3: Zona e kallumishteve - Phragmites australis, Zona 4: llojet me gjethe pluskuese, Zona 5: Zona Palustrine dhe Zona: Charatea.

Bimësia luan një rol të rëndësishëm duke funksionuar si filtër biologjik dhe mekanik për ndotësit organikë dhe inorganikë. Bimësia ujore ka gjithashtu një rëndësi të madhe në erozion dhe në kontrollin e rrjedhjes së ujit. Për më tepër, bimësia krijon një habitat natyror për lloje të ndryshme vertebrorësh dhe jovertebrorësh dhe funksionon si vend shumëzimi për shumë peshq dhe mbrojtje prej grabitqarëve.

Fauna bentike e liqenit të Pogradecit përmban një dendësi dhe shumëllojshmëri të lartë specimesh. Në zonë gjenden lloje arkaike, endemike e të rralla dhe liqeni është i famshëm për këtë. Sfungjeri i rumbullakët Ochridospongia rotunda gjendet vetëm në liqenin e Pogradecit dhe është një lloj endemik e i rrallë. Grupi më i përhapur dhe më i madh në numër janë Gastropodet (kërmijtë), dhe shumica e tyre në liqen janë lloje endemike. Niveli i lartë i endemizmit përfaqësohet gjithashtu nga taksonë të tjerë, të tillë si Tricladida, Oligochaeta, Hirudinea, Ostracoda, Amphipoda dhe Isopoda.

Fito dhe zoo-planktoni, mikroalgat, janë tregues biologjikë shumë të ndjeshëm ndaj ndryshimeve në regjimin/cilësinë e ujit. Fitoplanktoni përfaqësohet më shumë nga Cyclotella ocellata, Achnanthes minutissima, Achnanthes biasoletiana, Fragilaria capucina, etj., të cilët janë lloje oligotrofike dhe oligomesotrofike. Sidoqoftë, gjenden edhe lloje të ujërave eutrofike ose politrofike, si Cooccones ipedicularis, Cymbella minuta, Gomphonema minutum, etj.

Zooplanktoni mund të përdoret gjithashtu si tregues ndjeshmërie i kushteve të ekosistemit të liqenit. Komunitet e zooplanktonit në liqen përmbajnë më së shumti Rotiferet – Gastropuss tylifer, Keratella cochlearis, Filina terminalis; Molusqet – Dreissenadhe Krustacete – Daphnia pulicaria dhe Eudiaptomus gracilis.

Fauna e peshqve të liqenit të Pogradecit përfaqëson një përqindje të lartë (60%) të llojeve të peshqve9 endemikë. Në liqen gjenden 21 lloje natyror peshqish (shikoni Shtojcën II), 11 prej të cilëve shfrytëzohen për qëllime tregtie. Dy salmonidet, korani - Salmo letnica dhe belushka - Salmothymus ohridanus , janë deri më tani llojet më të rëndësishme në peshkim pasuar nga gjuhëza (Alburnus alburnus), krap (Cyprinus carpio), ngjala (Anguilla anguilla) dhe gurneci (Rutilus rubilio ohridanus).

Gjatë viteve të fundit, në liqen janë hedhur lloje peshqish jo natyror si ylber (Oncorhynchus mykiss), barkuloci (Gambusia affinis) apo sharoku laraman (Lepomis gibbosus). Këto lloje nuk janë të afta të riprodhohen në mënyrë natyrore dhe tani konsiderohen si të zhdukura.

Pellgu ujëmbledhës i liqenit të Pogradecit është shumë i pasur me shpendë ujë. Numri më i lartë prej





65.000 zogjsh është shënuar më 1999 U identifikuan 10 23 specie. Shpezojt më të përhapura të ujit janë Bajza - Fulica atra, Murrçaku - Netta rufina dhe Rosa laramane me xhufkë - Aythya fuligula. Kredharaku i vogël i zi (Podiceps nigricollis) dhe kredharaku i vogël (Tachibaptus ruficollis) kanë gjithashtu një dendësi të konsiderueshme në liqen. Për më tepër, pas popullatave të rëndësishme të llojeve më të përhapura për Shqipërinë, liqeni i Pogradecit është i rëndësishëm gjithashtu edhe/ose për llojet e rralla e te kërcënuara, të tilla si karabullaku i vogël (Phalacrocorax pygmaeus me një popullsi afër 100 specie dhe Pelikani kaçurrel (Pelecanus crispus). Lejleku i bardhë (Ciconia ciconia) e përdor liqenin si pikë ndalimi gjatë migrimit dhe Shqipja e fushës (Circus cyaneus) janë prezente me individë të pakët gjatë dimrit së bashku me Patën hallë bardhë (Anser albifrons)

### 3.5. Përshkrimi i peisazhit kulturor dhe trashëgimia në zonën e mbrojtur

Trashëgimia kulturore e Pisazhit të Mbrojtur të Territorit Tokësor/Ujor të Pogradecit përfshin dëshmi të aktivitetit të njeriut në të kaluarën. Ajo përfshin peisazhe, ndërtesa, vendndodhje, monumente dhe objekte, si dhe dialekte, zakone vendase, legjenda, tradita dhe arte.

Monumentet kulturore, historike dhe natyrore

Në zonën e mbrojtur ndodhen 7 Monumente Natyrore (Kategoria III e Zonave të Mbrojtura në Shqipëri) si më poshtë (numri i tyre korrespondon me vendndodhjen e tyre në Hartën 1 më sipër):

Monumentet Bio

- Qiparisat e Kishës së Shën Mërisë (2)
- Sallkeni i Tushemishtit (4)

Monumentet Gjeografikë

- Guri i Kamjes (1)
- Shpella e Najazmës (3)
- Fragmenti i shkëputjes tektonike të Ohrit (6)
- Shpella e Memlishtit (7)

Monumentet Hidrike

- Burimi i Drilonit (5).

Në zonë ndodhen edhe disa ndërtesa të rëndësishme historike kulturore, ku përfshihet:

- Rrënojat e Kishës Paleokristiane në Lin. Gjatë gërmimeve janë gjetur mozaikë nga shekujt IV dhe

V. Ky është një Monument Kulturor i Shqipërisë.

- Rrënojat e Kishës Bizantine në Lin. Ky është një Monument Kulturor i Shqipërisë.
- Kalaja e Pogradecit.

Rrugët që të lidhin me monumentet e zonës e që kanë vlera natyrore, kulturore dhe historike nuk janë në gjendje të mirë ose nuk ekzistojnë fare, kështu që nuk është e lehtë të shkohet tek këto monumente. Shimë prej vendndodhjeve të monumenteve janë të ruajtura mirë (ato natyrore), por në përgjithësi monumentet dhe rrethinat e tyre nuk janë të ruajtura dhe të mbajtura mirë, dhe disa monumente janë dëmtuar.







### 3.6. Përshkrimi i sistemit socio-ekonomik të zonës së mbrojtur

Njerëzit që jetojnë në Peisazhin e Mbrojtur i shfrytëzojnë gjerësisht burimet ekzistuese natyrore. Bujqësia është një nga sektorët kryesorë të ekonomisë lokale që ofron të ardhurat e nevojshme për banorët. Edhe prodhimi i verës është traditë në këtë zonë, së bashku me aktivitetet artizanale si punimi i bakrit, gdhendja e gurit, zdrukthëtaria dhe punimet e dorës. I pranishëm është edhe ekoturizmi, ndonëse në një masë të vogël.

#### Pronësia e tokës

Pronësia e zonës është e ndarë ndërmjet shtetit, komunave dhe pronarëve privatë. Shteti dhe pronarët privatë zotërojnë rreth 60% të sipërfaqes totale të zonës së mbrojtur, përfshirë sipërfaqet ujore dhe një pjesë të vogël të pyjeve e kullotave<sup>5</sup>. Toka bujqësore (16.6%) është në pronësi të pronarëve privatë, ashtu sikurse zona industriale/ekonomike (3%), ndërsa 40 % e zonës (pyje dhe kullota) është në pronësi të komunave Udenisht, Buçimas dhe Çërravë

Pronësia dhe administrimi i pyjeve u janë transferuar komunave pas miratimit të ligjit të ri. Megjithatë, pyjet dhe kullotat që u janë transferuar komunave nuk përfshihen plotësisht në kufijtë e

zonës së mbrojtur. Në fakt, një pjesë e sipërfaqeve të transferuara ndodhet jashtë zonës së parkut (Harta 2).

Tabela 4 më poshtë paraqet disa të dhëna rreth sipërfaqes së tokave pyjore dhe kullimore që u janë transferuar komunave.

Tabela 46: Tokat pyjore dhe kullimore që i janë transferuar komunave

| Komuna     | Tokë pyjore (ha) | Tokë kullimore (ha) | Baza ligjore           |
|------------|------------------|---------------------|------------------------|
| Hundenisht | 3834             | 497                 | VKM 130, datë 03.02.08 |
| Trebinje   | 2821.5           | 404.7               | VKM 520, datë 23.04.08 |
| Bucimas    | 2305             |                     | VKM 605, datë 14.05.08 |
| Çerave     | 2089             |                     | VKM 816, datë 04.06.08 |

Harta 12: Tokat aktualisht në pronësi të shtetit dhe komunave në Zonën e Mbrojtur Tokësore/Ujore të Pogradecit





### 3.7. Bujqësia dhe blegtoaria

Bujqësia në zonë karakterizohet nga intensitet i ulët me një përdorim të kufizuar të pesticideve dhe pajisjeve mekanike dhe përfshin prodhimet e te mbjellave dhe mbarështimin e bagëtisë. Tokat e përdorura për bujqësi vaditen duke përdorur ujin e liqenit të Pogradecit nëpërmjet stacioneve të pompave.

Gjatë verës, livadhet përdoren për kullotje të bagëtisë dhe për mbarështim. Në këtë zonë rriten bagëti me prodhimtari të lartë dhe raca autoktone. Prodhimet e qumështit dhe mishit nga bagëti janë faktorë të rëndësishëm për ekonominë lokale dhe rajonale.

Mbarështimi i bagëtive dhe prodhimi i qumështit praktikohet sipas mënyrave të vjetra tradicionale, duke përdorur metoda të thjeshta në nivel familjar, të cilat në disa raste ndikojnë në cilësinë dhe sigurinë e produkteve. Përmirësimi i cilësisë së produkteve, teknologjitë më të mira të përpunimit dhe çertifikimi i produkteve lokale do ta rriste cilësinë e produkteve bujqësore duke krijuar mundësi për zhvillimin e ardhshëm ekonomik në këtë sektor. Bagëtitë kullojnë kryesisht në zonat e braktisura. Tarifa e kullotjes nuk mbledhet nga administrata vendore. Ky mund të ishte një burim fondesh për administratën lokale që mund të përdorej për përmirësimin e menaxhimit të zonës në të ardhmen.

Kultivimi i lajthive dhe prodhimi i verës janë aktivitete të zakonshme në këtë zonë, megjithatë sasi të përfuara janë të kufizuara për shkak të teknologjive të vjetra që përdoren. Cilësia e produkteve preket edhe nga përdorimi i këtyre teknikave të vjetra.





Edhe lajthia konsiderohet si një burim. Në zonë praktikohet edhe mbarështimi i blcëve dhe prodhimi i mjalitit, të cilat u sigurojnë të ardhura banorëve vendas. Prodhimi tradicional i verës është gjithashtu një praktikë shumë e zakonshme.

Përmes marketingut dhe çertifikimit të produkteve organike lokale, mund të përfitohen përfitime për komunitetet lokale në sektorin e bujqësisë.

### 3.8. Aktiviteti artizanal

Puna artizanale është një mënyrë për të gjeneruar të ardhura për banorët vendas në zonë. Prodhimet artizanale prodhohen për nevoja individuale dhe si suvenirë për vizitorët. Banorët vendas kanë tradita të vjetra në mobilitet e drurit dhe prodhimin e artikujve të drurit për familje duke shfrytëzuar ahun, bredhin, lisin, pishën, gështenjën dhe shkurret për prodhimin e tyre. Këto aktivitete tradicionale të punës me dorë sigurojnë një burim të ardhurash për popullsinë vendase.

### 3.9. Përdorimi i ujit

Uji në zonë përdoret në bujqësi; fushat vaditen duke përdorur ujin e liqenit. Uji i pijshëm sigurohet nga burimet natyrore të zonës, bazuar kryesisht në ujin e liqenit në zonën e Tushemishtit.

Përveç kësaj, burimet e ujit brenda peisazhit të mbrojtur përdoren gjithashtu për argëtim, sporte në ujë dhe plazh (zona e liqenit). Bregu i liqenit dhe burimet e Drilonit janë të njohura për vlerat e tyre turistike dhe tërheqin shumë vizitorë.

### 3.10. Peshkimi

Peshkimi në liqenin e Pogradecit është një burim i rëndësishëm të ardhurash për popullsinë vendase. Urdhri Nr. 17 i datës 15.01.2003 vendos një organizim gjysmë publik: Organizata e Menaxhimit të Peshkimit si përgjegjëse për administrimin e peshkimit në një proces bashkëmenaxhimi me Drejtorinë e Peshkimit. Sot, kjo organizatë ka 107 anëtarë. Peshkatarët janë shpërndarë përgjatë bregut të liqenit: 12 varka peshkimi në Lin, 13 në Piskupat, 44 në Hudenisht, 13 në Memelisht dhe 25 në Pogradec. Përveç 107 anëtarëve, ka gjithashtu edhe peshkatarë të licencuar. Afërsisht 220 peshkatarë aktivë veprojnë së bashku në liqenin e Pogradecit. Për më tepër, aktualisht është aktiv edhe një grup peshkatarësh të pa licencuar.

Peshku tregtohet në zonë nga ndërmjetësues midis peshkatarëve dhe kryesisht tregut vendas të përbërë nga restorantet dhe hotelet.

Varkat e peshkimit janë zakonisht 4 m të gjata, me trup të drurit dhe përdoren nga i zoti dhe një anëtar i familjes, me motor 4-10 HP dhe ingranazhet përfshijnë bllokazhin dhe rjetat.

Niveli i ulët i arsimimit reflekton interesin e ulët të peshkatarëve sa i takon përshtatjes me teknikat e reja të peshkimit, gjurmimit të produkteve, zbatimit të legjislacionit aktual në peshkim dhe sektorëve të tjerë që kanë lidhje me të.

Numri mesatar i ditëve të peshkimit në vit është 165. Bazuar në të dhënat e kapjeve të mundshme të 10 vjetëve të fundit, mund të vlerësohet se përpjekja për peshkim (P.K.Nj./CPUE) në total varion nga 4.64 kg/njësi në ditë deri në rreth 7 kg/njësi në ditë. Vlerat për koranin variojnë nga 1.63 deri në 2.29 kg/për njësi në ditë.





Në zonën e liqenit të Pogradecit ka dy rezervate për shumimin e peshkut. Një është në Lin, në bregun shqiptar të liqenit dhe një në Maqedoni. Rezervatet janë vënë në veprim që prej vitit 1995 në Shqipëri dhe që prej 1934-ës në Maqedoni. Rezervati i Linit është nën përgjegjësinë e Rezervatit të Midhjeve në Sarandë dhe Drejtorisë së Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, e cila ka si qëllim të prodhojë 1 milionë rrsatë (me gjatësi 6-8 cm) çdo vit.

Në dimër, korani kapet në zonat e shumëzimit për të siguruar vezët e fertilizuara në rezervatin e shumimit të peshkut. Rezervati i Linit i blen vezët nga peshkatarët që, para se ta shesin, e kapin peshkun dhe e pastrojnë

### 3.11. Aktiviteti industrial

Zona e Pogradecit është e pasur në minerale, prej të cilëve më të rëndësishmit janë hekur-nikeli, kromi dhe qymyrguri. Rezervat e kromit janë të kufizuara, por gjithashtu ka ende mundësi për kërkime. Shumë prej lëndëve të para të kromit, por edhe të qymyrgurit, eksportohen, kurse pjesa që mbetet përdoret në vend.

Sidomos pjesa perëndimore e liqenit përmban miniera të vjetra dhe të braktisura, por edhe miniera aktive, të krijuara kohët e fundit.

Ka 11 kompani minierash me leje mjedisore që veprojnë brenda peizazhit të mbrojtur (2013). Shtatë kompani janë kompani minerale, njëra operon si gurorë për nxjerrjen e mineraleve hekur dhe nikel, kurse pjesa tjetër e kompanive të licencuara operojnë si gurorë brenda kufijve të zonës së mbrojtur.

### 3.12. Turizmi

Turizmi është burimi më i rëndësishëm i të ardhurave në zonë dhe mundësi të punësimit për shumë njerëz. Turizmi është i përqendruar në afërsi të liqenit, përgjatë vijës së bregut ndërmjet Tushemishtit dhe Pogradecit.

Aktualisht, shumica e vizitorëve në këtë zonë janë vendas, ku një pjesë e mirë vijnë nga Tirana. Gjithashtu, zona vizitohet edhe nga vizitorë ndërkombëtarë që kanë filluar të udhëtojnë përmes një numri operatorësh turistikë me qendër në Tiranë. Turistët zakonisht kalojnë një deri në dy netë në këtë zonë.

Zona has vështirësi të mëdha në zhvillimin e turizmit. Zhvillimi i infrastrukturës përbën një çështje kyçe. Marketingu dhe promovimi janë ende në fazë zhvillimi dhe ekzistojnë vetëm pak qendra zyrtare informimi, ku turistët mund të gjejnë informacione.

Ndonëse shqiptarët janë njerëz shumë miqësorë e mikpritës, ndërgjegjësimi për turizmin dhe trajnimi i industrisë janë të kufizuara. Turizmi si një sektor i orientuar nga vetë tregu kuptohet vetëm në një nivel të kufizuar.

Shumë hotele komerciale, restorante dhe dyqane ndërtohen nga banorët pa hënë asnjë lloj studimi të tregut e si rrjedhojë nuk mund të mbijetojnë.





Ndonëse aktorët e interesuar mezi presin të shohin zhvillimin dhe rritjen e sektorit të turizmit, menaxhimi i këtij sektori është i dobët.

Liqeni mund të promovohet edhe përmes tregut të ekoturizmit, por një parakusht i rëndësishëm për këtë lloj turizmi është mjedisi i shëndetshëm dhe i pandotur eme ujë të pastër.

Në zonë mungojnë edhe shtigjet, tabelat dhe shenjat orientuese.





#### 4. VLERESIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE DHE SOCIALE

Veprimtaria që propozohet të kryhet nuk ka përmasa të mëdha të karakterit të investimeve por të efektit që do të japë gjatë shfrytëzimit të saj që vlerësohet shumë pozitive. Kjo është arsyeja që mbetet e një rëndësie të veçantë të analizohen ndikimet që do të ketë ajo që nga çasti i nisjes, pra e ndërtimit, dhe më tej ende, gjatë shfrytëzimit të saj. Ky kapitull gjithashtu do të paraqesë një analizë të hollësishme të ndikimeve të mundshme gjatë ndërtimit duke specifikuar edhe masat zbutëse që do të përdoren për të eliminuar apo për të minimizuar ndikimet në mjedis. Kjo analizë kryhet duke u bazuar në projektin e konceptuar të diskutuar si më lart në këtë raport. Ndikimet në mjedis mund të ndodhin si gjatë ndërtimit ashtu dhe gjatë shfrytëzimit dhe mund të grupohen si më poshtë:

- ↓ Kimike-Fizike të cilat lidhen me ndikimet mbi burimeve natyrore si edhe proceset e degradimit fizik të mjedisit vetë;
- ↓ Biologjike-Ekologjike përfshirë burimet e energjive të rinovueshme, ruajtjen e biodiversitetit, ndikimin mbi jetën e gjallë të ndotjes së biosferës;
- ↓ Sociologjike të lidhura me komunitetin apo edhe individët e veçante, ndikimin mbi trashëgiminë kulturore dhe progresin e supozuar;
- ↓ Ekonomike-Makroekonomike të cilat marrin parasysh ndikimet e përkohshme apo të përhershme shkaktuar për shkak të realizimit të projektit.

Kriteret e vlerësimit të ndikimit në mjedis ndahen në dy grupe kryesore:

- ↓ Kriteret me ndikim mbi procesin e vlerësimit, qoftë edhe individualisht;
- ↓ Kriteret të cilët ndihmojnë në vlerësimin e situatës por që nuk kanë ndikim në proces

#### **Ndryshimet në mjedis gjatë Rehabilitimi i bregut të Liqenit të Ohrit dhe gjelberimi përgjatë rruges segmenti Lin – Pogradec**

Për të analizuar ndikimet e mundshme në mjedis gjatë periudhës së ndërtimit të projektit së pari, janë veçuar përbërësit kryesorë të punimeve të ndërtimit. Më pas, për secilin nga këto përbërës janë saktësuar ndikimet negative apo pozitive mbi mjedisin si dhe masat e mundshme zbutëse ndaj tyre. Në fund janë përvijuar burimet dhe shkaqet e ndikimeve të mundshme.

#### **Ndryshimet tokësore**

Gjatë fazës së parë të kësaj sipërmarrjeje, e gjithë veprimtaria e ndërtimit duhet të kryhet në përputhje me praktikën e duhura të ndërtimit si dhe me kërkesat e lejeve të ndryshme të nevojshme për ndërtim. Veprimtaritë që mund të shkaktojnë ndikime në mjedis gjatë fazës së ndërtimit janë identifikuar dhe përmbledhur më poshtë. Këto veprimtari përfshijnë përmirësimin e rehabilitimin e zones Pogradec-Lin, largimin e mbeturinave, ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve, udhëtimet e punëtorëve dhe veprimtari të tjera të nevojshme për tu kryer.

#### **4.1.1. Dukuritë që do të ndodhin gjatë gërmimeve**


Ndërtimi i objekteve ndihmëse në këto zone të Pogradecit si dhe gjelberim të saj fillimisht do të kërkojë gërmimin e zones për themelet të cilat pjesërisht janë në kufi me kanalën kulluese, në distancë 5-8 m prej tij. Zona që do të rehabilitohet do të ketë punime me sasi të gërmimit të përmasave jo të ekzagjeruara, por do të nevojitet material mbushës për të plotësuar zgjerimin e duhur. Kjo punë do të kryhet me anë të mjeteve gërmuese dhe largimi i materialit do të bëhet nga mjete vetëshkarkuese apo kamionë të një tonazhi të caktuar. Cikli i gërmimit do të përfshijë:





- ✦ Gërmimin e truallit me mjete gërmuese, duke hapur themele të nevojshëm për të hedhur materialin e mirë mbushës, të marrë nga karriera shkëmbore. Pjesa pranë zones së liqenit do të mbushet me gjetekstil me qëllim mbrojtjen dhe mospërzierjen e tyre;
- ✦ Ngarkimin e materialit të gërmuar nëpër kamionë;
- ✦ Largimin e këtij materiali dhe depozitimin e tij në vender të autorizuar nga pushteti lokal;
- ✦ Kthimin e automjeteve të transportit për në zonën e ndërtimit.

Shkaqet e ndikimeve të mundshme gjatë ndërtimit janë identifikuar në skemën e figurës. Në përgjithësi, largimi i sedimenteve ekzistuese dhe vendosja e tyre në një mjedis të përshtatshëm, ku parandalohet shpërndarja, ka një ndikim të dobishëm mbi mjedisin. Ndikimet negative të gërmimit mund të përfshijnë dëmtimin direkt potencial ndaj florës dhe faunës në zonat e gërmimit dhe të hedhjes së materialit të gërmuar, ndërthurjen e transportit të materialit të gërmuar me trafikun ekzistues tokësor, si dhe ndotjen e zhurmën gjatë punës së pajisjeve gërmuese.



Ndikimet e mundshme gjatë procesit të gërmimit

Me poshtë jepen vëllimet kryesore të punimeve që mund të paraqesin ndikim në mjedis:





Tabela 57: Vëllimet e punimeve që do të kryhen për ndërtimin e objekteve

| Nr.      | Analiza   | Pershkrimi i Punimeve   | Njesia         | Sasia    |
|----------|-----------|---|----------------|----------|
| <b>A</b> |           | <b>PUNIME PER EVADIMIN E MBETURINAVE DHE REHABILITIM TE ZONAVE KU JANE PRISHUR NDERTESAT DHE GJELBERIMI</b>   |                |          |
|          |           | <b>A-1. Punime dheu dhe transport mbeturinash</b>   |                |          |
| 1        | 3.25/b    | Germim me krahe seksion detyruar me gjerësi b > 1 m, h=1.5 m, toke e zak.                                     | m <sup>3</sup> | 7 450,0  |
| 2        | 3.210     | Shtrese çakelli mbeturine kave t=1x15cm, perhapur e ngjeshur makineri   | m <sup>2</sup> | 375,0    |
| 3        | 3.158/5a  | Transport dheu me auto deri 5.0 km  | m <sup>3</sup> | 7 450,0  |
| 4        | An-50- M3 | Transport element betoni dhe b/a me auto deri 10 km   | ton            | 13 010,0 |
|          |           | <b>Shuma A-1</b>  |                |          |
|          |           | <b>A-2 MBJELLJE PEME DHE GJELBERIME</b>   |                |          |
| 1        | An        | F.V + sherbime Hidrombjellje me varietete barishtore autoktone  | m <sup>2</sup> | 65 325,0 |
| 2        | 3.48/a    | Rrafshim skarpatesh, me krahe, ne germim toke te bute   | m <sup>2</sup> | 65 325,0 |
| 3        | 3.158/5a  | Transport dheu me auto deri 5.0 km.   | m <sup>3</sup> | 7 150,0  |
| 4        | An        | F.v + sherbime Pinus Halepensis c.20-25 cm  | copë           | 533,0    |
| 5        | An        | F.v. + sherbime Populus pyramidalis c.20-25 cm  | copë           | 52,0     |
| 6        | An        | F.v. + sherbime cupressus sempervirens c.20-25 cm   | cupe           | 55,0     |
|          |           | <b>SHUMA A-2</b>  |                |          |
| <b>D</b> |           | <b>PUNIME PER NDERTIMIN E OHRI CLUB ZONES</b>   |                |          |
|          |           | <b>D-1. Ohri club</b>   |                |          |
| 1        | 3,137     | Germim dheu me ekskavator goma 0.15 m <sup>2</sup> , ne themele, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke | m <sup>3</sup> | 1 852,0  |
| 2        | An.164/1a | Shtrese çakelli mbeturine kave t=1x20cm, perhapur e ngjeshur makineri   | m <sup>2</sup> | 1 640,0  |
|          |           |   |                |          |
|          |           |   |                |          |
|          |           |   |                |          |
|          |           |   |                |          |
|          |           |   |                |          |
|          |           |   |                |          |
|          |           |   |                |          |
|          |           |   |                |          |
|          |           |   |                |          |







|  |           |   |                |         |
|--|-----------|---|----------------|---------|
| 13   | 3,245     | F.V. Beton C25/30   | m <sup>3</sup> | 1 128,0 |
| 14   | 3,240     | F.V. Beton C12/15   | m <sup>3</sup> | 45,0    |
| 47   | An-11     | F.V depozite uji V=5000 lit   | cope           | 3,0     |
| 48   | 2.425/2   | Ndertim grope septike v12 m3  | cope           | 3,0     |
| <b>PUNIME PER NDERTIMIN E LOOK OUT ZONES</b>   |           |   |                |         |
| <b>E-1. Look outs zones</b>                    |           |   |                |         |
| 1  | 3,137     | Germim dheu me ekskavator goma 0.15 m <sup>2</sup> , ne themele, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke | m <sup>3</sup> | 1 250,0 |
| 2  | An.164/1a | Shtrese cakelli mbeturine kave t=1x20cm, perhapur e ngjeshur makineri   | m <sup>2</sup> | 540,0   |
| 3  | 3,245     | F.V. Beton C25/30   | m <sup>3</sup> | 345,0   |
| 4  | 3,240     | F.V. Beton C12/15   | m <sup>3</sup> | 42,0    |
| <b>F</b>                                       |           |   |                |         |
| <b>PUNIME PER NDERTIMIN E EXCHANGE MARKETS</b> |           |   |                |         |
| <b>F-1. Exchange markets</b>                   |           |   |                |         |
| 1  | 3,137     | Germim dheu me ekskavator goma 0.15 m <sup>2</sup> , ne themele, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke | m <sup>3</sup> | 1 134,0 |
| 2  | An.164/1a | Shtrese cakelli mbeturine kave t=1x20cm, perhapur e ngjeshur makineri   | m <sup>2</sup> | 320,0   |
| 3  | 3,245     | F.V. Beton C25/30   | m <sup>3</sup> | 60,0    |
| 4  | 3,240     | F.V. Beton C12/15   | m <sup>3</sup> | 64,0    |





#### 4.1.2. Ndryshimet ujore

Ndikimet mbi ujerat liqenore gjatë ndërtimit të objekteve do të jete vetëm me mundësinë e derdhjes së ujerave të kontaminuar, përmes kanalit kullues të zones ku sistemi i kanalizimeve nuk është prezent, kryesisht me ndotës hidrokarbure, të cilët mund të krijojnë një shtresë me sedimente të ndotura në bregun e tij dhe me gjere. Sidoqoftë ky rrezik, me përdorimin e teknologjisë moderne të ndërtimit është minimizuar.

#### 4.2. Analiza e praktikave më të mira të ndërtimit dhe të menaxhimit të zonës

Investimet e bëra dhe teknologjitë e ndryshme që do të përdoren në ndërtim kërkojnë kontraktimin e firmave me eksperience në fushën e zbatimit, të cilat do të kualifikohen dhe përzgjidhen me kujdesin më të madh. Përdorimi i pajisjeve të përshtatshme përshtatja me rregulloret ndërkombëtare dhe në përgjithësi zbatimi sipas standardeve dhe teknikave më të mira të ndërtimit, janë një kërkesë thelbësore për zgjedhjen e nenkontraktoreve dhe plotësimin e suksesshëm të projektit. Kjo do të sjellë përfitime të dukshme për zbutjen e ndikimit të ndërtimeve në mjedis. Në paragrafin e mëposhtëm diskutohen parametrat më kuptimplote dhe masat që janë marrë.

##### 4.2.1. Cilësia e ajrit

Çlirimet e gazrave në ajër që lidhen me ndërtimin mund të ndodhin nga dy burime të pavarura:

- ✦ Çlirime ndotësish nga djegiet e makinave private dhe atyre të ndërtimit, me motorë me djegie të brendshme;
- ✦ Pluhur që del nga lëvizja e makinave mbi rrugët e shtruara dhe të pashtuara.

Çlirimet e gazrave në ajër që lidhen me ndërtimin, për dy tipat e burimeve që u përmendën, ndryshojnë sipas llojeve të veprimtarive dhe lidhen me fazat e ndryshme tipike të një projekti ndërtimi. Kështu mund të dallohen fazat e mëposhtme të këtyre çlirimeve në një projekt dinjitoz ndërtimi:

- ✦ Përgatitja e zonës për ndërtim që përfshin nivelimin dhe stabilizimin e dheut, aktivitetet prerëse dhe mbushëse, të cilat mund të përfshijnë lëvizjen me makineri të renda për zhvendosjen e dheut mbi sipërfaqet e çrregullta, ngarkimin e materialeve, trafikun e automjeteve në rrugë të pashtuar apo shesheve të pa shtruar;
- ✦ Largimi i mbeturinave të pengesave natyrore dhe atyre të krijuara nga dora e njeriut, të cilat mund të përfshijnë heqjet mekanike, ngarkim/shkarkimet e materialeve;
- ✦ Ndërtimi i përgjithshëm; i themeleve, konstruksioneve prej çeliku, punimeve të brendshme dhe të jashtme, instalimeve dhe tubacioneve elektrike, hidraulike etj.

Çlirimet e gazrave dhe pluhurave në ajër nga këto veprimtari të zakonshme ndërtimi përfshijnë:

- ✦ Çlirimet e gazta nga djegiet (COV, NOx, CO, SOx, PM10) nga makineritë e renda lëvizëse me gazoil apo benzine, pajisjet ndihmëse portative si dhe automjetet e transportit të punonjësve;
- ✦ Pluhurat që dalin (PM10) nga gjermimi i dheut apo nga shembjet e ndryshme që ndodhin në kantier.



Përmbledhja e vlerësimeve të ndikimeve në mjedis gjatë punimeve të ndërtimit në tokë

| Parametri Mjedisor             | Burimi  | Vlerat e ndikimit |            |           |
|--------------------------------|---|-------------------|------------|-----------|
|                                |   | E (U)let          | (M)esatare | E (L)artë |
| <b>Zhurma</b>                  | Gjithë aktivitetet ndërtimore                     | U                 |            |           |
| <b>Mbeturinat</b>              | Gjithë aktivitetet ndërtimore                     | U                 |            |           |
|                                | Mbeturinat e nxjerra nga punëtor. e zonës         | U                 |            |           |
| <b>Ndotja e ajrit</b>          | Pajisjet ndërtimore                               | U                 |            |           |
|                                | Udhëtimet e kamionëve për ngarkim- shkarkim       |                   | M          |           |
|                                | Udhëtimet e punëtorëve                            | U                 |            |           |
| <b>Ndotja e ujit</b>           | Nxjerrja e pluhurit nga aktivitetet e përgatitjes |                   | M          |           |
|                                | Kullimi   | U                 |            |           |
|                                | Mbeturinat Sanitare                               | U                 |            |           |
| <b>Ndikimi më trafik/rruge</b> | Udhëtimet e kamionëve për ngarkim shkarkim        |                   | M          |           |
|                                | Udhëtimet e punëtorëve                            | U                 |            |           |

Ndonëse dihet që pajisjet e ndërtimit çlirojnë ndotës të mjedisit, ndikimet pritet të jenë minimale për disa arsye. Gjatë përgatitjes së zonës do të ketë shembje të kufizuara sepse rruga do të kalojë mbi trasenë ekzistuese. Edhe puna për një nivelim të tij do të jetë mjaft e kufizuar për shkak të vetë gjendjes natyrore të vendndodhjes së sheshit. Përveç kësaj, mjetet që do të përdoren në ndërtim do të mirëmbahen rregullisht gjë që do të sjellë si pasojë djegie të mirë të karburantit si dhe çlirime minimale të ndotësve të rastit si; monoksidi i karbonit dhe materialet pluhurore si PM10 dhe PM 2.5. Numri i mjeteve të transportit të mallrave apo edhe i punëtorëve do të jetë i ulët dhe për rrjedhojë ato nuk do të krijojnë ndikim të ndjeshëm negativ. Përsa i përket përhapjes së pluhurave, zonat e banuara me të afërta ndodhen larg nga traseja e rrugës, gjë që siguron ndikime minimale.

Siç është përmendur më lart, gjatë procesit të ndërtimit çlirohen gjithashtu tymra të djegies si: COV, NOx, CO, SOx, PM 10. Në tabelë jepen pajisjet e ndërtimit të standardeve që do të përdoren si dhe sasitë e gazrave që këto pajisje potencialisht shkurkojnë në atmosferën ku punojnë. Është plotësisht e mundur të vlerësohet numri dhe tipi i pajisjeve që do të përfshihen në realizimin praktik, duke u bazuar në publikimet e ndryshme dhe në zgjatjen e periudhës së përdorimit siç raportohet në tabelle.

Këto çlirime dhe ndikimet e tyre mund të konsiderohen të neglizhueshme, duke pasur parasysh kohëzgjatjen e kufizuar të fazës së ndërtimit.

**Të dhëna mbi çlirimin e gazeve nga makineritë e ndërtimit**

| Pajisja                         | CO [gh <sup>-1</sup> ] | CO <sub>2</sub> [gh <sup>-1</sup> ] | NOx [gh <sup>-1</sup> ] | SOx [gh <sup>-1</sup> ] | Pluhur [gh <sup>-1</sup> ] |
|---------------------------------|------------------------|-------------------------------------|-------------------------|-------------------------|----------------------------|
| Makinë shtrimi, Ekskavatorë dhe |                        |                                     |                         |                         |                            |

|   |        |        |        |      |      |
|---|--------|--------|--------|------|------|
| Buldozerë me rrota gome, Ekskavatorë të vegjël me rrota aktive      | 259.58 | 113.17 | 858.19 | 82.5 | 77.9 |
| Autobetoniere, Rul, Autovinç, Kamion, Traktor me rrota gome Autobot | 816.81 | 86.84  | 1889.1 | 206  | 116  |
| Vinç, Grup gjeneratori, Kompresor ajri, Saldatriçe, Çekiç pilotësh  | 306.37 | 69.35  | 767.3  | 64.7 | 63.2 |

Në çdo rast, pavarësisht nga proceset që do të kryhen, cilësia e ajrit nuk do të dëmtohet jashtë standardeve të parashikuara. Kështu, ditët me të këqija do të ndodhin gjatë proceseve të nivelimit apo të zhvendosjes së dherave sidomos kur këto procese do të kryheshin në stinë e thatë të verës. Në literaturën teknike jepet vlera referencë 0.15-0.30 kg/m<sup>3</sup>muaj<sup>-1</sup> për çlirimet e pluhurave që përhapen në mjedis. Këto çlirime mund të konsiderohen të pranueshme. Rikthimi i pluhurit në toke, në fakt, supozohet se do të jete shumë i vogël dhe do të interesoje vetëm zonën pranë sheshit të ndërtimit, kështu që nuk do të shkaktojë shqetësime mbetëse për banorët e zonës përreth.

Standardet e cilësisë së ajrit dhe shikarkimet ndotëse në mjedis

|             | Vlerat mesatare të elementëve ndotës |                                |              |                       |             |                           |
|-------------|--------------------------------------|--------------------------------|--------------|-----------------------|-------------|---------------------------|
|             | SO <sub>2</sub>                      |                                |              | NO <sub>x</sub>       |             |                           |
|             | Vjetore                              | 24h max. (ppm)                 | Ditore       | Vjetore (ppm)         | 24 orë max. | Ditore Orare              |
| <b>B. B</b> | 0.10                                 | 0.5 (jashtë)                   | 1.0 (brenda) | 0.05                  | -           | 0.05 -                    |
| <b>SHBA</b> | 0.02ppm [a]<br>0.03ppm [b]           | 0.1 [a]<br>0.14 [b]<br>0.5 [c] | -            | 0.05                  | -           | -                         |
| <b>WHO</b>  | -                                    | 90µg/m <sup>3</sup>            | -            | -                     | -           | 190-320 µg/m <sup>3</sup> |
| <b>BE</b>   | 80 µg/m <sup>3</sup>                 | -                              | -            | 200 µg/m <sup>3</sup> | -           | -                         |

[a]-Dytësore të bazuara në ndikimet mjedisore

[b]-Parësore të bazuara në ndikimet shëndetësore tek njerëzit

[c]-Maksimumi prej tre orësh një here në vit

### Zhurma dhe dridhjet

Zhurma nga aktivitetet e ndërtimit mund të jete e rëndësishme për një periudhë të kufizuar kohe. Nivelet e zhurmës të shkaktuara nga aktivitetet e ndërtimit mund të ndryshojnë shumë, në varësi të fazës së ndërtimit dhe detyrës specifike që po kryhet. Të gjitha pajisjet që lëshojnë zhurmë do të mirëmbahen ashtu siç duhet për të minimizuar ndikimin e zhurmës në zonë. Pajisjet që lëshojnë zhurmë do të jenë sipas standardeve të BE rreth zhurmës të shkaktuar në mjedis. Projekti i rrugës përfshin dhe karakterizimin e dheut, ujit nëntokësor dhe sedimenteve ujore të zonës në fjalë, me qëllim mbledhjen e informacionit të qartë mbi ndikimet teknike dhe ekonomike të ndotjes, e cila potencialisht ekzistonte që më parë. Në baze të këtyre rezultateve, në mënyrë që të parandalohet ndikimi i ndotësve gjatë gjurmimit të themeleve të ndërtesave dhe pajisjeve teknologjike, do të jete e nevojshme të largohet dhe i ndotur dhe të depozitohet i sigurt, në zonë të autorizuar nga pushteti vendor. Operatori i ndërtimit, do të konsiderohet përgjegjës për ndotjen që do të rezultojë në zonat e përmendura. Rekomandimi i dhënë ka për



qëllim të minimizojë rrezikun e ndotjes së dheut dhe të ujit nëntokësor për shkak të derdhjeve aksidentale të prodhimeve të naftës, dhe duhet të konsiderohet gjithashtu një zgjidhje shumë e mire për të izoluar dheun e ndotur dhe ujërat nëntokësore nga mjedisi mbi to.

#### Trafiku i ri shtesë i krijuar

Periodi i rehabilitimit të bregut të liqenit të Pogradecit do të karakterizohet nga një intensitet i lartë i lëvizjes së makinerive të transportit që do të shërbejnë për materialet e gërmuara apo për pajisjet dhe elementët e ndërtimit si dhe transportin e punëtorëve. Kategoria e transportit udhëtar apo e punëtorëve të ndërtimit që shkojnë e vijnë nga sheshi ndërtimit do të jetë e reduktuar. Numri maksimal i punëtorëve të ndërtimit për punime në tokë që do të punësohen në kohën e ngarkesës me të madhe të kësaj periudhe do të jete rreth 80/dite me një mesatare prej 30 ditë pune në muaj. Gjate kohëve jo me ngarkese maksimale, aktiviteti do të jete me i pakët. Lëvizjet e kamionëve për dërgimin e materialeve dhe largimin e tyre do të parashikohet që të ndodhë në kohën me më pak trafik në rrjetin rrugor lokal me qëllim që të ndërthuret sa më pak me trafikun normal të zonës suburbane dhe urbane. Kësaj, do të jetë e udhës që më mirë lëvizjet të kryhen kryesisht në intervalin kohor 17-07. Duke u bazuar në sasinë e trafikut të pritshëm të ndërtimit, kohën kur do të kryhet ky trafik, kohëzgjatjen e kufizuar të ndërtimeve intensive si dhe përmirësimin e rrugëve, volumin dhe kapacitetin e trafikut në rrugët ekzistuese, nuk parashikohet që aktivitetet e ndërtimit do të rezultojnë në ndikime negative mbi trafikun.

#### Mbeturinat që krijohen

Gjate periudhës së zbatimit të projektit do të ketë dy burime mbeturinash:

- Materiali i gërmuar për të realizuar infrastrukturën e parashikuar në tokë;
- Materiali i tepërt që do të rezultojë nga sheshimet apo nivelimet e ndryshme në zonën e shërbimeve

Pjesa kryesore e mbeturinave të prodhuara gjate punimeve tokësore mund të vijë nga gërmimi si dhe nga ambalazhi i materialeve të ndryshme të ndërtimit (çimento, dru, plastike, xham, materiale izoluese, etj.) dhe vajrat e kulluar. Këto lloj mbeturinash mund të klasifikohen si inerte, vetëm vajrat e kulluara mund të klasifikohen si të "rrezikshme". Punëtorëve të ndërtimit do t'ju kërkohet të mbledhin më vete llojet e mbeturinave. Të gjitha materialet e larguara nga sheshi i ndërtimit do të menaxhohen sipas ligjeve dhe rregulloreve shqiptare në fuqi. Materialet e rrezikshme që do të përdoren detyruesisht gjate ndërtimit, do të ruhen në zonat e parashikuara në fund të dyfishtë. Me këto masa, nuk ka pse të ndodhin ndikime negative të rëndësishme gjate ndërtimit.

#### Ndikimet pozitive gjatë periudhës së ndërtimit të projektit në vlerësim

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme të përmendura më parë, nxjerr në pah se veprat të tilla kanë disa pasojë pozitive në mjedis. Ndër këto mund të përmendim shkurtimisht faktin se tërë materialet e hedhura në zonë në mënyrë të pakontrolluar përbëjnë elementë ndotës në mjedisit dhe sidomos bregut e vete liqenit. Dallgët e detit janë burim i shpërndarjes së elementëve ndotës nga stercja në det për të përfunduar në drejtim të paditur. Ndërtimi i strukturave mbrojtëse në rrugën e rindërtuar do ta izolojnë zonën e plazhit. Bazuar në këtë informacion dhe rezultatet analitike të përfuara nga mostrat, nuk parashikohet që ndonjë material i gërmuar të ketë përqendrim të lartë merkuri ose metale të tjera të rënda. Sidoqoftë, heqja e sedimenteve duke gërmuar sipas teknologjisë së duhur dhe vendosja në një vend të thellë larg bregut, ku veprimi i dallgëve dhe rrymave detare është pothuaj i neglizhueshem, do të ishte zgjidhja e përshtetshme për materialet e gërmuara.





### Vlerësimi i ndikimeve dhe masave zbutëse

Kohëzgjatja dhe lloji i procesit që do të kryhet janë faktorët bazë që merren parasysh në vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve potenciale negative të ndërtimit të leprë. Kështu, për të pasur një ide më përmbljedhëse të këtyre ndikimeve, në tabelën 7 janë përmblodhur parametrat mjedisore dhe burimet e mundshme të ndikimeve të përcaktuara më sipër. Për secilin rast, duke marrë parasysh madhësinë dhe kohëzgjatjen e procesit, është bërë një vlerësim i rëndësise së përgjithshme duke përdorur tre nivele: i Ulët (U), i Mesëm (M) dhe i lartë (L). Si e dhënë e përgjithshme për procesin e vlerësimit duhet marrë në konsideratë fakti që zona e ndërtimit ndodhet në një distancë relativisht mesatare nga zonat rezidenciale.

**Përdorimi i burimeve të materialeve të ndërtimit** -Ndërtimi i objekteve dhe rehabilitimi i bregut do të kërkojë një sasi të madhe çimentoje. Ndikimi në mjedis të transportit të çimentos parashikohet të jetë shumë i moderuar, për shkak të kritereve përmes të cilëve do të përzgjidhen nënkontraktoret që do të realizojnë transportin e materialeve të ndërtimit.

**Ndikimi mbi trafikun/rrugët.** Ndikimi më i madh në trafikun tokësor do të vije nga transportimi i materialeve për ndërtim e objekteve në zonën e bregut të liqenit. Zbutja e nevojshme e ndikimit të këtij procesi transport dhe depozitim, sheshim, nivelimi, hyn në kategorinë e "Praktikave me të mira të Menaxhimit të Zonave të ndërtimit". Shpejtësia e kamionëve do të kontrollohet në mënyrë që të ulët rrezikun e aksidenteve, duke vendosur sinjale rrugore në pikat më "të nxehta" të trafikut (nyje apo kryqëzime problematike).



Tabela 68: Përmbledhje e vlerësimeve të ndikimeve në mjedis gjatë ndërtimit

| Faza    | Punimi   | Masat lehtësuese  | Kosto     |         | Përgjegjësitë              |                            | Komente  |
|---------|--|---|-----------|---------|----------------------------|----------------------------|--|
|         |  |   | Instalimi | Punimet | Instalimi                  | Punimet                    |  |
| Ndërtim | <ul style="list-style-type: none"> <li>Furnizim me material:<br/>Asfalt, gurë</li> </ul> | Të shfrytëzohen linjat ekzistuese të asfaltit dhe gurëve. Të aplikohet për marrjen e lejeve nga autoritetet përkatëse | NA        | NA      | Fabrikë asfalti dhe gurëve | Fabrikë asfalti dhe gurëve | Për tu saktësuar në kontratat e lidhura me nënkontraktorët   |
|         | <ul style="list-style-type: none"> <li>Transport materiali</li> </ul>                    |   |           |         |                            |                            |  |
|         | a) Asfalt Pluhur, tym  | Të mbulohej mjetet  | 5000L/ m  | minima  | Kontraktori                | kontraktori                | Për t'u saktësuar në kontratat e lidhura me nënkontraktorët  |
|         | b) Gurët pluhur  | Të laget ngarkesa   | 5000L/ m  | minima  | Kontraktori                | kontraktori                | Për t'u saktësuar në kontratat e lidhura me nënkontraktorët  |
|         | c) Menaxhimi i trafikut Zhurma etj.  | Të shmangen orët e pikut  | NA        | minima  | Kontraktori                | kontraktori                | Për t'u saktësuar në kontratat e lidhura me kontraktorin   |
|         | <ul style="list-style-type: none"> <li>Kantieri i ndërtimit</li> </ul>                   |   |           |         |                            |                            |  |
|         | a) Dëmtim i strukturës së tokës.<br>Humbje sipërfaqësore, dëmtime, rrëshqitje, erozion   | Të mbrohet dhe restaurohet zona e ndërtimit. Të ndërtohen struktura mbujtëse.   | 20000 L/m | NA      | projektuues                | projektluesi               | Rruga ndërtohet mbi një zonë të mbrojtur, por mbi gjurmën e rrugës ekzistuese. Gjendja e rrugës ekzistuese është shumë |



|  |  |  |  |  |  |  |  |         |   |           |  |
|--|--|--|--|--|--|--|--|---------|---|-----------|--|
|  |  |  |  |  |  |  |  |         | c mire. Terreni është fushor dhe struktura e tokës është aluvialorane. Kalon pranë plazhit të Pogradecit dhe Lin Ka shumë biznese të vogla dhe objekte publike pranë gjurmës së rrugës. |           |  |
| <i>b) Ndodhja akustike</i>                 |  |  |  |  |  |  |  | minimal | Ndërtuesi   | Ndërtuesi | Të specifikohet në projektin teknik te detajuar nga kontraktori                      |
| <i>c) Pluhuri</i>                          |  |  |  |  |  |  |  | minimal | Ndërtuesi   | Ndërtuesi | Të specifikohet në projektin teknik te detajuar nga kontraktori                      |
| <i>e) Probleme me trafikun</i>             |  |  |  |  |  |  |  | minimal | Ndërtuesi   | Ndërtuesi | Të lejohet trafikun normal të makinerive bujqësore dhe të banorëve e turistëve       |
| <i>g) Siguria e mjeteve të transportit</i> |  |  |  |  |  |  |  | minimal | Ndërtuesi   | Ndërtuesi | Kujdes i posaçëm duhet treguar për nxënësit e shkollave                              |
| <i>h) Ndodhje e ujit dhe terrenit</i>      |  |  |  |  |  |  |  | minimal | Ndërtuesi   | Ndërtuesi | Nuk ka asnjë lum pranë rrugës, por vetëm një kanal kullues i cili derdhet në kënetë. |





|   | përdoren.  |          |                     |                             |              |  |  |  |  |  |
|---|--|----------|---------------------|-----------------------------|--------------|--|--|--|--|--|
| i) Ndojtje e ujit dhe terrenit nga mbejtjet e ndërtimeve      | Të depozitohen në vendet e caktuara nga Pushteti Vendor  | 2000 l/m | minimal             | Ndërtuesi                   | Ndërtuesi    |  |  |  |  |  |
| j) Ndojtja nga karburantet apo mirëmbajtja e mjeteve          | Magazininim i sigurt i tyre                              | 2000 l/m | minimal             | Ndërtuesi                   | Ndërtuesi    |  |  |  |  | Komuna duhet të caktojë një vend për depozitim të tyre   |
| k) Mbrojtja në punë   | Të kryhet instruktimi mbi rregulloret e sigurimit teknik | 2000 l/m | minimal             | Ndërtuesi                   | Ndërtuesi    |  |  |  |  |  |
| l) Shkatërrim të mjellash, pemësh frutore etj.                | Të kompensohen dëmet                                     | NA       | Në varësi të dëmeve | Ndërtuesi/drejtori e pyjeve | Ndërtuesi    |  |  |  |  | Edhe pse zona është kryesisht shkurrëjë ndërtuesi duhet të tregojë kujdes të veçantë për çdo dëm eventua |
| <b>• Mirëmbajtje</b>  |  |          |                     |                             |              |  |  |  |  |  |
| a) Ndojtje akustike   | Të kufizohet aktiviteti ndërtimor gjatë ditës            | minimal  | minimal             | Mirëmbajtësi                | Mirëmbajtësi |  |  |  |  | Të specifikohet në kontratë  |
| b) Mundësi ndojtje të ajrit, ujit dhe tokës pluhur, emisione, | Magazininim i rregullt i karburantit, mirëmbajtje e      | minimal  | minimal             | Mirëmbajtësi                | Mirëmbajtësi |  |  |  |  |  |



|   |  |          |                 |              |              |                                      |
|---|--|----------|-----------------|--------------|--------------|--------------------------------------|
| karburant, mirëmbajtje e sistemeve të drenazhimit                           | makina ve etj.   | 3000 l/m | NA <sup>1</sup> | Mirëmbajtësi | Mirëmbajtësi | Të specifikohet në kontratë          |
| c) <i>dridhje</i>   | Të kufizohet aktiviteti gjatë orëve të ditës             | minimal  | minimal         | Mirëmbajtësi | Mirëmbajtësi |                                      |
| d) <i>Mbrojtja në punë</i>  | Të kryhet instruktimi mbi rregulloret e sigurimit teknik |          |                 |              |              |                                      |
| • <b>Siguria në rrugë</b>   |  |          |                 |              |              |                                      |
| a) <i>Rritet shpejtësia e trafikut</i>                                      | Të vendoset sinjalistika                                 | NA       | minimal         | Mirëmbajtësi | Mirëmbajtësi | Të specifikohet në kontratë          |
| b) <i>Erozion, rënie gurësh</i>   | Të vendosen tabela paralajmëruese                        | NA       | minimal         | Mirëmbajtësi | Mirëmbajtësi |                                      |
| c) <i>Madhësi e rezervave nga skoricet dhe kripu gjatë stinës së dimrit</i> | Të saktësohet sasia e tyre                               | NA       | minimal         | Mirëmbajtësi | Mirëmbajtësi | Të analizohen mirë rezultatet e rëna |



<sup>1</sup> N/A nuk ka informacion, ose nuk është e aplikueshme

Rev-04\_VIIMS >> Korrik 2015



### Ndikimet e drejtpërdrejta në habitatin përkatës

Ndikimet e drejtpërdrejta në habitatin detar lidhen me gjermimet. Për këtë arsye ndikimi i vete gjermimit konsiderohet si "i ulet". Në zonën e hedhjes së materialit të gjermuar makro-bentosi përbëhet nga disa grupe, me pasuri të specieve relativisht të larta, por me një densitet të ulet. Fauna ihtike (ichthyic) është e pasur në specie « benthic » dhe « pelagic ». Aktualisht zona përdoret për aktivitete peshkimi, lejohet përdorimi i rrjetave fundore «benthic» dhe zona nuk ka ndonjë rëndësi të veçantë në biodiversitet.

**Zhurma-Gjatë** ndërtimit të rruges, do të jetë e domosdoshme të përdoren pajisje që lëshojnë zhurmë. Ato do të operojnë për gjithë periudhën e ndërtimit të rrugës dhe largësia nga zonat e banuara është e konsiderueshme prandaj ndikimi konsiderohet i "i ulet".

**Ndotja e ajrit-Pluhurat** që dalin nga proceset e ndërtimit si dhe shkarkimet e gazrave të makinave janë burimet e mundshme të ndotjes së ajrit, të cilat mund të rrisin përqendrimin e materialeve të imta në të. Pjesa më e madhe e pajisjeve do të operojnë në një ambient të hapur me një dispersion të madh për shkak të rrymave dhe erërave. Ndikimi në ndotjen e ajrit pra mund të konsiderohet i ulet. Çështja që ka nevojë për masë zbutëse është ndotja (pluhurat dhe çlirimet) që lidhen me kamionët vetë-shkarkues që transportojnë material nga gurorja. Kontraktori duhet të sigurojë në hyrje dhe dalje të rruges, pajisje për shpëlarjen e rotave dhe pjesëve të kamionëve si dhe të ujisë rrugët e hyrjes. Të gjitha pajisjet që punojnë me gazoil duhet të mirëmbahen rregullisht për të minimizuar çlirimet nga skapamentot.

**Ndotja e ujit-** derdhja e ujërave të larjes së makinave dhe pajisjeve të tjera, mund të krijojnë kushte për ndikime të tjera objekt i të cilëve të jetë uji nëntokësor. Ndikimi i këtyre faktorëve është "i vogël", duke marrë në konsideratë nivelin e pajisjeve të përfshira dhe standardet me të cilat punojnë këto tip pajisjesh. Masat zbutëse përfshijnë Praktikën me të Mirë të Menaxhimit të Ndërtimit, të cilat do të jenë një nga kërkesat baze të specifikimeve të kontratës. Sistemet e zbatuara për drenime dhe detajet konstruktive shtrëngojnë ndotjen e ujërave nëntokësore. Për efekte të inspektimit në një pikë të drenimit jashtë trascesë do të vendoset elementi kontrollues. Këtu çdo moment mundësohet inspektimi dhe marrja e mostrave.

### Mbeturinat

Gjatë periudhës së shfrytëzimit të rrugës dhe zones, problemi i prodhimit të mbeturinave nuk do të jetë aq i rëndësishëm sa në periudhën e ndërtimit. Pritet një prodhim minimal i mbeturinave nga aktivitete si hedhja e mbeturinave urbane.

### Ndikime të tjera

Këtu do të përmenden disa ndikime që nuk janë diskutuar më parë si dhe shkalla e ndikimit të tyre në mjedis si:

- ↓ Ndikimet e gjermimeve për mirëmbajtje në trafikun tokësor mbi jetën ujore, tokësore dhe shpërndarjen e sedimenteve, ndikime që konsiderohen të një niveli mjaft të ulët mbasi operacionet e gjermimit do të kryhen në intervale të shkurtër dhe sasitë e tyre do të jenë të vogla;
- ↓ ndotja nga zhurma dhe ndotja e ajrit gjatë operimeve normale dhe të mirëmbajtjes janë konsideruar që janë të neglizhueshme;
- ↓ Shkakun kryesor të ndotjes së mundshme të ujit (përveç derdhjeve të diskutuara më sipër) janë derdhja e llumrave të vajit mjetet e transportit;
- ↓ Vajrat solar të përdorur nga motorët e mjeteve të transportit (tokësor) përmbajnë 5% ndotës të cilët nuk mund të digjen dhe duhet të ndahen nga lënda djegëse.



- Te minimizohet në maksimum kohezgjatja e punimeve dhe operacioneve të ndërtimit të.
- Subjekti të realizojë menjëherë çdo ndërhyrje për pastrimin e mjedisit në ndonjë rast derdhje lëndesh ndotëse në mjedis.
- Te minimizohen punimet gjatë natës dhe të përdoret sinjalistika me dritë pulsuese në vend të sinjalistikës zanore.
- Te përcaktohet numri i druveve që do të priten gjatë fazës së ndërtimit dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor të Korçes të hartohet projekti ripylyezues me tre fishin e druveve të prera përfshirë dhe vendin e mbjelljes së tyre.
- Te merren masa për sigurinë dhe shëndetin në punë në bazë të VKM Nr. 692 datë 13/12.2001 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë"

b) Gjatë ushtrimit të veprimtarisë

- Te përdoren lende të para nga subjekte të licencuara.
- Te bëhet trajtimi i ujerave teknologjike para shkarkimit.
- Te funksionojnë rregullisht të gjithë agregatet teknologjike të mbrojtjes së mjedisit (zjarrit, aspiratorit, etj.)
- Mbetjet e dala nga proceset e ndryshme të depozitohen perkohësisht në mjediset ku zhvillohet veprimtaria ,për t'u dërguar me pas në vendin e përcaktuar nga organet e Pushtetit Vendor.
- .
- Te kontrollohet në mënyrë të vazhdueshme efikasiteti i impianteve të trajtimit të ujrave, për të evituar ndotjen e tokës dhe ujerave (monitorimi).
- Subjekti të realizojë menjëherë çdo ndërhyrje për pastrimin e mjedisit në ndonjë rast derdhje lëndesh ndotëse në mjedis.
- Te konsiderohen përmirësime të vazhdueshme të infrastruktures dhe proceseve me qëllim që të ulët vazhdimisht ndikimin negativ në mjedis.
- Te zbatohet plani i emergjencës në rast aksidenti.
- Te merren masa për reduktimin e zhurmave në mënyrë që të respektohet kufiri i limitit për zhurmën në zonën e mbrojtur sipas direktivave të BE-së dhe normave shqiptare.

**4.4. Normat e lejuara të shkarkimeve në mjedis.**

**- Shkarkimet e lengta;**

Subjekti duhet të sigurojë që të mos kalojë vlerat e mëposhtme të shkarkimeve të lengta të veprimtarisë së tij (ujerat teknologjike, sipas VKM Nr. 177 datë 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse, Aneksi 3).

Në përfundim të trajtimit të ujerave të përdorura, kur janë brenda normave të lejuara të purifikimit, shkarkohen vetëm në ujëra sipërfaqësore rrjedhëse.



Nese per arsye teknike, eshte e pamundur te zbatohen normat e lejuara, subjekti qe ushtron veprimtarine industriale, njofton me shkrim Ministrine e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujërave duke argumentuar teknikisht pamundesine e zbatimit te ketyre normave.

Tabela 79: Normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta, qe duhet te plotesojne ujerat (e zeza dhe ato teknologjike) pas trajtimit. (Ne zbatim te vlerave te miratuara me VKM nr.177 date 31.03.2005).

| Nr. | Parametrat                              | Vlerat e lejuara |
|-----|---|------------------|
| 1   | pH                                      | 6-9              |
| 2   | Lende pezull                            | 50 mg/l          |
| 3   | Produkte te naftes                      | 10 mg/l          |
| 4   | Kromi total                             | 0.5 mg/l         |
| 5   | Bakri                                   | 0.5 mg/l         |
| 6   | Zinku                                   | 1.0 mg/l         |
| 7   | Hekuri                                  | 1.0 mg/l         |
| 8   | Klori i lire                            | 0.2 mg/l         |
| 9   | Rritja e temperatures ne ujerat pritese | 3°C              |
| 10  | BOD <sub>5</sub>                        | 50 mg/l          |
| 11  | COD                                     | 250 mg/l         |
| 12  | Phenol                                  | 0.5 mg/l         |
| 13  | CN total                                | 1mg/l            |
| 14  | CN i lire                               | 0.1mg/l          |
| 15  | P                                       | 2 mg/l           |
| 16  | F                                       | 20 mg/l          |
| 17  | SULFIDE                                 | 1mg/l            |

**Gjithashtu te zbatohen kushtet e meposhtme:**

1. Te eliminohet hedhja e cdo mbeturine te ngurte gjate fazes se ndertimit ne mjedisin liqenor
2. Largimi i mbeturinave dhe hidrokarbureve te behet nga subjekte te licensuara
3. Te eliminohen shkarkimet e mbetjeve te lengeta te patrajuara
4. Trajtimi i mbetjeve te lengeta te behet jashte zones se masterplanit
5. Te behet trajtimi i ujrave te zeza pasi te grumbullohen
6. Sistemi i kanalizimeve te jete i ndare nga shkarkimet e tjera te lengeta. Ndalohet shkarkesa direkte e ujrave te zeza.
7. Te inspektohet dhe mirembahet tubacionet per te eliminuar avarite qe ndikojne ne mjedisin ujqor dhe ne burimet nenujqore



8. Te sigurohet eliminimi i ndotjes nenujore
9. Te eliminohen ndotjet në mjedisin liqenor nga substancat që shkarkohen përmes ujërave të ndotur. Te respektohen normat e BE.
10. Te monitorohet temperatura e shkarkimit për të siguruar përputhshmëri me temperaturën maksimale të lejuar.
11. Te inspektohen vizualisht në mënyrë të vazhdueshme valvulat, pompat, ndaresi naftë uje, etj.


**- Shkarkimet në ajër**

Normat e lejuara të shkarkimeve në ajër nga funksionimi në këtë zonë gjatë zbatimit janë:

$PM_{10} \leq 50 \text{ mg / Nm}^3$  (dry @3 % O<sub>2</sub>).

$SO_2 \leq 1700 \text{ mg / Nm}^3$  (dry @3 % O<sub>2</sub>).

$NO_2 \leq 450 \text{ mg / Nm}^3$  (dry @3 % O<sub>2</sub>).





## 5. NDIKIMI SOCIAL

### 5.1. Gjendja fillestare

Prej kohësh, Bashkia Pogradec, tregon një numër në rritje të turistëve që vizitojnë vendin gjatë verës.

Biznesi në rritje është turizmi me një numër të madh hotelesh, restorantesh, baresh dhe apartamente për pushime. Numri në rritje me shpejtësi i vizitorëve të brendshëm me një numër të lartë vizitorësh nga

Pogradeci ka shtruar nevojën e shumë ndërtesave të reja pa vendosur së pari një koncept real për zhvillimin urban në vend. Këto ndërtesa të reja krijojnë një formë horizonti urban nëse shikohet nga horizonti.

Kjo formë turizmi që ekziston aktualisht është jashtëzakonisht sezonale dhe vizitorët kryesore vendas shpenzojnë relativisht pak para. Vendet e punës që janë krijuar në industrinë e turizmit për momentin nuk kërkojnë arsim domethënës dhe janë relativisht në një bazë me afat të shkurtër. Kohëzgjatja e sezonit është e kufizuar nga 5 deri në 6 javë dhe disa prej restoranteve hapen vetëm nga Qershori deri në fund të Gushtit dhe zakonisht vetëm për fundjavat jashtë pikut të sezonit. Piku i sezonit është në dy javët e para të Gushtit.

Me kushte klimatike edhe më pak të favorshme, sezoni fillon rreth kohës së Pashkëve deri në fund të Shtatorit. Nga mesi i Prillit, Hotelet rezervohen në rreth 30% por edhe me norma më të larta në fundjavë në varësi të kushteve klimaterike të sezonit. Situata e Pushimeve gjatë Majit dhe Qershorit ofron një sezon të parë të lartë rreth fundit të majit me dy javë pushime. Me shumë festa zyrtare, ky para-sezon i lartë mund të ofrojë 4 javë me një normë rezervimi pothuajse të plotë 90%, sigurisht me Pritshmëritë sezonale.

Tregtia/Hoteleria është pothuajse një biznes 12-mujor, pasi kanë nevojë për kujdes dhe vëmendje gjatë gjithë vitit, dhe puna e shërbimit dhe mirëmbajtjes kryhet jashtë pikut të sezonit. Situata do të mund të lejonte në parim një sezon 12-mujor të lundrimit me varkë për kënaqësi dhe sezon peshkimi për kënaqësi, duke e mbajtur ekipin kryesor të punonjësve dhe stafit të shërbimit në punë për të gjithë vitit.

Në këtë projekt gjatë përdorimit të strukturave rekreative do të krijohen një numër domethënës personeli për shërbime të ndryshme:

Vende Pune të Drejtpërdrejta:

Administrata

Drejtimi, Mbajtja e Llogarive, Blerja, Administrimi i Përgjithshëm

Shitjet dhe Marketingu

Marrëdhëniet me Publikun, TV, Spektaklet Tregtare, Menaxhimi i Eventeve

Personeli i Hotelit

Recepsioni, Administrimi i Ndarjes së Punëve, Mirëmbajtja

Shërbimet Katering

Banakerët, Kamerierët, Kuzhinierët, Stafi i Pastrimit

Mirëmbajtja

Mirëmbajtje dhe Riparim i Pontonëve dhe Mjediset e Jashtme (Pishinë/Plazhi)

Riparim Varkash dhe Shërbime të Varkave

Shërbime të Ndryshme, Shërbime Pirimi, Shërbime Pastrimi, Riparim dhe Këmbim Pjesësh,

Vende Pune Indirekte:

Dyqan Aksesorësh (mundësisht bashkë me Shërbimin e Varkës)

Shitës, Magazinier

Kompanitë

Administrator, Inspektor Varke, Personeli i Pastrimit,





Pika Karburanti:

Stafi i Shërbimit

Zyra e Sigurimit:

Administratori

Dok i Thatë:

Administrator, Stafi i Sigurisë

Shitjet e Varkave:

Administratori, Stafi i Shitjeve

Shkolla Detare:

Instrukturët

Shkolla e Zhytjes:

Instrukturët

Kjo listë nuk është e plotë dhe do të jetë objekt modifikimi gjatë fazës fillestare të implementimit të, sidomos, 10-50 vende pune që do të krijohen në rrjetin e drejtpërdrejtë të varkave janë pothuajse të sigurt dhe të nevojshëm për të ofruar shërbimet të prezencës së këtyre objekteve të reja siç është menduar.

Sipas eksperiencës së shoqërive të shërbimit çdo punonjës krijon 8-9 punë që përfshihen drejtpërdrejtë me kërkesat e Varkave dhe vizitorët, pasi këta njerëz normalisht sjellin jetë ekstra domethënëse dhe vlera në vendndodhjen. Gjithashtu edhe Eventet e planifikuara rreth gjatë gjithë vitit do të kenë një ndikim në strukturën e punonjësve dhe vlerën monetare të shpenzuar.

Duke u bazuar në këto eksperiencë, ne mund të marrim parasysh se 400 deri në 450 vende pune, shumica prej tyre në një bazë vjetore, do të krijohen në rajonin lokal. Të ardhura shtesë dhe të sigurt për punonjësit do të përmirësojnë gjithashtu situatën e punës në periudhën afatgjatë.

Vizitorët ndërkombëtarë shpenzojnë para domethënëse kur janë me pushime jashtë vendit të tyre.

Siç e shohim numri i banorëve është rritur në mënyrë domethënëse, i cili është një tregues se kushtet e punës dhe kërkesa për staf janë rritur ndjeshëm! Numri i vendeve të punës është shumëfishuar me 20. Dhe meqenëse zona ka zhvillim, vendi është shumë i njohur dhe do të vizitohet gjithashtu edhe nga turistët jo-detar. Një vlerë e shtuar është se tani ju do të gjeni gjithashtu qendra Mjekësore dhe shkolla. Kështu që instalimi i varkave si moli për pozicionimin e tyre ka krijuar vlerë shtesë për banorët përveçse krijimit të vendeve të punës.

Ne jemi të sigurt që implementimi i objekteve rekreative në Pogradec do të ketë një efekt pozitiv në Shqipëri dhe në përgjithësi në Turizmin Shqiptar! Ka një ndikim domethënës në njohjen e aktiviteteve turistike brenda vendit. Kjo kërkon një bashkëpunim të ngushtë me Bordin Shqiptar të Turizmit dhe përpjeke të përbashkëta për të paraqitur një tablo pozitive të Shqipërisë në Europë dhe në botë! Ky është çelësi për të fluar klientë ndërkombëtarë në Shqipëri dhe për të rritur Industrinë e Turizmit që të bëhet faktori më i madh ekonomik në Shqipëri.







## 6. MUNDËSITË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSITË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR NË GJENDJEN E MËPARSHME, PËRFSHIREDHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN

### 6.1. Rehabilitimi i mjedisit të ndikuar nga ndërtimi i rrjetit inxhinierik

Rehabilitimi përfshin të gjitha ato masa të cilat synojnë të riaftësojnë tokën e degraduar dhe t'i kthejnë këto toka në një gjendje të qëndrueshme dhe të pandotur.

#### Kutia 1. Qellimi i studimit të rehabilitimit

- Reduktim i kercenimeve ndaj larmise biologjike dhe pejsazhore,
- ~~Rehabilitim i shpejtë i larmise biologjike dhe pejsazhore~~
- Forcimi i koherences ekologjike,
- Sigurimi i pjesëmarrjes së plote të publikut në ruajtjen e larmise biologjike dhe pejsazhore.

#### Synimet kryesore të punës rehabilituese nga investitori janë:

- Të arrihet një stabilizim i zonave të dëmtuara nëpërmjet ndërhyrjeve inxhinierike për të minimizuar ndër të tjera erozionin.
- Të rigjëlbejnë të gjitha zonat e eroduar me specie të përshtatshme bimore, që kanë ekzistuar më parë.
- Të minimizojë ndikimin pamor të zonave të degraduara e të përmirësojë peizazhin.

#### Sistemimi dhe përgatitja e vendit

Hapi i parë në operacionin e rehabilitimit është pastrimi i përgjithshëm dhe sigurimi i zonës.

#### Masa të sugjeruara

Punimet e pastrimit të vendit që ndërmerren pas ndërprerjes së veprimtarisë përfshijnë:

- heqja dhe ndalimi i zhvillimit të veprimtarive që kanë karakter përpunimi apo përgatitje betoni në afërsi të gjurmes së ndërtimit në zone të banuar;
- largimi i të gjitha pajisjeve të fiksuara dhe të palëvizshme, të përkohshme dhe të përhershme;
- largimi dhe eliminimi i duhur i të gjitha mbetjeve përfshirë ato të rrezikshme;
- rehabilitimi i rrugëve dhe vendit të kantierit të ndërtimit;
- pas pastrimit të vendit mund të jetë i nevojshëm pengimi i hyrjes së makinave në vend duke ngritur gardhe për të parandaluar hyrjen e makinave, motoçikletave, njerëzve dhe kafshëve deri në rehabilitimin e zonës.

Hapi i parë në procesin e përgatitjes përfshin rimodelimin e zonës. Përdorimi përfundimtar i tokës do të përcaktojë formën e relievit. Vendi duhet të modelohet në mënyrë të tillë që të harmonizohet me peizazhin rrethues. Vendi duhet lënë në një gjendje të qëndrueshme, lehtësisht të kulluar që të harmonizohet me zonën rrethuese.

Shtresa e tokës duhet të ripërhapet në mënyrë uniforme mbi zonë në një thellësi të përshtatshme për të mbështetur rigjëlberimin anës rruges së re që do të sistemohet.

Kur mungon shtresa e tokës, duhen kërkuar alternativa në materiale argjile të pranishme në vend, në mbulesë minerale ose shkëmbinjtë sedimentare ultrabazik që përfshin një përmbajtje të lartë plurur minerali, shkëmb shumë të thërrmuar ose shtresë dheu që mund të merret nga vendet e ndërtimit, por duhet përshtatur në ngjyrë pa prishur peizazhin.

Të gjitha zonat e ngjeshura duhet të punohen thellë përgjatë konturit. Kjo mund të kryhet përmes ose





pas përhapjes së shtresës së dheut.

### **Rigjelhërimi dhe gjelbërimi**

Vegetacioni është stabilizuesi më i mirë i mirëmbajtjes së thjeshtë të zonave të degraduara në periudhë afatgjatë. Rigjelhërimi i shërben parandalimit të erozionit. Rigjelhërimi gjithashtu minimizon ndikimin e ndërhyrjes pamore.

### **Masa të sugjeruara**

Rigjelhërimi duhet të synojë instalimin e bimëve autoktone. Instalimi i tipeve të vegetacionit jo autokton shpesh kërkon më shumë burime se ri-instalimi i vegetacionit origjinal. Tokat për llojet e huaja duhet të jenë relativisht pjellore dhe mund të jenë të nevojshme trajtimet e mirëmbajtjes, si plehërimi dhe krasitja.

Shtresa e materialit organik me të cilin mbulohet sipërfaqja e tokës për të parandaluar erozionin rreth fidanëve që rriten, mund të reduktojë barërat e këqija dhe të ruajë lagështinë e tokës dhe shtimin e ushqyesve dhe lëndës organike të dobishme. Ndër materialet që mund të përdoren përfshijnë: komposto, mbetje druri, copëra, pluhura sharre, kashitë, levore etj.

### **Monitorimi dhe mirëmbajtja**

Rehabilitimi është një proces që mund të shkojë me vite për të dhënë një ekosistem të qëndrueshëm dhe vetëqëndrues. Kujdesi i mëpastajshëm është vitalisht i rëndësishëm dhe çdo dështim duhet të riparohet shpejt.

### **Masa të sugjeruara**

Zonat e rehabilituara duhet të inspektohen rregullisht për të vlerësuar shëndetin e vegetacionit dhe kontrolluar për erozion, dëmtim nga kullotja dhe ndotje nga barërat e këqija. Inspektime të përvitshme mund të kërkohen për të siguruar suksesin në vazhdim të rigjelhërimit.

## **6.2. Gjelberimi (mbjella e drureve dhe e barit)**

Përgjatë rrugës në krahun e liqenit janë parashikuar dhe mbjella e 533 pemëve pisha (*Pinus halepensis* me perimetër c 20-25), 52 cope plepa (*Populus pyramidalis* me perimetër c.20-25). Distanca e mbjelljes së pemëve është 12 m.

Në zonat e Ohri club janë parashikuar dhe *Pinus nigra* 36 cope, *Betula alba* (perimetër c.20-25) 45 cope. Distanca e mbjelljes së pemëve në këtë zonë është 6m.

Gjelberimi në exchange markets është parashikuar të kryhet me bime selvie (*Cupressus sempervirens pyramidalis*, 5-6 m te larta, *Populus pyramidalis*, c. 20-25 cm).

Është parashikuar dhe hidrombjellja në një sipërfaqe prej 65,325 m<sup>2</sup>.

Në specifikimet teknike është përcaktuar që pemët duhet të mirëmbahen për një periudhë minimumi një vit pas mbarimit të kontratës dhe gjatë periudhës së garancisë së kontratës.

## **6.3. Kujdesi mbi sipërfaqen, druret dhe shkurret**

### **Transportimi, shtratifikimi dhe përgatitja për mbjellje**

Gjatë transportimit të fidanëve nga fidanishtja deri në objektin ku do të mbillen, është e rëndësishme që ato të mbrohen për të mos u demtuar (ku mund të thyhet) sistemi rrënjor e veçanërisht qimet thithëse të tyre. Për këtë, duhet pasur parasysh që fidanet të jenë në vazo (plastike). Të gjithë llojet e bimësisë, drurët dhe shkurret që do të përdoren në gjelberim, duhet të shtrenjë pranë vendit ku do të implantohen (grupës) në vazo për siguri më të madhe në zënie.



Gjatë transportimit të tyre nuk duhet lejuar ulja mbi fidanë ose vendosja e çfarëdo peshe mbi to.

- **Mbjellja e fidaneve**

Te gjitha kostot e blerjes, transportit dhe mbjelljes së pemëve dhe periudha e garancisë janë të përfshira në emimin e pemëve.

**Piketimi ,hapja e gropës**

Pasi ka përfunduar punimi i përgjithshëm i tokës, caktohen vendet se ku do të mbillen drurët dhe shkurret dekorative, sipas projektit teknik.

Ky vend caktohet duke vendosur në tokë piketa të etiketuara sipas llojeve të fidanëve. Madhësia e gropave është e ndryshme për drurët dhe për shkurret. Ajo varet prej përbërjes së tokës, moshës së fidanit dhe madhësisë e shtrirjes së vetë sistemit rrënjor të tyre. Dy-tre vjet mbas mbjelljes, fidanët kërkojnë tokë më të shkrifët dhe më pjellore me qëllim që të zhvillojnë më mirë sistemin e tyre rrënjor.

**Mbjellja**

Mbjellja e fidanit duhet të bëhet prej dy punëtorëve.

Në gropën ku është mbjellë fidani, dheu duhet të qëndrojë 3-5 cm më lart se sa niveli i territorit, me qëllim që mbas cedimit të tij të fitohet niveli i mëparshëm.

- **Kujdesi pas mbjelljes (shërbime agroteknike)**

**Shkriftimi i Tokës**

3 herë në vit (në pranverë, në verë dhe në vjeshtë), duhet t'u bëhet punimi dhe shkrifërimi i tokës përreth trungut. Ky punim zakonisht kryhet me bel ose me shat, dhe është i nevojshëm sidomos vitin e parë mbas mbjelljes. Duhet që ky proces të kryhet mbasi të kenë kaluar ngricat e pranverës.

**Ujitja**

Sasia e ujit që duhet përdor për vaditje përcaktohet edhe nga lloji dhe përbërja e tokës, por në përgjithësi përdoret 30 l uje nje dru i rritur dhe 7-10 l uje shkurre.

Kontraktori duhet të llogarise nje periudhe mirembajtje per punimet e gjelberimit me kohezgjatje sa garancia e kontrates.

Mbjellja e drureve dhe e barit parashikon furnizim, vendosje dhe shërbimet perkatese.

- **Sipërfaqja e barit**

**Cilesite**

- a) të mos mbajë ujë e shiut. Kjo sigurohet nëpërmjet përmirësimit të tokës dhe drenazhimit të saj
- b) të jetë e fortë që të mos deformohet gjatë shkeljeve
- c) të ripërtërihet shpejt pas kositjes

**Roli i sipërfaqes**

Përveç rolit higjieno-sanitar, estetik, mjedisor, këto sipërfaqe (shirita) shërbejnë edhe për ajrimin e tokës së parcelave dhe ndihmojnë në zhvillimin normal të drurëve dhe shkurreve dekorative.

Sipërfaqe bari në skarpate të pjerrësive duhet t'u kushtohet vëmendje e duhur për të pasur densitetin e duhur dhe punimet paraprake të jenë bërë me shumë cilësi (dheu, ngjeshja, etj) në mënyrë që mos të ndodhë "cedimi i sipërfaqes" apo zhvendosje.

Keto detaje dhe parametra teknike duhet të ruhen në zbatimin me sukses të këtij projekti.





## 7. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS

### Masat zbutese ndaj ndikimit në mjedis

#### Faza e ndërtimit,

Në funksion të rezultateve të vlerësimeve të ndikimit, masat zbutese që ndërmerren gjatë fazës së ndërtimit:

- (i) Sheshet e ndërtimit, rrugët e transportit, dhe venddepozitimet e mbetjeve inerte do të jenë të mbuluar me ditë erë si dhe të lagen me ujë deri në tri herë në ditë në ditë të thatë dhe, sidomos në qoftë se këto vende janë pranë receptor të ndjeshme, siç janë zonat e banimit.
- (ii) Automjetet dhe makineritë e ndërtimit do të duhet të mirëmbahen siç duhet dhe në përputhje me standardet e emisioneve përkatëse.
- (iii) Aktivitetet e ndërtimit do të jenë të planifikuara me kujdes për të minimizuar ndikimin e zhurmës nga makineritë e ndërtimit. Natën përdorimi i makinave të zhurmshme, të tilla si eskavatore dhe vibratore betoni, do të ndalohen.
- (iv) Në bashkëpunim me autoritet përkatëse, planet e qarkullimit rrugor do të jetë i përgatitur përpara e ndërtimit në zonat urbane mbushur plot.
- (v) Ujërat e zeza nga kampet e ndërtimit do të mbledhen dhe të trajtohen në gropa septike para se të shkarkohen, për të shmangur kontaminimin të zonat përreth.
- (vi) Toka e qëndrimit të përkohshëm do të jetë i planifikuar mirë përpara e ndërtimit për të minimizuar ndikimin. Toka do të rikthehet në gjendjen e saj origjinale pas ndërtimit.
- (vii) Lendet apo materialet e ndërtimit do të ruhen në vende të përshtatshme dhe të mbuluara për të minimizuar pluhurin.
- (viii) Mbetjet e ndërtimit do të hiqen menjëherë nga venddepozitimi. Djegia e mbetjeve të ndërtimit do të jetë i ndaluar qofshin dhe në sasi minimale.
- (ix) Materialet do të jenë ete mbuluara gjatë transportit për të shmangur shpërndarjen e pluhurit në ajër.
- (x) Ndërtim do të pezullohet menjëherë nëse ka ndonjë, ose ka objekte kulturore arkeologjike të gjetur gjatë fazës së ndërtimit. Autoriteti përkatës kulturore, si dhe IMK, do të njoftohet menjëherë, dhe ndërtimi do të rinisin vetëm pas një hetim të plotë.
- (xi) Kontraktori do të jetë e nevojshme për të marrë masat e nevojshme për sigurinë në vendet e ndërtimit për të mbrojtur publikun, dhe për të siguruar shenja paralajmëruese për të njoftuar për rreziqet e mundshme të sigurisë publike në dhe rreth e zonave të ndërtimit.
- (xii) Të gjithë kontraktuesit dhe mbikëqyrësit e ndërtimit do të kërkohet që të marrin pjesë në programet e trajnimit të mjedisit para se të ndërtimit.
- (xiii) Masat për të parandaluar gërryerjen e dheut do të miratohet në forme rehabilituese me vepra ndërtuese të përkohshme ose të përhershme. Këto masa mund të përfshijnë kanale zënue, mbajtjen e mureve, dhe ndërtimit caktimin për të shmangur demtim të tyre gjatë rënies së shirave apo stuhive.
- (xiv) Shtresat e punueshme do të mbledhen në gropa bosh të përkohshme. Tokës do të përdoret për rehabilitimin të sheshit dhe bonifikimin e sipërfaqeve të demtuara. Zbutjen e masave të mësipërme do të përcaktohen saktë pasi të merren lejet përkatëse të dhëna nga autoriteti miratuesë kundërsht subjektit ndërtues në fazën e II i cili do të jetë subjekti që do të rishikoj edhe njëherë këtë raport fillestar konform detyrimeve ligjore në fuqi, sipas kontratave për ndërtim (Rehabilitimin e bregut të Liqenit të Ohrit si dhe gjelbërimit përgjatë rruges segmentit Lin-Pogradec.





Lista e kontrollit të efekteve të mundshme dhe masave kryesore nga zhvillimi i projektit

Tabela 849: Lista e kontrollit të efekteve të mundshme dhe masave kryesore nga zhvillimi i projektit

| Komponentët Mjedisorë | Efektet e Mundshme  | Masat Zbutëse  |
|-----------------------|---|--|
| <i>Mjedis i Fizik</i> |   |  |
| Dherat                | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dëmtime të strukturës së dheut si pasojë e ruajtjes së materialeve, trafikut të transportit, etj.</li> <li>• Humbja e dheut sipërfaqësor gjatë gërmimeve apo hedhjes së materialeve të ndërtimit</li> <li>• Erozioni si pasojë e rrjedhjeve sipërfaqësore të pakontrolluara</li> <li>• Ndotje në pikat e derdhjes së mbeturinave, që mund të sjellë ndotjen e ujrave nëntoksorë</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbrojtja e zonave jo-ndërtimore, shmangia e punimeve në zonat e ndjeshme gjatë kushteve me negativitet të lartë, sigurimi i rrugëve për transport, sipas nevojës, riparimi i zonave të dëmtuara</li> <li>• Heqja e dheut sipërfaqësor aty ku është e nevojshme, ruajtja dhe rivendosja mbas mbarimit të ndërtimeve</li> <li>• Projektimi i drenazheve e strukturave për të siguruar stabilitetin e dheut sipërfaqësor dhe trajtim i përshtatshëm</li> </ul>   |
| Toka                  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rrëshqitje mbi skarpata, faqe toke, etj.</li> <li>• Efektet e gërmimeve / hedhja e dheut dhe materialeve të tjera</li> </ul>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbrojtja e zonave jo-ndërtimore</li> <li>• Kryerja e punimeve në mënyrë të tillë që të minimizohet sipërfaqja e ndikuar e tokës</li> <li>• Projektimi i sipërfaqeve të pjerrta dhe strukturave mbajtëse për të minimizuar rrezikun, sigurimi i drenazheve dhe stabilizimit të dheut/mbulimit të bimësisë</li> <li>• Heqja e dheut sipërfaqësor aty ku është e nevojshme, ruajtja dhe rivendosja/ripërdorimi mbas mbarimit të ndërtimeve</li> <li>• Transportimi/hedhja e materialeve nga/në vende të aprovuara</li> </ul> |





| Komponentët Mjedisorë | Efektet e Mundshme   | Masat Zbutëse  |
|-----------------------|--|--|
| Burimet Ujore         | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndryshime në rregjim nga gërmimet apo hedhja e dheut, mbeturinat, etj.</li> <li>• Ndotja/infektimi nga punimet ndërtimore, mbeturinat njerëzore apo të kafshëve përfshi karburantet &amp; vajrat, mbetjet e rrezikshme, mbeturinat ujore dhe ujrut e zeza – sidomos nga derdhja kur nuk janë të lidhura me sistemin e kanalizimeve ekzistuese.</li> <li>• Mbi-popullimi i sipërfaqeve ujore që sjell ndryshime në habitate, etj.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ruajtja e kujdesshme e materialeve dhe mbeturinave të rrezikshme, sigurimi i drenazhimeve të përshtatshme dhe derdhje e kujdesshme e mbeturinave</li> <li>• Përzgjedhja e teknologjisë së përshtatshme për trajtimin e mbeturinave ujore për të minimizuar ndotjen, p.sh. në afërsi të burimeve të ujit të pijshëm, dhe operimi e mirëmbajtja e kujdesshme sipas standarteve të aprovuara, trajnim në operim e mirëmbajtje</li> <li>• Impjante i përpunimit në kantier të funksionojë në mënyrë të përshtatshme, ose të përfshihet në sistem të mëdha mbeturinash ujore, të kryhet trajtim në përputhje me standartet e kërkuara, plus trajnim</li> </ul> |
| Cilësia e Ajrit       | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pluhuri gjatë fazës ndërtimore</li> <li>• Gazra të rrezikshme në puseta dhe gjatë disinfektimit (kur bëhet me gaz klorik)</li> </ul>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kontrollohet pluhuri me ujë</li> <li>• Të kontrollohen metodat e ndërtimit dhe impjanti, afatet e punimeve</li> <li>• Të kufizohet shpejtësia e automjeteve në zonat rezidenciale</li> <li>• Projektim i kujdesshëm</li> <li>• Të krijohet një sistem i përshtatshëm operimi dhe monitorimi</li> </ul>   |
| Mjedisi Akustik       | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhurma nga punimet ndërtimore, dhe trafiku</li> </ul>   | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përcaktohen afatë të punimeve për të minimizuar shqetësimet</li> <li>• Të përdoren metoda dhe paisje të përshtatshme ndërtimi</li> <li>• Të kufizohet shpejtësia e automjeteve në zonat rezidenciale, sidomos e kamionave</li> </ul>   |






| Komponentët Mjedisorë        | Efektet e Mundshme   | Masat Zbutëse  |
|------------------------------|--|--|
